



**“PROPOZIMI FRANCEZ”:  
GJUHA E URREJTJES, DEZINFORMATA,  
MANIPULIME MEDIATIKE  
- ANALIZA MEDIATIKE -**

**“PROPOZIMI FRANCEZ”:  
GJUHA E URREJTJES, DEZINFORMATA,  
MANIPULIME MEDIATIKE  
- analiza mediatike -**

**Botues:**

Instituti për Media dhe Analitikë IMA Shkup

**Bordi redaktues:**

Petrit Saraçini, kryetar i IMA

Zoran Bojarovski, redaktor i botimeve

Zharko Trajanoski, redaktor i hulumtimeve

**Autorë:**

Zoran Bojarovski

Dr. Katerina Kollozova

Zharko Trajanoski

Dr. Sefer Tahiri

Petrit Saraçini

**Përkthimi:**

Fatos Kica

Petrit Saraçini

**Dizajni:**

Jane Stefanov

*Ky publikim është prodhuar me mbështetjen e Fondit Evropian për Demokraci (FED) - European Endowment for Democracy (EED). Përmbajtja e tij nuk pasqyron domosdoshmërisht opinionin zyrtar të EED. Përgjegjësia për informacionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë publikim i takon tërësisht autorit(ëve).*

## PËRMBAJTJA

HYRJE .....	5
<b>ZORAN BOJAROVSKI</b> SHPËRTHIM I GJUHËS SË URREJTJES NË DEBATIT PUBLIK LIDHUR ME “PROPOZIMIN FRANCEZ” .....	7
<b>ZHARKO TRAJANOSKI</b> DEZINFORMATATA, MANIPULIME MEDIATIKE DHE TEORI TË KONSPIRACIONIT PËR “PROPOZIMIN FRANCEZ” .....	25
<b>SEFER TAHIRI</b> SI RAPORTUAN MEDIAT NË GJUHËN SHQIPE PËR “PROPOZIMIN FRANCEZ”? .....	41
<b>PETRIT SARAÇINI</b> NEGOCIATAT ME BE-NË DHE MARRËVESHJA ME BULLGARINË: ORGANIZATAT MEDIATIKE MBËSHTESIN LUFTËN KUNDËR GJUHËS SË URREJTJES, KRITIKA PËR MËNYRËN E ZBATIMIT DHE TRANSPARENCËN .....	47
<b>KATERINA KOLLOZOVA</b> RRUGA E MAQEDONISË SË VERIUT DREJT BE ËSHTË NËN KËRCËNIM NGA NJË AKTOR I PAPRITUR .....	58



## Hyrje

Publikimi “Propozimi francez”: Gjuha e urrejtjes, dezinformata, manipulime mediatike (analiza mediatike) është pjesë e aktiviteteve të projektit të Institutit për Media dhe Analitikë IMA, të mbështetura nga Fondi Evropian për Demokraci (European Endowment for Democracy) nga Brukseli.

Analizat e paraqitura në këtë botim janë kontribut i IMA-s për avancimin e demokracisë dhe sundimit të së drejtës, avancimin e të drejtave të njeriut në komunikimet publike, zhvillimin e mendimit dhe debatit kritik në media, si dhe promovimin e edukimit mediatik dhe gazetarisë etike.

Tekstet autoriale në këtë publikim synojnë të vënë në dukje nevojën për të reduktuar dëmet nga gjuha e urrejtjes, për të ekspozuar gjuhën diskriminuese dhe për të zbuluar narracionet me dezinformata në media.

Në analizën “Shpërthimi i gjuhës së urrejtjes gjatë debatit publik për ‘propozimin francez’”: autori Zoran Bojarovski nisat nga fakti se debati politik ditor për të ashtuquajturin “propozim francez” për tejkalimin e kontestit me Bullgarinë dhe vetos për fillimin e negociatave të Maqedonisë së Veriut për anëtarësim në Bashkimin Evropian, nxitit gjuhën e urrejtjes në publik, në media dhe në rrjetet sociale.

Dukuritë e tilla fituan shtytje pikërisht në kohën kur tensionet në këtë proces po arrinin kulmin. Kjo analizë identifikon karakteristikat dhe elementet e gjuhës së urrejtjes që mbizotëron në diskursin publik dhe se si ato reflektohen në mjedisin aktual të komunikimit në vend në kontekstin e kornizës së propozuar për hapjen e negociatave për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në BE, gjegjësisht “propozimit francez”, siç u pranua gjerësisht në diskursin publik.

Në analizën “Dezinformata, manipulime mediatike dhe teori të konspiracionit për ‘propozimin francez’” autori Zharko Trajanoski thekson se “propozimi francez” ka shkaktuar një valë të dezinformatave, manipulimeve mediatike dhe teorive të konspiracionit në media dhe në komunikimet publike në vend, dhe se e gjithë kjo ndikoi negativisht në debatin publik, i cili u polarizua dhe u rëndua me gjuhë që nxit urrejtje, jotolerancë, armiqësi, e kohë pas kohe edhe dhunë.

Analiza e Trajanoskit i paraqet narracionet kryesore që përmbanin dezinformata me qëllim të ngritjes së panikut social, nxitjes së mosbesimit ndaj institucioneve, nxitjes së urrejtjes, jotolerancës dhe polarizimit në shoqëri. Disa nga ato narracione kishin për qëllim shkaktimin e çorientimit dhe destabilizimit politik në funksion të mobilizimit politik për të shkaktuar ndryshimin e qeverisë qendrore.

Dr. Sefer Tahiri, në analizën “Si raportuan mediat në gjuhën shqipe për “propozimin francez”?” tregon se mediat në gjuhën shqipe kanë pasur raportime kryesisht afirmative për “propozimin francez”. Autori përqendrohet në rastet e raportimeve sensacionale, si dhe në përmbajtje mediatike me dezinformata. Si tregues veçanërisht indikativ për debatin, Tahiri analizon raportimet e mediave gjatë protestave të organizuara nga opozita maqedonase, kur mediat në gjuhën shqipe u fokusuan në antishqiptarizmin e tyre dhe theksuan nxitjen e urrejtjes ndëretnike që u shfaq në këto protesta.

Pjesë e këtij publikimi është edhe një pasqyrë e qëndrimeve të organizatave mediatike që ndoqën me vëmendje punën dhe raportimin e mediave lidhur me debatin për “propozimin francez”. Petrit Saraçini ka kërkuar nga përfaqësuesit e këtyre organizatave përgjigje në lidhje me trajtimin e gjuhës së urrejtjes në kornizën e negociatave me BE-në dhe veçanërisht në Protokollin për zbatimin e Marrëveshjes për miqësi dhe fqinjësi të mirë me Bullgarinë.

Sa i përket trajtimit të gjuhës së urrejtjes në kontekst të negociatave me BE-në dhe përmbushjes së Marrëveshjes së Miqësisë me Bullgarinë, organizatat mediatike profesionale dhe eksperte në vend shprehen me mbështetje të plotë për luftën kundër gjuhës së urrejtjes. Në të njëjtën kohë, ato shprehën rezerva për mënyrën e zbatimit, definicionet dhe mekanizmat ligjorë që do të përdoren në atë luftë, për transparencën dhe efikasitetin e mekanizmave ekzistues në të gjithë procesin, si dhe për mundësitë e abuzimit për të cenuar lirinë e shprehjes.

Në shkrimin e Dr. Katerina Kollozova “Rruga e Maqedonisë së Veriut drejt BE është nën kërcënim nga një aktor i papritur” analizohen disa nga karakteristikat më të rëndësishme të debatit për “propozimin francez”. Kollozova në analizë paralajmëron edhe për rrezikun që një pjesë e madhe e shoqërisë civile maqedonase iu bashkua të djathtës në refuzimin e marrëveshjes me Sofjen dhe Brukselin.

*Instituti për Media dhe Analitikë IMA Shkup*

# 1 SHPËRTHIM I GJUHËS SË URREJTJES NË DEBATIT PUBLIK LIDHUR ME “PROPOZIMIN FRANCEZ”

Shkruan: ZORAN BOJAROVSKI

Aktualitetet politike ditore dhe zhvillimi i bisedimeve në bazë të të ashtuquajturit “propozim francez” për tejkalimin e kontestit me Bullgarinë dhe vetos për fillimin e negociatave të Maqedonisë së Veriut për anëtarësim në Bashkimin Evropian, ngjallën sërish gjuhën e urrejtjes në publik, media dhe në rrjete sociale. Dukuritë e këtilla morën hov pikërisht në kohë kur tensionet në këtë proces arritën kulminacionin e tyre. Kjo analizë identifikon karakteristikat dhe elementët e gjuhës së urrejtjes që mbizotërojnë në diskursin publik dhe si ato reflektohen në ambientin aktual të komunikimit në vend, në kontekst të kornizës së propozuar për hapjen e negociatave për anëtarësim të Maqedonisë së Veriut në BE, gjegjësisht të “propozimit francez” siç njihet më gjerë në diskursin publik.

## Evolucioni i gjuhës së urrejtjes

Gjuha e urrejtjes dhe dezinformatat, si mjete propagandistike, polarizojnë mendimin publik, promovojnë ekstremizmin e dhunshëm dhe veprat e urrejtjes, minojnë demokracitë dhe zvogëlojnë besimin te liderët politikë, institucionet dhe proceset demokratike.

Sipas më shumë definicioneve, gjuha e urrejtjes si mjet propagande, në të gjitha format e veta të manifestimit, ka për qëllim që të përhapë, nxisë, promovojë apo justifikojë urrejtjen ndëretnike, urrejtjen racore, ksenofobinë, antisemitizmin ose forma tjera të urrejtjes që bazohen në jotolerancë.

Të gjitha këto ndikime përfshijnë jotolerancë të manifestuar me nacionalizëm dhe etnocentrizëm agresiv, diskriminim dhe armiqësi ndaj grupeve të caktuara, pakicave dhe kategorive tjera në margjinat e shoqërisë.

Për fat të keq, si rezultat i dezinformatave dhe gjuhës së urrejtjes, gjithnjë e më shpesh [regjistrohen raste dhune ose vepra penale të urrejtjes<sup>1</sup>](#).

Kjo është një dukuri globale, por përvojat tregojnë së rajoni dhe vendi ynë janë një truall pjellor për ndikime të këtilla. Përvojat flasin se shoqëria maqedonase veçanërisht preket nga gjuha e urrejtjes dhe dezinformatat, me ç’rast në 10 vitet e fundit është vërejtur një trend vazhdimësie dhe përqendrimi në procese dhe grupe të caktuara.

Në këtë kontekst, fushatat me gjuhë urrejtjeje janë të drejtuara kah nxitja e konflikteve të brendshme, sidomos ndërmjet bashkësisë etnike maqedonase dhe shqiptarëve etnikë, dhe në drejtim të përkeqësimit të marrëdhënieve ndërkombëtare të Maqedonisë së Veriut, veçanërisht në raport me fqinjët (Bullgarinë, Greqinë) dhe BE.

Aktualitetet politike ditore dhe dinamika e tyre, e diktuar nga zhvillimi i proceseve

<sup>1</sup> Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, postim në faqen zyrtare në Facebook, 22.07.2022



**Aktualitetet politike ditore dhe zhvillimi i bisedimeve në bazë të të ashtuquajturit “propozim francez” për tejkalimin e kontestit me Bullgarinë dhe vetos për fillimin e negociatave të Maqedonisë së Veriut për anëtarësim në Bashkimin Evropian, ngjallën sërish gjuhën e urrjetjes në publik, media dhe në rrjetet sociale. Dukuritë e këtylla morën hov pikërisht në kohë kur tensionet në këtë proces arritën kulminacionin e tyre.**

që janë pjesë e përpjekjeve negociuese për tejkalimin e kontestit me Bullgarinë lidhur me veton për fillimin e negociatave dhe të ashtuquajturit “propozim francez”, ngjallën sërish gjuhën e urrjetjes në opinionin publik, mediat dhe rrjetet sociale. Dukuritë e këtylla morën hov pikërisht në kohë kur tensionet në këtë proces arritën kulminacionin e tyre.

Qëllimi tjetër, kundër të cilit janë drejtuar fushatat me gjuhë urrjetjeje, janë proceset kryesore politike në vend, siç ishte referendumi i shtatorit të vitit 2018 lidhur me ndryshimin e emrit të vendit si rezultat i Marrëveshjes së Prespës, që po ashtu ishte cak i një fushate të organizuar me gjuhë urrjetjeje dhe dezinformata.

Intensiteti i theksuar dhe organizimi sistematik i fushatave me gjuhë urrjetjeje dhe dezinformata vërehet kur ato problematizojnë çështjet strategjike të Maqedonisë së Veriut në pozicionimin ndërkombëtar të vendit, siç janë anëtarësia në NATO dhe BE.

Gjatë periudhës së pandemisë të KOVID-19, fushata e dezinformatave u përcoll edhe me gjuhë urrjetjeje.

Si një shoqëri mjaft e polarizuar, në të gjitha këto procese u vërtetua se gjuha e urrjetjes dhe dezinformatat gjejnë mjedis jashtëzakonisht pjellor në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ku niveli i lirisë së mediave dhe kulturës politike akoma ka pasoja nga periudha e shtetit të kapur dhe propagandës së vazhdueshme populiste gjatë qeverisjes së Nikolla Gruevskit.

Pikënisja e kësaj analize është te identifikimi i karakteristikave dhe elementëve tipikë të gjuhës së urrjetjes që mbizotërojnë në diskursin publik, mediat dhe në rrjetet sociale, dhe si ato reflektohen në ambientin aktual të komunikimit në Maqedoninë e Veriut, në kontekst të [Qëndrimit të përgjithshëm në takimin e ministrave në konferencën ndërqeveritare lidhur me përfundimin e hapjes së negociatave për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian](#)<sup>2</sup>, gjegjësisht “propozimit francez” siç njihet më gjerë në diskursin publik në vend.

Analiza është bërë në bazë të vlerësimit të peizazhit mediatik, shembujve konkretë të mediave dhe komunikimit lidhur me temën “propozimi francez” për kornizën e bisedimeve të Maqedonisë së Veriut lidhur me fillimin e negociatave me BE në periudhën nga 4 deri në 16 korrik, kur Kuvendi miratoi konkluzionet e Qeverisë. Në mënyrë plotësuese janë shfrytëzuar burime dytësore, si për shembull raportet për mbikëqyrje dhe vendimet e organeve rregullatore, organeve vetërregulluese, platformat për verifikimin e fakteve dhe hulumtime paraprake të mediave për gjuhë urrjetjeje dhe dezinformata, si dhe intervista me burime dhe ekspertë relevantë lidhur me gjuhën e urrjetjes dhe dezinformatat.

<sup>2</sup> [Qëndrimi i përgjithshëm i takimit ministror të konferencës ndërqeveritare për përfundimin e hapjes së negociatave për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian \(“Propozimi francez”\)](#), i publikuar në ueb faqen e Qeverisë, më 07.06.2022

## Burimet e gjuhës së urrejtjes dhe dezinformative nuk gjinden vetëm jashtë vendit, por i kemi edhe këtu

Kur bëhet fjalë për gjuhën e urrejtjes dhe dezinformatat si mjete propagandistike, në rastin e Maqedonisë së Veriut duhet të merret parasysh edhe studimi i Parlamentit Evropian, i publikuar në vitin 2021, [“Mapping Fake News and Disinformation in the Western Balkans and Identifying Ways to Effectively Counter Them”](#)<sup>3</sup>. Në të është nxjerrë konkluzioni se “edhe pse gjuha e urrejtjes dhe dezinformatat merren në kontekst të kërcënimeve të jashtme lidhur me funksionimin e qeverisjes dhe demokracinë, ky studim tregon se aktorët e huaj nuk janë fajtorët më të shquar. Numri më i madh i individëve, mediave dhe organizatave që prodhojnë gjuhë urrejtjeje dhe përhapin dezinformata janë të brendshëm” (Diskriminim, jotolerancë dhe gjuhë urrejtjeje në “Milenko Nedelkovski Show”)<sup>4</sup>.

Krahas kësaj, ky studim tërheq vëmendjen se “dukuritë e këtilla më shumë lënë përshtypjen e një simptome se sa një shkak, dhe se janë rezultat i një niveli të ulët të kohezionit shoqëror dhe qeverisjes demokratike”.

Këta tregues duhet të merren shumë seriozisht, në mënyrë që të jepet diagnoza më e saktë për arsyet e nivelit aq të theksuar të gjuhës së urrejtjes, e cila në shumë raste merr formë dhe ka pasoja ekstreme dhe brengosëse ([Mori flakë qendra “Vanço Mihajll-ov” në Manastir](#)<sup>5</sup>, [Përdhosje e përkujtimores së turistëve bullgarë në Ohër](#)<sup>6</sup>), dhe në rast se kërkohet përgjigja më e përshtatshme (përveç me analizat e këtij lloji dhe konstatimet e shumta) për t’u ballafaquar me këtë dukuri që dëmton seriozisht indet vitale të organizmit shoqëror dhe përhapet në to si kancer.

**Aktorët e huaj nuk janë fajtorët më të shquar. Numri më i madh i individëve, mediave dhe organizatave që prodhojnë gjuhë urrejtjeje dhe përhapin dezinformata janë të brendshëm.**

Kjo për më tepër, nëse merren parasysh vërejtjet plotësuese që burojnë nga studimi i Parlamentit Evropian, i cili konstaton se intensiteti dhe tehu i fushatave ksenofobe, të nxitura si nga aktorë vendas ashtu edhe të huaj, janë posaçërisht të theksuara në shtetet ku ekzistojnë ndasi për çështje të caktuara në kontekst etnik, siç janë Bosnja e Hercegovina dhe Maqedonia e Veriut, si dhe në ato shtete ku ka koalicionet qeveritare me një shumicë të ngushtë, e të cilat janë të pambrojtura nga ndërhyrjet e pozicioneve të caktuara gjeopolitike të palëve të treta.

Lidhur me pasojat brengosëse të gjuhës së urrejtjes, e cila ka në shënjestër relacionet ndëretnike, ka tërhequr vërejtjen edhe kryetari i Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, [në intervistën për javoren Fokus të datës 28 korrik 2022](#)<sup>7</sup>.

<sup>3</sup> Shih: [Mapping Fake News and Disinformation in the Western Balkans and Identifying Ways to Effectively Counter Them](#), botuar më 23.02.2021, në Internet faqen e Parlamentit Evropian

<sup>4</sup> Shih: “Diskriminimi, intoleraanca dhe gjuha e urrejtjes në “Milenko Nedelkovski Show”” ([Дискриминација, нетрпеливост и говор на омраза во „Миленко Неделковски шоу“](#)) Mbikëqyrje e jashtëzakonshme e Agjencisë për Media dhe Shërbime Audiovizuale Mediatike, botuar më 13.03.2018

<sup>5</sup> Shih: “Ndizet qendra “Vanço Mihajll-ov” në Manastir” ([Опожарен центарот „Ванчо Михајлов“ во Битола](#)), botuar në TV Telma, 04.06.2022

<sup>6</sup> Shih: “Përdhosje e monumentit për turistët bullgarë në Ohër” [Сквернавење на споменикот за бугарските туристи во Охрид](#), botuar në ueb faqen [Kriime të urrejtjes](#), 27.11.2020

<sup>7</sup> Shih: Intervista e kryetarit Pendarovski për javoren “Fokus”, 28.07.2022 ([Интервјуто на претседателот Пендаровски за неделникот Фокус](#), 28.07.2022)

"Konflikte dhe tensione ndëretnike paraqiten kur aktorët politikë forcojnë retorikën nacionaliste dhe kjo është diçka që më brengos më së shumti. Jo se Maqedonia do të shpërbëhet nëse mbesim jashtë BE, e as që do të ketë destabilizim serioz për këtë shkak, por nuk është mirë të ekzistojnë faktorë politikë, të cilët manipulojnë më ndjenjat nacionale të qytetarëve", thotë Pendarovski.

Ai potencon se retorika nxitëse kundër të tjerëve mund të shkaktojë incidente: "Mua më kujtohet fillimi i viteve të '90-ta, kur as VMRO-DPMNE e atëherëshme nuk kishte retorikë kaq nxitëse kundër të tjerëve. Ne kemi një retorikë të paparë kundër shqiptarëve, pastaj kemi retorikë të paparë antiperëndimore, antiamerikane, antigreke, antibullgare dhe druaj se gjeneratat e reja, të nxitur nga retorika e politikanëve, ndoshta do të duan të shkaktojnë incidente provokuese".

Pendarovski tërheq vërejtjen se janë të rrezikshme përpjekjet për të fituar pikë politike me retorikë nxitëse dhe krahason situatën e sotme me atë të vitit 2001.

"...Retorika e vitit 2001 kur kishim luftë, nuk është as për së afërmi si kjo tani. Mund të tentosh të fitosh pikë politike me retorikë të tillë, por kjo është e rrezikshme. Për 30 vjet pavarësie të vendit tonë, ne për herë të parë kemi një deputet që flet për pushkatime, për prerje kokash. Kjo nuk mund të jetë shprehje legjitime politike. Çka nëse njerëzit, që kanë dalë të protestojnë në rrugë, mendojnë se kjo me të vërtetë është zgjidhje për disa probleme?", thekson kryetari Pendarovski në intervistën për magazinën politike "Fokus".

Për shkak se vjen nga Parlamenti Evropian, studimi "[Mapping Fake News and Disinformation in the Western Balkans and Identifying Ways to Effectively Counter Them](#)"<sup>8</sup> posaçërisht u kushton vëmendje veprimeve të aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në vendet e Ballkanit Perëndimor, të cilët përdorin gjuhën e urrejtjes dhe dezinformata, me qëllim që ta minojnë kredibilitetin e Bashkimit Evropian në rajon.

Studimi potencon se në përpjekjet për diskreditim të BE dominon Rusia, e cila ka infrastrukturë të gjerë të manipulimit mediatic në gjithë rajonin.

## Gjuha e urrejtjes dhe dezinformatat si eksploziv C4 për shtyllat e shoqërisë

Analizat tregojnë se qendrat e propagandës, si vendase ashtu edhe ato të huaja në lindje, kanë identifikuar 4 shtylla në të cilat mbështetet dhe mbi të cilat funksionon shoqëria maqedonase. Ato janë:

- Marrëdhëniet ndëretnike;
- Marrëdhëniet fqinjësore;
- Lidhjet me BE dhe NATO dhe
- Proceset kritike politike që kanë të bëjnë me të ardhmen dhe zhvillimin e vendit – zakonisht të tilla konsiderohen proceset zgjedhore.

Pikërisht këto janë caqe të propagandës me gjuhë të urrejtjes dhe dezinformata.

Intensiteti i theksuar dhe organizimi sistemik i fushatave me gjuhë urrejtjeje dhe

<sup>8</sup> Shih: [Mapping Fake News and Disinformation in the Western Balkans and Identifying Ways to Effectively Counter Them](#), botuar më 23.02.2021, internet faqja e Parlamentit Evropian

**Intensiteti i theksuar dhe organizimi sistemik i fushatave me gjuhë urrejtjeje dhe dezinformata vërehet kur ato problematizojnë çështjet strategjike të Maqedonisë së Veriut në pozicionimin ndërkombëtar të vendit, siç janë anëtarësia në NATO dhe BE.**

dezinformata vërehet kur ato problematizojnë çështjet strategjike të Maqedonisë së Veriut në pozicionimin ndërkombëtar të vendit, siç janë anëtarësia në NATO dhe BE.

Kjo është plotësisht e kuptueshme, nëse merret parasysh se shumë nga çështjet kryesore të agjendës politike për të ardhmen e Republikës së Maqedonisë së Veriut varen ose burojnë nga zgjedhja e përhershme e këtyre dy qëllimeve strategjike. Rrjedhimisht, [pikërisht ato paraqesin cak legjitim të propagandës, siç deklaroi një ambasador rus](#)<sup>9</sup>, e ku përfshihen edhe gjuha e urrejtjes dhe dezinformatat.

Përdorimin e gjuhës së urrejtjes dhe dezinformatave, si pjesë e propagandës kundër referendimit për ndryshimin e emrit të vendit, në mënyrë shumë precize dhe gjithëpërfshirëse e analizon Zharko Trajanoski, në serinë e analizave [“Propaganda ruse në Maqedoni në vitin 2018: “Edinstvena Maqedonia” \(Maqedonia Unike\) si ‘gur shahu’ i “Rusisë Unike”](#)<sup>10</sup>, [“Propaganda ruse me dezinformata në Maqedoni para referendimit të vitit 2018”](#)<sup>11</sup> dhe [“Propaganda ruse në Maqedoni pas referendimit deri në anëtarësimin në NATO”](#)<sup>12</sup>.

Në një nga pjesët e analizës së tij, Trajanoski në mënyrë precize përmend protagonistët e propagandës dhe përmbajtjen e gjuhës së urrejtjes në këtë moment kyç të historisë bashkëkohore të Maqedonisë së Veriut, duke dhënë konkluzion se “propaganda e tillë kërcënuese pa dyshim nxiste dyshime dhe mosbesim në institucionet demokratike dhe ndaj qeverisë, që udhëhiqte një fushatë pozitive për referendumin. Fushatat propagandistike me hashtagun #Bojkotoj, shkaktuan ndasi në “patriotë” dhe “tradhtarë”, e radikalizuan diskursin politik dhe nxitën ndjenja negative dhe urrejtje kundër “tradhtarëve”. Fushatat me dezinformata dhe konspiracione që shkaktuan frikë, mosbesim, pasiguri dhe që nxinin armiqësi dhe gjuhë urrejtjeje, u treguan si armë të fuqishme për të pasivizuar votuesit, për të minuar referendumin si proces demokratik dhe për të rritur mosbesimin ndaj BE dhe NATO në Maqedoni”.

## Evolucioni i gjuhës ballkanike të urrejtjes me “theks francez”

Vërsulja e fundit propagandistike me gjuhë urrejtjeje ndodhi në kontekst të “propozimit francez” për zhblokimin e procesit negociues për anëtarësim të Maqedonisë së Veriut në BE. [Kanonada me gjuhë urrejtjeje](#)<sup>13</sup> përjetoi kulminacionin gjatë dis-

<sup>9</sup> Shih: “Rusia do t’i përgjigjet Maqedonisë me një përgjigje të menduar mire” ([Русија ќе ѝ возврати на Македонија со промислен одговор, DW, 29.03.2018](#))

<sup>10</sup> Shih: “Propaganda ruse në Maqedoni në 2018: “Maqedonia Unike” si “gur shahu” i “Rusisë Unike” ([„Руската пропаганда во Македонија во 2018: „Единствена Македонија“ како „пионче“ на „Единствена Русија“](#)), botuar në ueb faqen Vërtetmatës (Вистиномер) 05.04.2022

<sup>11</sup> Shih: “Propaganda ruse me dezinformata në Maqedoni para referendimit të vitit 2018 ([„Руската пропаганда со дезинформации во Македонија пред референдумот во 2018“](#)), botuar në Vërtetmatës më 12.04.2022

<sup>12</sup> Shih: “Propaganda ruse në Maqedoni pas referendimit deri në anëtarësimin në NATO” ([„Руската пропаганда во Македонија по референдумот до зачленувањето во НАТО“](#)), botuar në Vërtetmatës më 20.04.2022

<sup>13</sup> Rezultatet e kërkimeve me fjalën kyçe “urrejtje” në portalin Republika ([Резултати од пребарувањата со клучниот збор „омраза“ на порталот Република](#))

kutimit plenar në Kuvend për konkluzionet e Qeverisë lidhur me tekstin e kornizës së bisedimeve, e menjëherë më pas edhe për Protokollin me Republikën e Bullgarisë, si dhe për Deklaratën që trajton çështjen e gjuhës maqedonase.

Kjo analizë konsideroi si posaçërisht të rëndësishëm aspektin e gjuhës së urrejtjes, e cila u transferua në Kuvend nga rrugët me protesta dhe nga rrjetet sociale ([Debat rruçqërie në Kuvend: Deputetët e LSDM janë monstra, e ata të VMRO-DPMNE janë për shërim në Demir Hisar](#)<sup>14</sup>), si dhe aspektin e gjuhës së urrejtjes dhe ndasive gjithnjë e më të theksuara në plan të brendshëm ndërmjet dy grupeve më të mëdha etnike ([Mllefi nga propozimi francez shtrihet mbi bashkëjetesën](#)<sup>15</sup>).

Mirëpo, para se ta analizojmë evolucionin e gjuhës ballkanase të urrejtjes me "theks francez", të shohim çfarë thonë doracakët e propagandës për përdorimin e gjuhës së urrejtjes dhe dezinformatave ([Hate and propaganda models of media and communication in the Western Balkans and Turkey](#)<sup>16</sup>).

Për sa i përket përbajtjes, doracakët thonë se rekomandohet prodhim sistemik i pakove mediatike me gjuhë të urrejtjes në tekste, raporte, komente, tituj, përbajtje vizuale "gazetareske" (fotografi, ilustrime, video regjistrime), simbole, porosi të krijuara enkas për të nxitur urrejtje kundër grupeve dhe individëve të caktuar, shpifje, paragjy-kime dhe gjuhë diskriminuese.

Tingëllon si diçka që kemi dëgjuar më parë, apo jo?

Si diçka të njohur, tashmë të parë e të dëgjuar dhe jashtëzakonisht të rrezikshme, këtë e vlerësoi edhe Instituti për Media dhe Analitikë IMA, i cili në tekstin "[Intensifikohet gjuha e urrejtjes sipas më shumë bazave: Sërish jehon "shqiptarët e mallkuar" dhe "Maqedoni e pastër"; ku është opinionimi publik dhe institucionet?](#)<sup>17</sup>", tërhoqi vërejtjen se "gjuha e urrejtjes paraqet kërcënim për paqen dhe sigurinë e shoqërisë dhe se mediat, shoqëria civile, por, para së gjithash institucionet kompetente, duhet të bëjnë çmos për ta parandaluar rritjen dhe përdorimin e saj si metodë në luftën politike".

Të gjitha këto, të mbështetura fuqishëm me frikësim, shqetësim dhe dezinformata, manipulime faktesh dhe fotografish, revizionizëm të fakteve historike, fushata brutalisht negative dhe shpifëse kundër qaqeve të caktuara, përhapjen e frikës së panevojshme – dominojnë si narrativ në këto platforma mediatike dhe të komunikimit.

Qaqe të përbajtjeve të këtilla janë individë ose grupet e përkrahësve të partive politike kundërshtarë, bashkësive etnike, fetare dhe seksuale, popujt fqinjë, bashkësitë e pakicave si emigrantet, refugjatët dhe azilkërkuesit, romët, myslimanët, hebrenjtë, kundërshtarët politikë ose ideologjikë, gazetarët dhe mediat kritike ([SHGM: Sulme të shpeshtuara ndaj gazetarëve; organet kompetente të reagojnë urgjentisht lidhur me de-noncimet](#)<sup>18</sup>), personat publikë dhe aktivistët e shoqërisë civile me orientim kritik, anëtarët

<sup>14</sup> Shih: "Debat rruge në Kuvend: Deputetët e LSDM-së janë frikacakë, kurse ata të VMRO-DPMNE-së për mjekim në Demir Hisar" ([Улична дебата во Собранието: Пратениците од СДСМ се изроди, а тие од ВМРО-ДПМНЕ се за лекување во Демир Хисар](#)), botuar në portalin [Makfaks 15.07.2022](#)

<sup>15</sup> Shih: Mllefi nga propozimi francez derdhet në bashkëjetesë ([Бесот од францускиот предлог се истура врз соживот](#)), botuar në portalin [Prizma 07.07.2022](#)

<sup>16</sup> Shih: [Hate and propaganda models of media and communication in the Western Balkans and Turkey](#), objaveno на portalot на [SEENPM на 27.11.2020](#)

<sup>17</sup> Shih: "Po intensifikohet gjuha e urrejtjes mbi disa baza: Përsëri jehon 'Shiptarët e mallkuar'" ([„Се интензивира говорот на омраза по повеќе основи: Пак ечи „Клетите Шиптари“](#)), botuar në ueb faqen e IMA, 14.07.2022

<sup>18</sup> Shih: "SHGM: Sulme të shpeshtuara ndaj gazetarëve; organet kompetente të reagojnë urgjentisht lidhur me de-noncimet" ([ЗНМ: Зачестени напади врз новинари, надлежните итно да постапат по пријавите](#)), botuar më 22.10.2021 në portalin [360 shkallë](#)

e komunitetit akademik dhe ithtarë të shoqërive multikulturore, feministet, mbrojtësit e të drejtave të njeriut, organizatat ekologjike dhe aktivistët e mjedisit, Xhorxh Soros, BE ([Me çfarë porosish u prit Ursula Lajen në Kuvend?](#)<sup>19</sup>) dhe aktorët tjerë ndërkombëtarë me qëndrime kritike.

Edhe kjo tingëllon si diçka e njohur.

Në tekstin “Gjuhë urrejtjeje dhe sulme joshembullore kundër profesoreshës Kollozova për publikimin e qëndrimeve personale”, [Instituti për Media dhe Analitikë](#) dhe shembull konkret për një sulm të tillë të vazhdueshëm me gjuhë urrejtjeje dhe kërcënime për dhunë<sup>20</sup>.

Kur profesoresha [Katerina Kollozova në profilin e saj në Fejsbuk postoi mendimin](#)<sup>21</sup> e saj për temën kontroverse, pasoi jo vetëm një valë reagimesh dhe [komentesh të pahijshme](#)<sup>22</sup>, por edhe sulme me gjuhë ekstreme të urrejtjes kundër saj në më shumë drejtime. Për shembull, faja e Infomax.mk në Fejsbuk ka lejuar postimin e [qindra komenteve](#)<sup>23</sup> fyese poshtë postimit, prej të cilave një pjesë janë fyerje personale, një pjesë janë me gjuhë urrejtjeje seksiste dhe nxitje urrejtjeje në më shumë baza, ndërsa një pjesë tjetër kërkojnë shkeljen e të drejtave të saja njerëzore dhe janë kërcënime për sigurinë e saj personale.

IMA evidentoi edhe një formë të gjuhës ekstreme të urrejtjes më 26 korrik të vitit 2022, kur në grupin e Fejsbukut [Macedonian Radio Program-3ZZZ, Melbourne](#) u publikua një [status](#)<sup>24</sup> i gazetarit [Ico Najdovski-Perin](#)<sup>25</sup> me fotografi (montazh) të Pendarovskit, Zaevit dhe Kovacevskit, dhe porosinë në vijim, të cilat përmbajnë gjuhë “patriotike” urrejtjeje me motiv politik që nxit dhunë: “Edhe të vdekur do t’ju ndjekim!!! Për linden vetëm shkopi për këta tradhtarë!”.

Në një kombinim të përmbajtjeve dhe caqeve të targetuara për sulm, objekt problematizimi dhe përdhosje faktesh janë edhe ngjarje të caktuara historike nga pozicione të etno-nacionalizmit agresiv.

Formatet dhe teknikat speciale, përfshirë anonimitetin, përdorimin e algoritmeve dhe teknikave tjera, me gjuhën e zgjidhjeve të fuqishme, emotive, verbale dhe vizuele, si dhe mbjelljes së frikës, janë mënyrat e tërheqjes së audiencës, për të ndikuar opinionin publik dhe për të manipuluar me të.

Gjuha e urrejtjes dhe dezinformatat e këtij lloji, të përcjella fuqishëm me mbështetje mediatike dhe gjueti shtrigash në platformat e komunikimit siç janë rrjetet sociale, mund të shkaktojnë incidente, aksione dhe sulme të organizuara ([Incidente para qeverisë në protestat kundër “propozimit francez”](#)<sup>26</sup>, [Policia parandaloi incident ndëretnik në protesta...](#)<sup>27</sup>)

<sup>19</sup> Shih: “Me çfarë porosish u prit Ursula Lajen në Kuvend?” ([Со кои пораки беше пречекана Урсула Лажен во Собранието, rezultate të kërkimit me fjalë kyçe në agregatorin grid.mk](#))

<sup>20</sup> Shih: “Gjuhë e urrejtjes dhe sulmet të pahijshme ndaj profesoreshës Kollozova për pikëpamjet e publikuara personale” ([Говор на омраза и непримерни напади кон професорката Колозова за објавени лични ставови](#)), botuar në ueb faqen e IMA më 28.07.2022

<sup>21</sup> Shih: [Postim në FB profilin e Katerina Kollozova, 25.07.2022](#)

<sup>22</sup> Shih: “Vankovska me ashpërsi ndaj Kollozovës: Nuk e di për familjen tënde, por e imja as nuk flinte dhe as nuk ishte tradhtarë”, botuar më 26.07.2022 ([Ванковска остро до Колозова: За твојата фамилија не знам, но мојата не била заспана ни предавничка, 26.07.2022, Читаж.мк](#))

<sup>23</sup> [Rezultate nga kërkimi me fjalë kyçe në rrjetin social Fejsbuk](#)

<sup>24</sup> Shih: <https://www.facebook.com/groups/756347761371257/permalink/1740772409595449/>

<sup>25</sup> Shih: <https://www.facebook.com/groups/756347761371257/user/1348546167/>

<sup>26</sup> Shih: “Incidente para qeverisë në protestat kundër “propozimit francez”, botuar më 04.07.2022 ([Инциденти на протестите против „францускиот предлог“ пред влада, 04.07.2022](#))

<sup>27</sup> [Rezultate nga kërkimi me fjalë kyçe për incidentet gjatë protestave për propozimin francez në agregatorin e lajmeve time.mk](#)

## Gjuhën e urrejtjes e përvetësuan politikanët dhe fytyrat publike

Në kontekst të fushatës kundër kornizës së propozuar për fillim të negociatave për anëtarësim në BE, lideri dhe deputeti i partisë “Levica” (E Majta), Dimitar Apasiev, zhvendosi gjuhën e urrejtjes nga mediat dhe rrjetet sociale në paraqitjet publike, kur fillimisht bëri thirrje për radikalizim ([Apasievi propozon radikalizim të opozitës me protesta, bllokim dhe paralizim të Kuvendit](#)<sup>28</sup>), e më pas edhe me retorikë të hapur urrejtjeje ndaj kryetarit të vendit Pendarovski ([Apasiev publikisht shan Pendarovskin](#)<sup>29</sup>), pasi që njeriu i parë i vendit në Samitin e NATO në Madrid deklaroi se propozimi i modifikuar francez është “shumë më i mirë për ne, për dallim nga propozimi i parë”.

Kjo vetëm u dha impuls shtesë ndjekësve të Apasievit në rrjetet sociale, sidomos pasi që ai “u vërsul” me gjuhë të pahijshme edhe kundër një pjese të gazetarëve që paraqitën mendimet e tyre lidhur me “propozimin francez” ([Funksionarët nga “Levica” \(E Majta\) me etiketime, gjuhë urrejtjeje dhe kërcënime për përfshirje në “lista” kundër gazetarit Popetreski](#)<sup>30</sup>).

Instituti për Media dhe Analitikë IMA regjistroi se nga gjuha e urrejtjes nuk u kursyen fare as funksionarët e lartë të BE, që në Maqedoninë e Veriut vinin me porosinë se në propozimin e ndryshuar të kornizës negociuese të BE gjuha maqedonase qëndron pa fusnotë, se ardhmëria e Maqedonisë së Veriut është në Bashkimin Evropian dhe se Evropa nuk është e tërë pa të ([Sulme të orkestruara me gjuhë urrejtjeje dhe dezinformata kundër fon der Lajen dhe BE](#)<sup>31</sup>).

Ndaj kësaj reagoi edhe eurokomisari për zgjerim dhe fqinjësi Oliver Varheji, i cili në [intervistën për “Euroaktiv”](#)<sup>32</sup> ftoi opozitën në Maqedoninë e Veriut të kthellohet me porosi se “ndezja e dokumenteve në sallën plenare, nxitja e njerëzve në dhunë dhe nxitja e urrejtjes nuk sjellin asgjë tjetër përveç dëmit”.

Repertori i gjuhës së urrejtjes iu kthye “traditave më të mira” nga koha e qeverisjes së Nikolla Gruevskit dhe shtetit të kapur, kur me rrathë të kuq mbaheshin në “shënjestër” të gjithë që shpreheshin lirisht dhe ndryshe nga pushteti i atëhershëm i VMRO-DPMNE, si dhe kur përpiloheshin lista, mirëpo, kësaj radhe, të inkurajuar në mënyrë shtesë me deklaratat e liderit, që në disa raste ishin jashtëzakonisht ekstreme ([Pse Apasievi do që fëmijët e dikujt të pështyjnë gjak dhe pse nuk është arrestuar?](#)<sup>33</sup>)

Se gjuha e urrejtjes mund të shndërrohet në “bombë” që paraqet kërcënim serioz për marrëdhëniet ndëretnike, ishte një nga pikat e debatit [“Urrejtja etnike nga foltorja e kuvendit”](#)<sup>34</sup>, të cilën e organizoi “Civil Media”, e në të cilën morën pjesë deputetët Latife Shikovska, Zeqir Ramçilloviq dhe Martin Kostovski.

<sup>28</sup> Shih: “Apasievi propozon radikalizim të opozitës me protesta, bllokim dhe paralizim të Kuvendit” ([Апасиев предлага радикализација на опозицијата со протести, блокади и парализа на Собранието, 360 степени, 11.11.2021](#))

<sup>29</sup> Shih: “Apasiev publikisht shan Pendarovskin” ([Апасиев јавно го цуце Пендаровски, МКД.мк, 02.07.2022](#))

<sup>30</sup> Shih: “Funksionarët nga “Levica” (E Majta) me etiketime, gjuhë urrejtjeje dhe kërcënime për përfshirje në “lista” kundër gazetarit Popetreski” ([Функционери на Левица со етикети, говор на омраза и закани за ставање на „список“ кон новинарот Попетрески, 23.06.2022](#))

<sup>31</sup> Shih: “Sulme të orkestruara me gjuhë urrejtjeje dhe dezinformata kundër fon der Lajen dhe BE” ([Оркестрирани напади со говор на омраза и дезинформации кон фон дер Лajен и ЕУ, botuar në ueb faqen e IMA, 15.07.2022](#))

<sup>32</sup> Shih: [EU’s Varhelyi: Will for enlargement is back, we’re ready to move fast, botuar në ueb faqen Euraktiv, 25.07.2022](#)

<sup>33</sup> Shih: “Pse Apasievi do që fëmijët e dikujt të pështyjnë gjak dhe pse nuk është arrestuar?” ([Зошто Апасиев сака нечии деца да пукаат крв и зошто уште не е приведен?, botuar në frontline.mk, 16.01.2021](#))

<sup>34</sup> Shih: [Urrejtja etnike në foltoren e Kuvendit, video debat i Civilmedia, 15.07.2022](#)



Nxitja me gjuhë të urrejtjes pastaj mori edhe forma tjera, siç ishte rasti me publikimin e listës me numrat e telefonave të deputetëve (“[39 numra deputetësh të shumicës në kuvend publikohen në Twitter – Thirrje për kërcënime dhe gjuhë urrejtjeje që të mos votojnë për propozimin francez](#)”<sup>35</sup>).

Jo se numrat zyrtarë të telefonave të deputetëve janë sekret shtetëror, por, kësaj radhe, ato u publikuan me thirrjen “U bëni porosi që të mos tradhtojnë popullin”, që u pasua me kërcënime, sharje dhe gjuhë tjetër urrejtjeje kundër deputetëve të shumicës qeverisëse, si presion që të votojnë kundër konkluzioneve të Qeverisë për të pranuar “propozimin francez”.

Si jehonë e debatit toksik mediatic dhe politik në opinion lidhur me “propozimin francez” dhe deklaratën për gjuhën maqedonase, gjuha e urrejtjes dhe diskriminimi u përcollën në Uikipedia, me ndërhyrje përmbajtjesore në faqet e ministrit për punë të jashtme Bujar Osmani, kryeministrit Dimitar Kovaçevski dhe kryetarit të shtetit Stevo Pendarovski ([Sulme të sinkronizuara kundër politikanëve në Uikipedia, me dezinformata, nxitje urrejtjeje dhe diskriminim](#)<sup>36</sup>).

**Komiteti i Helsinkit potencoi se gjuhën e urrejtjes e përvetësuan politikanët dhe fytyrat publike dhe i ftuan ata “të kenë kujdes se çfarë fjalori përdorin kur i drejtohen publikut”, ndërsa nga mediat kërkuan “t’i mbulojnë ngjarjet duke u udhëhequr nga parimet e objektivitetit dhe paanshmërisë gjatë raportimit”.**

Gjithçka filloi me [ndërhyrjen e hakerëve në faqen e Uikipedias që i kushtohet ministrit për punë të jashtme Bujar Osmani](#)<sup>37</sup>, kur një “administrator” deri më tani i panjohur, në orët e pasdites më 23 korrik ndryshoi përmbajtjen e faqes së Uikipedias në gjuhën angleze me emërtime fyese (një pjesë e këtyre emërtimeve për ministrin e punëve të jashtme u vërejtën edhe në pankartat e protestuesve opozitarë kundër të ashtuquajturit “propozim francez”). Pasuan ndërhyrje në faqet e kryeministrit dhe kryetarit, me fyerje, përshkrime dhe fjalor diskriminues, si sulm i organizuar propagandistik me caqe qartë të targetuara, për veprim të sinkronizuar me mbështetje nga të ashtuquajtura “ferma botësh” nga vendi, që në rrjetet sociale menjëherë postonin fotografi me ndryshimet e bëra në Uikipedia me përmbajtje fyese, urryese dhe diskriminuese, para se faqja të kthehet në përmbajtjen e zakonshme.

Ndaj përshkallëzimit të dhunës dhe gjuhës së urrejtjes reagoi edhe Komiteti i Helsinkit, duke [“dënuar çdo akt dhune dhe çdo gjuhë urrejtjeje, si dhe nxitjen dhe thirrjen për dhunë](#)<sup>38</sup>”, si gjëra jashtëzakonisht të dëmshme dhe në kundërshtim me vlerat e një shoqërie demokratike.

Komiteti i Helsinkit potencoi se gjuhën e urrejtjes e përvetësuan politikanët dhe fytyrat publike dhe i ftuan ata “të kenë kujdes se çfarë fjalori përdorin kur i drejtohen

<sup>35</sup> Shih: “39 numra deputetësh të shumicës në kuvend publikohen në Twitter – Thirrje për kërcënime dhe gjuhë urrejtjeje që të mos votojnë për propozimin francez” ([39 броеви на пратеници од мнозинството во парламентот објавени на Твитер – Повици со закани и говор на омраза за да не гласаат за францускиот предлог](#)), botuar në TV Telma, 13.07.2022

<sup>36</sup> Shih: “Sulme të sinkronizuara kundër politikanëve në Uikipedia, me dezinformata, nxitje urrejtjeje dhe diskriminim”, botuar në ueb faqen e IMA, 25.07.2022 ([Синхронизирани напади кон политичари на Википедија со дезинформации, поттикнување омраза и дискриминација, ИМА, 25.07.2022](#))

<sup>37</sup> [Rezultate të kërkimit me fjalë kyçe në agregatorin e lajmeve time.mk](#)

<sup>38</sup> Shih: Kumtesë e Komitetit të Helsinkit, botuar më 06.07.2022 ([„Апелираме за мирни протести без насилство“, соопштение на Хелсиншки комитет за човекови права, 06.07.2022](#))



publikut”, ndërsa nga mediat kërkuan “t’i mbulojnë ngjarjet duke u udhëhequr nga parimet e objektivitetit dhe paanshmërisë gjatë raportimit”.

Në këtë kontekst, edhe Komisioni për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi informoi se janë dorëzuar dhjetëra parashtrës për të vërtetuar diskriminimin në bazë të përkatësisë etnike në opinione të postuara në rrjete sociale ([Dhjetëra parashtrës për supozime se është përdorur gjuha e urrejtjes kundër bullgarëve në vend](#))<sup>39</sup>.

Dhe, kur flasim për mediat, është e domosdoshme që edhe një herë t’i rikujtojmë parimet themelore për atë se si duhet të reagojnë gazetarët dhe redaktorët ndaj gjuhës së urrejtjes, sepse, padyshim, për disa arsye të caktuara, këto parime nuk respektohen.

**Lideri dhe deputeti nga “Levica” (E Majta), Apasiev, vazhdoi me sulme të vrazhda dhe gjuhë urrejtjeje kundër gazetarëve, gjë të cilën e bën në vazhdimësi. Kësaj radhe, gazetarët e mediave që raportojnë nga Brukseli lidhur me fillimin e negociatave me BE, Apasievi i quajti “lavire dhe qullashë”**

Në një [opinion të publikuar në ueb-faqen zyrtare](#)<sup>40</sup>, ish-kryetarja e Komisionit për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi, Vesna Bendevska, thekson se “Gjuha e urrejtjes është diçka më shumë se sa vetëm fjalë të thjeshta”. Fjalori i tillë ka për qëllim të lëndojë, të fyejë, të shkatërrojë dinjitetin dhe integritetin e dikujt, të nënvlerësojë, të nënçmojë. Gjuha e urrejtjes paraqet kërcënim të vërtetë për të drejtat e njeriut, të garantuara me kushtetutën tonë dhe konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të cilat i kemi ratifikuar dhe janë pjesë e rendit tonë juridik.

Sipas KPMD, gazetarët dhe redaktorët “duhet të jenë syçelë të dallojnë diskriminimin, praktikat diskriminuese, si dhe të distancohen dhe ashpër ta dënojnë çdo gjuhë urrejtjeje”.

[Kodi i gazetarëve të Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë](#)<sup>41</sup> i obligon ata të mos flasin me gjuhën e urrejtjes:

“Gazetari nuk do të krijojë ose përpunojë me vetëdije informata që rrezikojnë të drejtat ose liritë e njeriut, nuk do të flasë me gjuhën e urrejtjes dhe nuk do të nxisë dhunë dhe diskriminim mbi asnjë bazë (nacionale, fetare, racore, gjinore, sociale, gjuhësore, të orientimit seksual, politike...)”.

Në [Doracakun për etikë në gazetari](#)<sup>42</sup> thuhet se “gjuha e urrejtjes është e panjësueshme me etikën gazetareske” dhe se “Media dhe gazetari nuk duhet të publikojnë materiale (informata, fotografi, mendime, komente) që kanë për qëllim të përhapin armiqësi ose urrejtje, ose nëse ekziston një mundësi e madhe që materiali i publikuar të shkaktojë armiqësi ose urrejtje kundër një personi tjetër për shkak të racës, përkatësisë etnike, gjinisë, fesë, përkatësisë politike, orientimit seksual, aftësive të kufizuara fizike të tij/saj etj”.

<sup>39</sup> Shih: “Dhjetëra parashtrës për supozime se është përdorur gjuha e urrejtjes kundër bullgarëve në vend” ([Десетици пријави за наводен говор на омраза против Бугарите во земјава. Канал 5 ТВ. 21.07.2022](#))

<sup>40</sup> Shih: “Bendevska: Gjuha e urrejtjes është kërcënim për ushtrimin e të drejtave të njeriut” ([Бендевска: Говорот на омраза е закана за уживањето на човековите права](#)), botuar më 21.12.2021, internet faqja e Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi

<sup>41</sup> Shih: [Kodi i gazetarëve i Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë](#)

<sup>42</sup> Shih: Doracak për etikë në gazetari ([Прирачник за етиката во новинарството. ЗНМ. 2020](#))

Madje, edhe vetë gazetarët ishin cak i sulmeve dhe gjuhës së urrejtjes në periudhën e debatit publik për “propozimin francez”, si dhe gjatë miratimit të kornizës së bisedave dhe fillimit të negociatave në Bruksel.

Lideri dhe deputeti nga “Levica” (E Majta), Apasiev, vazhdoi me sulme të vrazhda dhe gjuhë urrejtjeje kundër gazetarëve, gjë të cilën e bën në vazhdimësi. Kësaj radhe, gazetarët e mediave që raportnin nga Brukseli lidhur me fillimin e negociatave me BE, Apasievi i quajti “lavire dhe qullashë” ([Apasievi vazhdon me sulme brutale kundër gazetarëve dhe me përhapje të dezinformatave](#)<sup>43</sup>) dhe përhapte dezinformata për “gjoja konferencë politike” dhe se “negociatat do të fillojnë në ‘verën e qyqes’ (shprehje maqedonase për diçka që nuk do të ndodhë asnjëherë”, që u pasua me demant të drejtpërdrejtë nga ngjarja në Bruksel.

## Maqedonia Veriore kundër Bullgarisë: Kush ia filloi i pari?

Që nga fillimi i hapjes së çështjeve të identitetit, të cilat Bullgaria i imponoi me sukses si politikë zyrtare dhe si shkas për veton kundër fillimit të negociatave të Maqedonisë së Veriut për anëtarësim në BE, gjuha e urrejtjes është një nga konstantat të cilëve i referohet ajo.

Mirëpo, në nëntor të vitit të kaluar, hulumtimi dhe studimi i [Fondacionit për Hulumtime Humanitare dhe Sociale](#)<sup>44</sup> nga Sofja në Bullgari, tregoi se “gjuha e urrejtjes kundër Bullgarisë e cila u vërejt në mediat maqedonase, është pasojë e vetos për fillim të negociatave të Maqedonisë së Veriut me BE. Konkluzioni i Fondacionit për Hulumtime Humanitare dhe Sociale nga Sofja është se presioni i Bullgarisë ndaj Maqedonisë së Veriut për çështjet e identitetit dhe gjuhës nuk ka ndaluar “maqedonizmin”, por ka forcuar dhe zgjeruar ndikimin e tij dhe se ky presion është treguar kundërproduktiv ([Politikë kundërproduktive: Sofja ka provokuar gjuhën e urrejtjes në Shkup, konkludon studimi bullgar](#)<sup>45</sup>).

“Në vitin 2019 në mediat maqedonase nuk ka populizëm, siç ishte në Bullgari në atë periudhë, por në shtator të vitit 2020 ambienti u përkeqësua rishtas dhe për momentin ai është tmerrues”, vlerëson Dimitar Vacov, profesor i filozofisë në Universitetin e Ri Bullgar, dhe kryetar i Këshillit Drejtues të Fondacionit për Hulumtime Humanitare dhe Sociale, që realizoi hulumtimin dhe përgatiti studimin.

Duke iu referuar studimit, profesori Vacov thekson se gjendja mediatike u përshkallëzua në vitin 2020, fillimisht për shkak të intervistës së [profesorit Denko Maleski](#)<sup>46</sup> dhe qëndrimit të [Akademiës së Shkencave të Bullgarisë se gjuha maqedonase është dialekt i bullgarishtes](#)<sup>47</sup>, pas së cilës kulminacioni u arrit me deklaratën e ish-zëvendëskryeminit bullgar Krasimir Karakaçanov, i cili paralajmëroi se Sofja do t’i vendosë veto fillimit të negociatave të Maqedonisë së Veriut me BE ([Karakaçanov për TV 24: Nëse nuk ka](#)

<sup>43</sup> Shih: “Apasievi vazhdon me sulme brutale kundër gazetarëve dhe me përhapje të dezinformatave” ([Апасиев продолжува со брутални напади врз новинарите и ширење дезинформации, botuar në ueb faqen e IMA, 20.07.2022](#))

<sup>44</sup> Shih: <https://hssfoundation.org/>

<sup>45</sup> Shih: “Politikë kundërproduktive: Sofja ka provokuar gjuhën e urrejtjes në Shkup, konkludon studimi bullgar”, botuar në Dojçe Vele maqedonisht, 17.11.2021 ([Контрапродуктивна политика: Софија го предизвикала говорот на омраза во Скопје, заклучува бугарска студија, DW на македонски, 17.11.2021](#))

<sup>46</sup> Shih: “Çfarë tha saktë Denko Maleski për TV Evropën bullgare” ([Што точно рече Денко Малески за бугарската ТВ Европа?, 360.мк, 29.04.2022](#))

<sup>47</sup> [Rezultate nga kërkimi me fjalë kyçe në agregatorin e lajmeve time.mk](#)

[avancim lidhur me çështjet historike, Bullgaria do ta bllokojë konferencën e parë ndërqeveritare me BE](#),<sup>48</sup>).

"Nga 9 shtatori (viti 2020, v.j.) deri në fund të vitit, diskursi maqedonas shënon rritje të madhe. Atëherë fillon edhe diskursi antibullgar. Vetëm për Goce Dellçevin dhe derivate të rrënjës "bullgar/e" ka 3033 tekste. Deri para deklaratës së Karakaçanovit më 9 shtator, ka 710 tekste që flasin për Goce Dellçevin. E për katër muaj, deri në fund të vitit, ka 2323 tekste", [sqaron Vacov](#).

Studimi i mjedisit mediatik në Maqedoninë e Veriut nga Fondacioni për Hulumtime Humanitare dhe Sociale për vitin 2019 dhe 2020, tregon se në raport me vitin paraprak 2019, në vitin 2020 është dyfishuar edhe numri i teksteve në të cilat flitet për "fashistë" dhe "okupatorë fashistë".

Dhe, nëse këto të dhëna, të sistematizuara në këtë mënyrë, shkojnë në favor të përgjigjes për pyetjen "Kush ia filloi i pari?", ato gjithsesi nuk japin përgjigjen e pyetjeve më me rëndësi – kur do të përfundojë e gjithë kjo dhe a kanë Sofja dhe Shkupi mënyrë efikase për të ndikuar në eliminimin e gjuhës së urrejtjes në të dy vendet.

[Protokollin nga Takimi i dytë i Komisionit të përbashkët ndërqeveritar, i formuar në bazë të nenit 12 të Marrëveshjes për Miqësi, Fqinjësi të Mirë dhe Bashkëpunim ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Bullgarisë](#)<sup>49</sup> i datës 17 korrik të vitit 2022, obligon të dyja palët të identifikojnë dhe të ndërmarrin masa kundër gjuhës së urrejtjes në mbishkrime të objekteve publike dhe monumenteve, tekste dhe programe shkollore, si dhe në hapësira publike, që si detyrë do të merret përsipër nga ministrinë për punë të jashtme të Bullgarisë dhe Maqedonisë së Veriut për t'i kontaktuar dhe informuar institucionet kompetente me qëllim të identifikimit të përbashkët të rasteve të tilla.

Lidhur me gjuhën e urrejtjes Protokollin në mënyrë plotësuese parasheh që shtetet të ndërmarrin masa efikase për parandalimin e propagandës jo qëllimshme nga ana e institucioneve dhe agjencive, si dhe do të dekurajojnë aktivitetet e subjekteve private, të drejtuara në nxitje të dhunës, urrejtjes ose aktivitetëve tjera të ngjashme, që do të dëmtonin marrëdhëniet e ndërsjella.

Ajo që imponohet si domosdoshmëri dhe detyrim i Qeverisë së Maqedonisë së Veriut, gjegjësisht Ministrisë për Punë të Jashtme, është nevoja për sqarime plotësuese lidhur me dispozitat e protokollit, e që kanë të bëjnë me gjuhën e urrejtjes, me argumente bindëse se parandalimi i gjuhës së urrejtjes nuk do të jetë instrument censurimi që do ta mohojë lirinë e të shprehurit dhe do të përshtatë narracionet në kulturë dhe krijimtari.

Po ashtu, është e domosdoshme të qartësohet se detyrimet për luftë kundër gjuhës së urrejtjes janë krejtësisht reciproke dhe se gjuha e urrejtjes trajtohet vetëm në aspekt të së drejtës së BE dhe të drejtës ndërkombëtare në të dy shtetet, e jo sipas interpretimeve arbitrare oportuniste që zakonisht mund të keqpërdoren.

<sup>48</sup> Shih: "Karakaçanov për TV 24: Nëse nuk ka avancim lidhur me çështjet historike, Bullgaria do ta bllokojë konferencën e parë ndërqeveritare me BE" ([Каракачанов за ТВ 24: Бугарија ќе ја блокира првата меѓувладинска конференција со ЕУ ако нема напредок по историските прашања](#)), botuar në 360.mk, 09.09.2020

<sup>49</sup> Shih: Protokollin nga Takimi i dytë i Komisionit të përbashkët ndërqeveritar, i formuar në bazë të nenit 12 të Marrëveshjes për Miqësi, Fqinjësi të Mirë dhe Bashkëpunim ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Bullgarisë botuar në [MIA](#), 17.07.2022

## Maqedonia e Veriut në evolucionin e propagandës me gjuhë urrejtjeje në trekëndëshin ballkanik

Për ta përmbyllur trekëndëshin ballkanik, në të cilin Maqedonia e Veriut u gjend si mjedis i përshtatshëm për gjuhë urrejtjeje, do t'u referohemi disa studimeve dhe analizave, që japin perceptimin se gjenerator dhe frymëzues i propagandës me gjuhë urrejtjeje dhe dezinformata është Rusia, duke marrë parasysh këtu edhe studimin e Parlamentit Evropian të vitit 2021, “[Mapping Fake News and Disinformation in the Western Balkans and Identifying Ways to Effectively Counter Them](#)”<sup>50</sup>, që konkludon se aktorët e huaj nuk janë fajtorët më të shquar dhe se numri më i madh i individëve dhe organizatave që prodhojnë gjuhë urrejtjeje dhe përhapin dezinformata janë vendas.

Si mbështetje vlerësimit të këtillë mund të merren parasysh konstatimet nga një numër studimesh në Maqedoninë e Veriut, Bullgari dhe Bosnjë e Hercegovinë.

Në serinë e [analizave për ndikimin rus në Maqedoninë e Veriut, analisti mediatik Zharko Trajanoski](#)<sup>51</sup>, ndoshta analisti i vetëm që në mënyrë të thuktë dhe në vazhdimësi ndjek këtë temë, thotë se “sa i përket temës për ‘ndikimin rus’ dhe ‘skenarin ukrainas’, na ka marrë lumë që moti (shih [analizën 1](#)<sup>52</sup> dhe analizën 2<sup>53</sup>), kur në dhjetor të vitit 2017 propagandistët rusë publikonin parashikime të errëta për zhdukjen e Maqedonisë nga harta botërore dhe për ndarje të Maqedonisë ndërmjet Shqipërisë dhe Bullgarisë ([Shih-ni ANALIZËN E ANDREJ KORIBKOS: A do të zhduket Maqedonia nga harta e botës në vitin 2018?](#)<sup>54</sup>).

Trajanoski po ashtu shton se “zëdhënësit lokalë rusë [shpërndanin](#)<sup>55</sup> parashikime apokaliptike se “Maqedonia është zgjedhur si vendi ku do të fillojë lufta e radhës, gjegjësisht konflikti botëror ndërmjet NATO dhe Rusisë”.

Ofensiva e propagandës ruse kundër NATO dhe BE u intensifikua në shkurt dhe në mars të vitit 2018, kur tanimë paralajmëroheshin sinjale pozitive për zgjedhjen e kontestit me Greqinë për emrin, që ishte parakusht për anëtarësi të Republikës së Maqedonisë në NATO ([Athina pret përparim pas takimit Zaev-Cipras në Davos](#)<sup>56</sup>).

Në atë ofensivë, krahas fokusit drejtuar NATO-s, si viktimë e “zjarrit miqësor” u apostrofuhan edhe marrëdhëniet ndëretnike në vend, me gjuhë urrejtjeje kundër shqiptarëve në Maqedoni.

Trajanoski përkujton se “në emisionin më të shikuar të asaj kohe “Vetëm e vërteta” më [20 shkurt](#)<sup>57</sup> të vitit 2018, ‘debatonin’ dy propagandistë pro-rusë lidhur me temën “A

<sup>50</sup> Shih: [Mapping Fake News and Disinformation in the Western Balkans and Identifying Ways to Effectively Counter Them](#), botuar në 23.02.2021, internet faqja e Parlamentit Evropian

<sup>51</sup> Rezultatet e kërkimit me fjalë kyçe për analizën e Zarko Trajanoskit për ndikimin rus në Maqedoninë e Veriut

<sup>52</sup> Shih: “Propaganda ruse gjatë krizës politike maqedonase (2015) - dezinformata për “skenarin ukrainas”” ([Руската пропаганда за време на македонската политичка криза \(2015\) – дезинформации за „украинско сценарио“](#)), botuar në ueb faqen Vërtetëmatësi më 10.02.2022

<sup>53</sup> Shih: Propaganda ruse për “skenarin ukrainas” në Maqedoni ([Руската пропаганда за „украинското сценарио“ во Македонија \(2016-2017\)](#), botuar në Vërtetëmatës më 23.02.2022

<sup>54</sup> Shih: “ANALIZA E ANDREJ KORIBKO: A do të zhduket Maqedonia nga harta botërore në vitin 2018?” [АНАЛИЗА НА АНДРЕЈ КОРИБКО: Ќе ја снеса ли Македонија од картата на светот во 2018 година?](#), botuar në infomax.mk, 02.12.2017

<sup>55</sup> Shih: “Milenko i kërkon Rusisë të ndërhyjë dhe t'i nxjerrë nga burgu Batman gënjeshtarin dhe Borisin!, kolumnë e Milenko Nedelkovskit” ([Миленко бара од Русија да интервенира и да ги извадела од затвор Бетмен лежит и Борис!](#), kolumna на Milenko Nedelkovski), botuar në portalin Zëri i popullit (Народен глас), 01.12.2017

<sup>56</sup> Shih: “Athina pret përparim pas takimit Zaev-Cipras në Davos” ([Атина очекува напредок по средбата Заев-Ципрас во Давос](#), botuar DW maqedonisht më 23.01.2018

<sup>57</sup> Shih: Aleksandar Rusjakov dhe Stefan Vlahov Micov në emisionin “Vetëm e vërteta” në TV Kanal 5 më 20.02.2018 ([Александар Русјаков и Стефан Влахов Мицов во „Само вистина“ на Канал 5 ТВ на 20.02.2018](#))

ka Maqedonia alternativa të BE dhe NATO?". Mysafirët ishin në një vijë sa i përket fushatës negative kundër BE dhe NATO, si dhe në denigrimin e qeverisë properëndimore dhe përqeshjen e ithtarëve për anëtarësim në NATO dhe BE. Në emisionin e njëjtë, përfaqësuesi i "Edinstvena Makedonija" (Maqedonia Unike) u drejtua me porosi eksplicite antishqiptare duke thënë se shqiptarët "do të kenë dy mundësi – ose të fillojnë ta mësojnë rusishten ose të mësojnë të notojnë, dhe këtë e them shumë seriozisht".

Lideri i "Edinstvena Makedonija" (Maqedonia Unike), Baçev, [pohonte](#)<sup>58</sup> se "aleanca strategjike me Rusinë siguron ekzistencën dhe ardhmërinë e Maqedonisë", ndërsa mysafire në "Vetëm e vërteta" në [mars](#)<sup>59</sup> ishte edhe kolumnistja, profesoresha Biljana Vankovska, si një nga nënshkrueset e para të deklarimit [manipulues](#)<sup>60</sup> të intelektualëve që kërkonin ndërprerjen e negociatave për emrin. Vankovska, autore e kolumnës [Çmimi Nobel për Putinin: E, pse jo?](#)<sup>61</sup> (në "Ruska reç"), më herët kishte promovuar sloganin "[JO për NATO, madje as me emrin kushtetues!](#)"<sup>62</sup>.

Përveç përpjekjeve për frikësim me "[shqiptarizim brutal](#)"<sup>63</sup>, propagandistët përdornin adutin e "antifashizmit", duke paraqitur Perëndimin si fashizoid, si dhe adutin e alternativës politike brenda Bashkimit Euroaziatik dhe "vëllazërisë sllave" ([Propagandisti Dugin, satanizimi i Perëndimit dhe apologjia e imperializmit rus](#))<sup>64</sup>, të cilën në Maqedoni e promovonte propagandisti dhe gjeopolitikani rus [Aleksandar Dugin, të cilin publiku ynë e njohu që në vitin 2015 kur ishte mysafir i Milenko Nedellkovskit](#).<sup>65</sup>

Është interesant fakti se po këtë vit (2015), menjëherë pas aneksimit rus të Krimesë dhe luftës në Ukrainë, kur intensiteti i fushatave dezinformuese, përfshirë edhe gjuhën e urrejtjes, mori përmasa brengosëse, BE dhe NATO edhe zyrtarisht i kualifikuan kërcënimet e propagandës ruse si jashtëzakonisht serioze, të cilat kërkojnë përgjigje përkatëse.

Në studimin [Russia's Strategic Interests and Tools of Influence in the Western Balkans](#)<sup>66</sup> (Interesat Strategjike dhe Mjetet për Ndikim të Rusisë në Ballkanin Perëndimor) e Qendrës për Komunikime të Përkryera Strategjike pranë NATO-s ([Strategic Communications Centre of Excellence](#)), autori [Dimitar Baçev](#)<sup>67</sup> konstaton se "qëllimi kryesor i Rusisë në Ballkanin Perëndimor nuk është ta revidojë status-kononë, por ta ngrijë atë. Ajo dëshiron ta parandalojë zgjerimin e NATO-s dhe ta ngadalësojë zgjerimin e BE-së. Situata e tanishme është në pajtim me interesat strategjike të Rusisë. Ballkani Perëndi-

<sup>58</sup> Shih: Janko Baçev dhe Toni Naunoski në emisionin "Vetëm e vërteta" në TV Kanal 5 më 09.03.2018, botuar në Fb faqen e partisë Maqedonia Unike ([Јанко Бачев и Тони Науноски во „Само вистина“ на Канал 5 ТВ на 09.03.2018. ФБ Единствена Македонија](#))

<sup>59</sup> Shih: Biljana Vankovska në emisionin "Vetëm e vërteta" ([Билјана Ванковска во „Само вистина“, TV Kanal 5, më 13.03.2018](#))

<sup>60</sup> Shih: "TOP 5 manipulimet më të mëdha në 2018 për anëtarësimin e Maqedonisë në NATO" ([ТОП 5 најголеми манипулации во 2018 година за македонското членство во НАТО](#)), botuar në Vërtetëmatës, më 24.12.2018

<sup>61</sup> Shih: Çmimi Nobel për Putinin: E pse jo?, kolumnën e Biljana Vankovska ([Нобелова награда за Путин: А. зошто не?, колумна на Билјана Ванковска](#)), botuar më 17.10.2013

<sup>62</sup> Shih: "Kolumnë e Biljana Vankovska: Maqedonia ose NATO? #Thuaj tash" ([КОЛУМНА НА БИЛЈАНА ВАНКОВСКА: Македонија или НАТО? #Сега кажи!](#)), botuar në infomax.mk, më 22.01.2018

<sup>63</sup> Shih: "Zaev bëri një shqiptarizim brutal të organeve shtetërore me administratorë shqiptarë" ([Заев врши брутална албанизација на државните органи со административци-Албанци](#)), botuar në internet faqen e partisë Maqedonia Unike, më 22.03.2018

<sup>64</sup> Shih: "Propagandisti Dugin, satanizimi I Perëndimit dhe apologjia e imperializmit rus" ([Пропандистот Дугин, сатанизацијата на Западот и апологијата на рускиот империјализам](#)), botuar në portalin Vërtetëmatës, më 23.03.2022

<sup>65</sup> Shih: "Milenko Nedellkovski Shou me Aleksandar Dugin" ([Миленко Неделковски шоу со Александар Дугин](#)), më 18.12.2015)

<sup>66</sup> Shih: [Russia's Strategic Interests and Tools of Influence in the Western Balkans](#), botuar më 05.12.2019

<sup>67</sup> Shih: [Këshilli Atlantik, Dimitar Baçev](#)

mor është joformalisht i integruar në Perëndim, por nuk kishte konsolidim të brendshëm demokratik ose zgjidhje përfundimtare të konflikteve mes shteteve. Moska ka dobi nga problemet ekzistuese në këtë rajon, e jo të krijojë të reja: konteste të hapura që datojnë që nga luftërat e viteve të '90-ta, raportin dashuri-urrejtje me Perëndimin, institucione të dobëta, sundimin e komprometuar të së drejtës, ekonomi të brishta dhe mungesë të përgjithshme të transparencës dhe llogaridhënies”.

Beçev konkludon se “në një ambient të tillë politik (të Ballkanit Perëndimor, v.y.) Rusia projekton ndikimin e saj, duke përfunduar pozicionin e vet në politikën evropiane dhe, në masë më të vogël, edhe në nivel global. Për Moskën, Ballkani Perëndimor është një fryt peme që mbërrihet me një të zgjatur dore. Rusia preferon të ndikojë pa shumë resurse dhe kryesisht me ndihmën e bashkëpunëtorëve lokalë. Për këtë arsye, politika ruse në rajon kryesisht është e fokusuar në kooptimin dhe metodat subversive, në vend të formave ushtarake ose jo ushtarake të detyrimit. Në vend që të zhvendosë ushtarë në ish-Jugosllavi për ta rritur balancën lokale të forcave në një mënyrë apo tjetrën, Rusia mbështetet në intervenimin politik përmes iniciativave diplomatike, ndërhyrjen në politikën e brendshme dhe në fushata informative”.

Viti 2015 edhe një herë paraqitet si pikë referimi për propagandën ruse në Ballkan. Atë vit, menjëherë pas aneksimit të Krimesë dhe luftës së parë në Ukrainë, Federata Ruse hapi radio-stacionin Sputnik në Serbi, që pas një kohe u zgjerua me Agjencinë Sputnik. Radioja dhe agjencia Sputnik kanë rolin e një platforme rajonale me shërbim informativ në gjuhën serbe që ka sinjal në gjithë rajonin, të plotësuar me rrjet të mbi tridhjetë stacioneve rajonale. Përmbajtjet e radios dhe agjencisë shpërndahen edhe në mediat lokale të shtypura dhe *online*, përfshirë këtu edhe mediat rozë me tirazh të lartë dhe TV stacionet me shikueshmëri të madhe si Blic, Kurir, Informer, Veçernje Novosti dhe B92.

Prania e Rusisë në hapësirën informative të Ballkanit Perëndimor, sipas studimit [Russia's Strategic Interests and Tools of Influence in the Western Balkans](#)<sup>68</sup> të Dimitar Beçevit, është në boshtin e aktiviteteve të Kremlinit, nëse e kemi parasysh se [Sputnik është themeluar me dekret](#)<sup>69</sup> të Vladimir Putinit.

Zonat e ndikimit të Sputnik, përveç në Serbi dhe Bosnjë e Hercegovinë me theks në Republika Sërpska, kanë shtrirje edhe në Malin e Zi, popullatën serbe në Kosovë dhe, deri diku edhe në Maqedoninë e Veriut.

Në Maqedoninë e Veriut, Sputnik nuk ka mediat e veta dhe zakonisht vepron përmes “proksi” mediave në vend dhe kryesisht përmes rrjeteve sociale, në periudha kur në vend zhvillohen procese politike që ndërlidhen me qëllimet strategjike ose gjatë fushatave zgjedhore.

Veprimtaria e shërbimeve ruse të informimit në Maqedoninë e Veriut është regjistruar në më shumë raste në: [Sputnik Analyst Claims Macedonians Dislike EU and NATO. Polls Show Majority Support](#)<sup>70</sup>, [#ElectionWatch: Sputnik Misleading in Macedonia](#)<sup>71</sup>.

Një margaritar i rrallë në kronologjinë e aktiviteteve propagandistike të Sputnik kundër Maqedonisë së Veriut është teksti me titullin “Politikani bullgar: Është çështje kohe kur Maqedonia do të kërkojë një pjesë të Bullgarisë”, të cilën e transmetuan një numër i mediave serbe dhe që megjithatë u zbulua nga servisi për verifikimin e fakteve

<sup>68</sup> Shih: [Russia's Strategic Interests and Tools of Influence in the Western Balkans](#), botuar më 05.12.2019

<sup>69</sup> Shih: [Sputnik \(news agency\). Wikipedia, the free encyclopedia](#)

<sup>70</sup> Shih: [Sputnik Analyst Claims Macedonians Dislike EU and NATO. Polls Show Majority Support](#), botuar në portalin për verifikimin e fakteve [poligraf.info](#), më 28.09.2018

<sup>71</sup> Shih: [#ElectionWatch: Sputnik Misleading in Macedonia](#), објавено на порталот Медиум на 23.09.2018

"Vistinomer" (Vërtetëmatësi) i Fondacionit Metamorfozis ([Serbian news agency Sputnik is frightening the Bulgarians that Macedonia might have territorial appetites towards Bulgaria](#)).<sup>72</sup>

Dhe kur flasim për Bullgarinë, në këtë shtet propaganda ruse ka model të ngjashëm si Sputniku në Serbi, me atë që rolin e shpërndarësve të përmbajtjeve mediatike në interes të Kremlinit këtu e marrin përsipër më shumë agregatë apo portale si "Novini 247", "Pogled info", "Aspekto", "News Front"... ([Проф. Димитър Вацов: Лъжата не е алтернативна гледна точка и никога не е била](#)).<sup>73</sup>

## Zgjidhje është edukimi dhe zbatimi i ligjeve

Gjatë fushatës së gjuhës së urrejtjes që përcillte procesin e diskutimit dhe konsultimit publik për "propozimin francez" lidhur me atë se çka ndërmerret për të sanksionuar këtë vepër penale, ministri për punë të brendshme, Oliver Spasovski, iu përgjigj pyetjes së një deputeteje në Kuvendin e Maqedonisë së Veriut, se në vitin 2022 nuk ka vepër penale për shkaktim urrejtjeje dhe se në proces e sipër është vetëm një vepër për rrezikim të sigurisë përmes mjeteve elektronike ([Spasovski: Në vitin 2022 nuk ka vepër penale për shkaktim urrejtjeje dhe vetëm një vepër për rrezikim të sigurisë në mënyrë elektronike](#)).<sup>74</sup>

Spasovski saktësoi se kjo statistikë nuk tregon zvogëlim të gjuhës së urrejtjes, por se në këtë periudhë nuk ka pasur parashpresa.

Kjo edhe një herë flet për faktin se njohja dhe denoncimi i gjuhës së urrejtjes dhe veprave nga urrejtja nuk përkon me rritjen e gjuhën e urrejtjes dy vitet e fundit, ku mbizotëron gjuha politike e urrejtjes si rezultat i krizës së vazhdueshme politike, e cila polarizoi mediat, por edhe shoqërinë në përgjithësi.

**Fjalimet politike të ngjeshura me gjuhë urrejtjeje shkaktonin ndasi mes qytetarëve, politikanëve, aktivistëve dhe mediave në "patriotë" dhe "tradhtarë", ndërsa intensiteti i përmbajtjeve fyese përplot urrejtje shënonte rritje si në media, ashtu edhe në rrjetet sociale.**

Fjalimet politike të ngjeshura me gjuhë urrejtjeje shkaktonin ndasi mes qytetarëve, politikanëve, aktivistëve dhe mediave në "patriotë" dhe "tradhtarë", ndërsa intensiteti i përmbajtjeve fyese përplot urrejtje shënonte rritje si në media, ashtu edhe në rrjetet sociale.

Në kontekst të kësaj situatë, përshtypja e opinionit publik maqedonas për luftën kundër gjuhës së urrejtjes në vend është se ajo bëhet vetëm deklarativisht, edhe pse gjuha e urrejtjes është e përfshirë në Kodin Penal. Për shembull, neni 319 i KP parasheh se nxitja e urrejtjes, ndasive ose jotolerancës në bazë nacionale, racore dhe në bazë tjetër diskriminuuese, dënohet nga një deri në pesë

<sup>72</sup> Shih: [Serbian news agency Sputnik is frightening the Bulgarians that Macedonia might have territorial appetites toward Bulgaria, botuar në portalin e agjencisë META më 18.12.2019](#)

<sup>73</sup> Shih: [Проф. Димитър Вацов: Лъжата не е алтернативна гледна точка и никога не е била, botuar në portalin БНР бр më 15.04.2022](#)

<sup>74</sup> Shih: "Spasovski: "Në vitin 2022 anuk ka vepër penale për shkaktim të urrejtjes dhe ka vetëm një vepër penale për rrezikim të sigurisë përmes pajisjeve elektronike" ([Спасовски: Во 2022 нема кривично дело за предизвикување на омраза и само едно дело за загрозување на сигурноста по електронски пат](#)), botuar në ueb faqen e IMAI më 30.06.2022



vjet burgim, ndërsa dënim me 10 vjet burgim sipas këtij neni parashihet nëse vepra shkakton trazira dhe dhunë kundër njerëzve ose pronës. KP në nenin 394-d sanksionon edhe shpërndarjen e materialeve raciste dhe ksenofobe përmes sistemit kompjuterik.

Kjo situatë sërish na kthen te pyetja për efikasitetin e prokurorisë dhe pavarësisë së gjyqësorit, si dhe në pyetjen për gatishmërinë e organeve rregullatore dhe vetërregulluese mediatike, në përputhje me normat dhe standardet e pranuar ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, për të dhënë kontributin e tyre në parandalimin e nxitjes së urrejtjes si “lëndë djegëse” për konflikte në shoqëri.

**Vetëm qytetarë të informuar, mediatikisht të arsimuar, mund të bëjnë zgjedhje racionale, e jo emocionale, dhe, për këtë shkak, përfshirja e edukimit mediatik dhe digjital në programet arsimore mund ta ndalojë zjarrin që ndezin propagandistët me gjuhën e tyre të urrejtjes.**

Përvoja tregon se vetërregullimi i mediave, aty ku është efikas, mbetet një nga mënyrat për t’iu kundërvënë gjuhës së urrejtjes dhe për t’iu përgjigjur në mënyrë përkatëse kësaj çështjeje. Përmes vetërregullimit, mediat ushtrojnë përgjegjësinë e vet morale dhe shoqërore, përfshirë edhe aktivitetet për balafaqim adekuat me propagandën e urrejtjes dhe diskriminimit. Kodet etike dhe instrumentet e vetërregullimit dhe ko-rregullimit duhet të garantojnë se rastet e propagandës do të zbulohen dhe ekspozohen në vazhdimësi, e po ashtu do t’i prezentohen edhe publikut.

Nga ana tjetër, vetëm qytetarë të informuar, mediatikisht të arsimuar, mund të bëjnë zgjedhje racionale, e jo emocionale, dhe, për këtë shkak, përfshirja e edukimit mediatik dhe digjital në programet arsimore mund ta ndalojë zjarrin që ndezin propagandistët me gjuhën e tyre të urrejtjes.

Qeveria nuk duhet më të humbë kohë për të investuar në programe të tilla arsimore dhe duhet sa më parë ta zgjedhë modelin më të përshtatshëm, që duhet ta kompensojë shumë shpejt atë që për vite të tëra është lënë mangët në këtë drejtim.





## 2. DEZINFORMATATA, MANIPULIME MEDIATIKE DHE TEORI TË KONSPIRACIONIT PËR “PROPOZIMIN FRANCEZ”

Shkruan: ZHARKO TRAJANOSKI

Korniza negociuese e BE-së (i ashtuquajtur “propozimi francez”) ka qenë një temë dominuese mediatike dhe socio-politike në disa muajt e fundit. “Propozimi francez” shkaktoi një vërshim të dezinformatave, manipulimeve mediatike dhe teorive të konspiracionit në mediat dhe komunikimet publike në Maqedoni. E gjithë kjo ndikoi negativisht në debatin publik, i cili ishte i polarizuar dhe i rënduar me gjuhë që nxit urrejtje, jotolerancë, e kohë pas kohe edhe dhunë.

Në këtë analizë do të vështrojmë narracionet kryesore që përmbanin dezinformata, manipulime mediatike dhe teori të konspiracionit në lidhje me «propozimin francez», të cilat mund të identifikohen në titujt dhe përmbajtjet e artikujve mediatikë, në komunikimet politike publike, në mesazhet nga protestat, si. dhe në komunikimet në rrjetet sociale në Maqedoni.

**Narracionet dezinformuese në Maqedoni u përpoqën të ngrenë panik social, të nxisin mosbesimin ndaj institucioneve, të nxisin urrejtje, jotolerancë dhe polarizim në shoqëri. Disa prej tyre kishin për qëllim të shkaktojnë çorientim dhe destabilizim politik, e disa ishin në funksion të mobilizimit politik për të shkaktuar ndryshim të pushtetit qendror.**

Gjithashtu, në këtë analizë nuk janë të përfshira dezinformatat, manipulimet mediatike dhe teoritë e konspiracionit në lidhje me “propozimin francez” dhe veton bullgare në Bullgari, të cilat padyshim patën ndikim në ndezjen e diskurseve nacionaliste në Maqedoni, por që meritojnë një analizë të veçantë. Po kështu, nuk janë të përpunuara as dezinformatat në mediat në gjuhën shqipe, të cilat trajtohen në një analizë të veçantë.<sup>1</sup>

Në analizë nuk përfshihen kritikata e argumentuara për kornizën negociuese, për mostransparencën e qeverisë, për komisionet historike, për qëndrimet e BE-së etj.

Narracionet dezinformuese në Maqedoni u përpoqën të ngrenë panik social, të nxisin mosbesimin ndaj institucioneve, të nxisin urrejtje, jotolerancë dhe polarizim në shoqëri. Disa prej tyre kishin për qëllim të shkaktojnë çorientim dhe destabilizim politik, e disa ishin në funksion të mobilizimit politik për të shkaktuar ndryshim të pushtetit qendror.

### Narracione me dezinformata dhe manipulime mediatike për gjuhën maqedonase

Edhe para publikimit zyrtar të kornizës së negociatave me BE-në, u shfaqën tituj sensacionalistë dhe interpretime tendencioze që ngritën panik social, se versioni fillimisht i publikuar i “propozimit francez” paska përmbajtur një riemërtim të gjuhës maqedonase.

<sup>1</sup> Shih: Sefer Tahiri, “[Si raportuan mediat në gjuhën shqipe për propozimin francez](#)”, IMA, 30.07.2022

donase. Më tepër portale në gjuhën maqedonase publikuan tituj me informacionin se në “propozimin francez” gjuha maqedonase është emërtuar si “gjuha maqedonase numër 2” / “gjuha maqedonase 2”, ose se “ka marrë shënjimin 2”. Përfundimet e gabuara janë nxjerrë nga simboli i fusnotës pas shprehjes “gjuha maqedonase”.<sup>2</sup>

Në media u përhap edhe dezinformata e një akademikeje se “kishte vetëm një fusnotë se gjuha maqedonase është dialekt i bullgarishtes”.<sup>3</sup> Paso një përgënjeshtim nga ana e kryeministrit, i cili deklaroi se ka pasur shumë gënjeshtra dhe spekulime lidhur me propozimin francez, dhe se “Nuk ka fusnota dhe shtesa, këto janë gënjeshtra”.<sup>4</sup>

U përhap edhe dezinformata se „[Gjuha maqedonase nuk është në propozim](#)” (në kumtesë të VMRO-DPMNE-së) e cila u zbulua nga Vërtetëmatësi.<sup>5</sup>

Lideri i VMRO-DPMNE-së dezinformoi se pranimi i një propozimi të tillë nënkupton “se gjuha maqedonase është dialekt i bullgarishtes”<sup>6</sup>, ndërsa edhe partia “Levica” (E Majta) e kundërshtoi publikisht me qëndrimin se “gjuha maqedonase nuk është një dialekt dhe fusnotë”. Megjithatë, siç theksohet në përmbajtjen e Vërtetëmatësit, “në vetë propozimin francez nuk përmenden fusnota dhe dialekte, siç synohet të imponohet në statusin e partisë E Majta”.<sup>7</sup>

Po ashtu, pretendimi i partisë E Majta se “vetëm për ne gjuha do të jetë maqedonase” nuk ka asnjëfarë baze në korinazën negociuese.<sup>8</sup>

Dezinformatat vazhduan edhe pasi presidenti francez Macron [theksoi](#) se “Kjo marrëveshje nuk e vë në dyshim ekzistencën zyrtare të gjuhës maqedonase, e cila është pjesë përbërëse e identitetit tuaj”. Megjithatë, protestat dhe bllokadat kundër “propozimit francez” arsyetoheshin me shprehjen “[mbrojtja e gjuhës, popullit dhe shtetit maqedonas](#)”.<sup>9</sup>

Më 07.11.2022, LSDM publikoi një video të liderit të VMRO-DPMNE Mickoski në një televizion serb, ku ai gabimisht pretendon se gjuha maqedonase është kodifikuar në “[vitin e largët 1977](#)”, gjë që u vlerësua si një pretendim i turpshëm.<sup>10</sup>

Dezinformata dhe manipulime mediatike përmbante edhe “Manifesti i mësuesve maqedonas” për gjuhën maqedonase, në të cilin ka [pretendime](#) të pabaza se “gjuha maqedonase, sipas këtij propozimi, do të jetë historikisht inekzistente për BE-në” dhe se

<sup>2</sup> Një pjesë e tekstit jozyrtar është keqinterpretuar si “gjuha maqedonase numër 2” ose “gjuha maqedonase 2”. Shihni më shumë në [Dezinformata të reja sensacionale për gjuhën maqedonase, tani në “Propozimin francez”](#), IMA, 21.06.2022

<sup>3</sup> Katica Qullafkova paralajmëron për tradhëti të lartë: Maqedonia është në prag të shpërbërjes së plotë ([Катица Кулафкова предупредува на велепредавство: Македонија е на прагот на целосна разнебитеност](#)), A1on, 02.07.2022.

<sup>4</sup> Shih: “Kovačevski: Nuk ka fusnota dhe shtesa, këto janë gënjeshtra” ([Ковачевски: Нема никакви фусноти и дополнувања, тоа се лаги](#)), A1on, 02.07.2022.

<sup>5</sup> Shih: Vladimir Petrevski, “Dezinformatat dhe manipulimet për dhe rreth propozimit francez” ([Дезинформациите и манипулациите за и околу францускиот предлог](#), Вистиномер, 07.07.2022).

<sup>6</sup> Shih: “Mickoski nuk e përranon propozimin francez” ([Мицкоски не го прифаќа францускиот предлог](#), Дојче Веле, 01.07.2022)

<sup>7</sup> Shih: Vladimir Petrevski, “Dezinformatat dhe manipulimet për dhe rreth propozimit francez” (Владимир Петрески, [Дезинформациите и манипулациите за и околу францускиот предлог](#), Вистиномер, 07.07.2022).

<sup>8</sup> Shih: “Edhe Levica thirri për protestë gjithëpopullore kundër propozimit francez” ([И Левица повика на сенароден протест против францускиот предлог](#), mkd.mk, 01.07.2022)

<sup>9</sup> Shih: “Bocevi: Nesër nga ora 13 fillojmë bllokada në mbarë vendin, përderisa deputetët tanë trima luftojnë në Kuvend për interesat tona për mbrojtje të gjuhës, popullit dhe shtetit maqedonas” ([Боцевски: Утре од 13 часот започнуваме блокади низ цената држава, додека нашите храбри пратеници се борат во Собранието за нашите интереси за одбрана на македонскиот јазик, народ и држава](#), Курир, 7.07.2022)

<sup>10</sup> Shih: “Kuzeska: Mickoski e rrënon gjuhën maqedonase, pretendon turpshëm se është kodifikuar në vitin 1977” ([Кузеска: Мицкоски го руши македонскиот јазик, срамно тврди дека е кодификуван 1977 година](#), Канал 5, 11.07.2022)

“Propozimi francez... do t’i reduktojë popullin maqedonas dhe [gjuhën maqedonase në një deklaratë të njëanshme që nuk ka vlerë para institucioneve të BE-së](#).”<sup>11</sup>

Edhe gjatë diskutimit parlamentar ranë në sy akuzat e pabaza për gjuhën maqedonase: “...për një grusht para këta janë gati të thonë se [gjuha maqedonase është dialekt bullgar...](#)”, akuzoi një deputete e opozitës.<sup>12</sup> VMRO-DPMNE në një kumtesë partiake theksoi se “nuk do të pranohet marrëveshje që do të thotë mohim i gjuhës, identitetit dhe veçantisë maqedonase”.<sup>13</sup>

Manipulimet politike dhe dezinformatat për gjuhën maqedonase vazhduan edhe pas publikimit të deklaratave të njëanshme të Maqedonisë së Veriut dhe Bullgarisë. Simptomatikisht, deklaratat e njëanshme e qeverisë maqedonase ishte më shumë cak i sulmeve propagandistike me interpretime të gabuara se ka heqje dorë nga dialektet sesa deklaratat e njëanshme e qeverisë bullgare në të cilën gjuha maqedonase nuk njihet shprehimisht.<sup>14</sup> Profesori Ludmill Spasov theksoi se [nuk ka heqje dorë nga dialektet, por definim të gjuhës së standardizuar maqedonase](#), dhe për këtë arsye ai më pas ishte cak i sulmeve shpifëse propagandistike.<sup>15</sup>

Madje, u shpërndanë dezinformata se [qeveria aktuale e ka riemërtuar gjuhën maqedonase në “gjuhë amtare”](#). Shërbimi për Verifikimin e Fakteve qysh në vitin 2019 ka shpjeguar se titulli “mësues i gjuhës amtare” është zyrtarizuar gjatë qeverisjes së mëparshme të VMRO-DPMNE-së, por në portale dhe rrjetet sociale ka ngrihej panik se qeveria aktuale e ka riemërtuar gjuhën maqedonase në “gjuhë amtare”.

Narracionet dezinformuese inkurajonin pasione nacionaliste dhe tentuan të ngjallnin panik social në lidhje me rrezikimin e gjuhës maqedonase. Ata nxisnin mosbesim ndaj qeverisë dhe ministrave të saj dhe urrejtje e jotolerancë ndaj tyre<sup>16</sup>, ndaj BE-së dhe Bullgarisë, si dhe polarizim dhe ndarjet e reja në shoqëri.

## Narracione me dezinformata, frikësim dhe teori të konspiracionit për identitetin maqedonas dhe popullin maqedonas

Narracioni frikësues dezinformativ se me të ashtuquajturin “propozim francez” di-

<sup>11</sup> Shih: “Manifesti i më shumë se 800 mësuesve maqedonas: U themi JO kushteve poshtëruese në një propozim të pahijshëm” ([Манифест на повеќе од 800 македонски учители: Велиме НЕ на понижувачките услови во непристоен предлог](#), Нова Македонија, 12.07, 2022). Shih edhe Teo Bilazhevski, “Kontraspin: Nuk ka asnjë konfirmim se “në të gjitha dokumentet e ardhshme të BE-së” gjuha maqedonase do të shkojë me një shtesë ose një fusnotë” (Teo Blaževski, [Kontraspin: Nema potvrda дека „во сите идни документи на ЕУ“ македонскиот јазик ќе оди со додавка или фуснота](#), 13.07.2022)

<sup>12</sup> Shih: “Në Kuvendin e Maqedonisë vazhdoi debati për propozimin francez” ([Продолжи расправата за францускиот предлог во Собранието на Македонија](#), mkd.mk, 15.07.2020).

<sup>13</sup> Shih: “VMRO-DPMNE: Propozimi francez për futjen e kërkesave bullgare në kornizën e negociatave është hap për bullgarizim” ([ВМРО-ДПМНЕ: Францускиот предлог за влегување на бугарските барања во преговарачка рамка е чекор за бугаризација](#), А1он, 17.06.2022).

<sup>14</sup> “Çdo referencë ndaj gjuhës zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut në dokumentet/pozicionet/deklaratat zyrtare/jozyrtare dhe të tjera të BE-së dhe institucioneve, organeve, zyrave dhe agjencive të saj duhet të kuptohet në mënyrë rigorozë në përputhje me Kushtetutën e këtij vendi dhe në asnjë mënyrë nuk interpretohet si njohje nga Republika e Bullgarisë të “gjuhës maqedonase”. Shih tekstin e tërë të Deklaratës bullgare për gjuhën maqedonase botuar nga TV Telma ([Интегрален текст: Бугарската декларација за македонскиот јазик](#), Телма, 19.07.2022).

<sup>15</sup> Shih: “Manipulime të reja politike dhe dezinformata për gjuhën maqedonase” ([Нови политички манипулации и дезинформации за македонскиот јазик](#), ИМА, 06.08.2022)

<sup>16</sup> Shih: “Sulmet e sinkronizuara ndaj politikanëve në Wikipedia me dezinformata, gjuhë urrejtjeje dhe diskriminim” ([Синхронизирани напади кон политичари на Википедија со дезинформации, поттикнување омраза и дискриминација](#), ИМА, 25.07.2022)

kush po e "asgjëson identitetin maqedonas" ra në sy jo vetëm në deklaratat politike, por edhe në deklaratat e historianëve maqedonas.

Për shembull, deklarata politike e Mickoskit e dhënë në TV ("jetojmë në një kohë kur një politikan mendjelehtë po e shkatërron identitetin maqedonas...")<sup>17</sup> dhe deklarata e historianit Todor Çepreganov se "propozimi francez është propozim bullgar i mbështjellë me celofan francez, i cili shkatërron identitetin, gjuhën dhe kulturën maqedonase!"<sup>18</sup> i përkasin të njëjtit narracion dezinformues, i cili akuzon pa bazë për shkatërrim të identitetit maqedonas. Një narracion identik se dikush "shkatërron drejtpërdrejt identitetin maqedonas" ishte i dukshëm edhe në deklaratat politike të VMRO-DPMNE-së të dhëna për Marrëveshjen e Prespës në vitin 2018, e cila u përbuz edhe si "marrëveshje kapitulluese".<sup>19</sup>

Në diskursin nacionalist të VMRO-DPMNE-së, Maqedonia dhe "identiteti maqedonas" u vendosën në kundërshtim me "propozimit francez" si diçka që i kërcënon drejtpërdrejt. "Maqedonia dhe identiteti maqedonas para të gjithave dhe mbi të gjitha"<sup>20</sup>, ishte mesazhi kryesor i Mickoskit në "protestat kundër propozimit francez".

Mickoski e lidhi identitetin maqedonas me "antropologjinë e gjenit maqedonas"<sup>21</sup> – shprehje manipuluese që nuk ka bazë shkencore në antropologji. Lideri i VMRO-DPMNE-së pohonte publikisht se jo vetëm që pranimi i të ashtuquajturit "propozim francez" është një "sulm i drejtpërdrejtë ndaj identitetit maqedonas", por edhe sugjeronte skenarë katastrofikë - se nuk do të ketë ndryshim të Kushtetutës, sepse ai vet është "mbrojtësi i fundit i identitetit maqedonas", të cilit i kërcënohet fundi.<sup>22</sup>

Deputetët e koalicionit VMRO-DPMNE dhe ata që nuk pajtohen me "propozimin francez" u promovuan si "gardianët e identitetit maqedonas", i cili kërcënohet për vdekje mu nga "propozimi francez".

Edhe parti të tjera politike e pranuan narracionin e "shkatërrimit të identitetit maqedonas". Në një proklamantë, partia E Majta pretendonte se "Bullgaria përmes BE-së vendos ultimatum për të shkatërruar identitetin maqedonas!"<sup>23</sup>. Partia "Edinstvena Macedonia" (Maqedonia Unike) dezinformoi se negociatat me BE-në ishin të kushtëzuara me "fshirjen e kombit, gjuhës, historisë dhe historisë dhe kulturës maqedonase",<sup>24</sup>, ndër-sa kreu i partisë GROM pohoi se "koka e popullit maqedonas po pritet në protokoll".<sup>25</sup>

<sup>17</sup> Shih: "Mickoski: Kovačevski negocioi fshehtas 6 muaj, tani bën sikur nuk e di për propozimin me të cilin do të bullgarizohet Maqedonia" ([Мицкоски: Ковачевски тајно преговарал 6 месеци, сега се прави дека не знае за предлогот со кој би се бугаризирала Македонија](#), Република, 23.06.2022)

<sup>18</sup> Shih: "Propozimi francez është bullgar, i mbështjellë me celofan francez që shkatërron identitetin, gjuhën dhe kulturën maqedonase!" ([„Францускиот предлог е бугарски, омотан со француски целофан кој го ништи македонскиот идентитет, јазик и култура!“](#), Lider, 04.07.2022)

<sup>19</sup> Shih: "Janushev: Deri më tani askush nuk ka guxuar të nënshkruajë një marrëveshje të tillë kapitulluese" ([Јанушев: Никој до сега не се осудил да потпише ваков капитулантски договор](#), Курир, 26.09.2018)

<sup>20</sup> Shih: "Mickoski para fillimit të tubimit para Qeverisë: Identiteti maqedonas para së gjithash dhe mbi të gjitha" ([Мицкоски пред почетокот на собирот пред Владата: Македонскиот идентитет пред и над сè](#), Канал 5, 02.07.2022)

<sup>21</sup> Mickoski ka përdorur edhe shprehjen "gjeni maqedonas" në fushatën zgjedhore 2020. Shih: "Beteja për gjenin maqedonas është një betejë që nuk mbaron kurrë" ([Битката за македонскиот ген е битка којашто никогаш не завршува](#), Lider, 12.03.2020)

<sup>22</sup> "Nëse bie Kushtetuta, nëse kalon korniza negociuese, mbaron identiteti maqedonas", shih: "INTERVISTË, HRIS-TIJAN MICKOSKI: BDI hyri në pakt me Bullgarinë dhe tradhtoi popullin maqedonas" ([ИНТЕРВЈУ ХРИСТИЈАН МИЦКОСКИ: ДУИ влезе во пакт со Бугарија и го предаде македонскиот народ](#), Вечер, 22.07.2022).

<sup>23</sup> Shih: "Edhe E Majta thirri për protestë gjithëpopullore kundër propozimit francez" ([И Левица повика на сенароден протест против францускиот предлог](#), mkd.mk, 01.07.2022)

<sup>24</sup> Shih: "Maqedonia Unike Kovačevskit pas propozimit francez: Eja në zgjedhje dhe populli të vendosë për të ardhmen e Maqedonisë" ([Единствена Македонија до Ковачевски по францускиот предлог: Ајде на избори и народот нека одлучи за иднината на Македонија](#), Единствена Македонија, 20.06.2022).

<sup>25</sup> Shih: "Jakimovski: Popullit i jepet propozimi i të madhit Makron, por në fakt ia prenë kokën me protokollin në

Një perceptim të ngjashëm u përpoqën të imponojnë përkrahësit e partisë E Maja në protesta, të cilët sollën aty një gjyotinë me mbishkrimin “Propozimi francez”, si dhe politikanët e partisë Glas za Makedonija (“Zë për Maqedoninë”).<sup>26</sup>

Një ish - nënkryetar i qeverisë të udhëhequr nga VMRO-DPMNE (përgjegjës për integrimet evropiane), në një kolumnë dezinformoi se kushti për të hyrë në BE është anulimi i gjithçkaje maqedonase dhe fshirja e maqedonasve si popull dhe komb.<sup>27</sup>

Gjenerator i dezinformatave të ngjashme dhe teorive të konspiracionit për “propozimin francez” ishte edhe kryetari i ASHAM, i cili shkruajti se “...me propozimin francez, Qeveria e Maqedonisë do të dëshmojë se në shtetin e Maqedonisë, brenda kufijve të Maqedonisë së sotme, nuk ka maqedonas...”<sup>28</sup>. Kocarev parashihte se “në qoftë se nuk i ndër-presim të dy dokumentet, maqedonasit do të zhduken, ndërsa në BE do të hyjë Maqedonia, por jo edhe maqedonasit”<sup>29</sup>. Kocarev u përpoq të paraqiste si “fakt” një akuzë klasike pa prova: se me dy dokumentet “Maqedonia, në fakt, me vetëdije apo pa vetëdije, ka kryer gjenocid ndaj maqedonasve në Egje dhe Pirin”.<sup>30</sup>

Akuza të paargumentuara për “gjenocid” kanë bërë edhe deputetët e VMRO-DPMNE-së gjatë debatit parlamentar,<sup>31</sup> ndërsa për “gjenocid ekonomik”<sup>32</sup> ka folur edhe Mickoski në protestën antiqeveritare të 18 qershorit.

Në njërën nga kolumnat e tij, kryetari i ASHAM-it Kocarev dezinformoi se “maqedonasit që sot nuk ekzistojnë”, duke nxjerrë një përfundim të gabuar nga një dokument për regjistrim në fakultet.<sup>33</sup>

prapavijë!” ([Якимовски: На народот му се дава предлогот на великиот Макрон, а всушност му се сече глава со протоколот од позадина!](#), Infomax, 05.07.2022)

<sup>26</sup> Natasha Kotllar, historiane dhe kandidate e VMRO-DPMNE-së dhe koalicionit për kryetare të Komunës Qendër, shih: “Natasha Kotllar: Propozimi francez është gjyotinë për popullin maqedonas!” ([Наташа Котлар: Францускиот предлог е гилотина за македонскиот народ!](#), Република, 14.07.2022)

<sup>27</sup> Shih: Ivica Boceovski, “Grackat më të mëdha për Maqedoninë në “Propozimin francez”” (Ivica Boceovski, [Најголемите замки за Македонија во „францускиот предлог“](#), Нова Македонија, 02.07.2022)

<sup>28</sup> Shih Akad.Lupço Kocarev, “Maqedonizmi do të mbijetojë” (Љупчо Коцарев, [Македонизмот ќе опстои](#), Нова Македонија, 5.07.2022.)

<sup>29</sup> Shih: Akad.Lupço Kocarev, “Dy mijë e tetëdhjetë e katërta” ose “Maqedonasi i fundit në Evropë” (Љупчо Коцарев, [Две илјади осумдесет и четврта](#) или [„Последниот Македонец во Европа“](#), [Н.Македонија](#), Нова Македонија, 22.07.2022.)

<sup>30</sup> Bëhet fjalë për përdorim jashtëzakonisht joprofesional dhe të paargumentuar të termit “gjenocid” i cili është përcaktuar në Kodin Penal dhe në të drejtën ndërkombëtare (në Konventën për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit dhe në [Statutin e Romës të Gjykatës Penale Ndërkombëtare](#), ku në nenin 6 janë të numëruara aktet e gjenocidit). Nëse Kocarev ka pasur prova me të cilat mund të mbështeste akuzën e tij për gjenocid ndaj maqedonasve në Egje dhe Pirin nga ana e Maqedonisë, ai është i detyruar t’i paraqesë ato në prokurorinë e vendit ose në Gjykatën Ndërkombëtare Penale, sepse gjenocidi është krimi më i rëndë që nuk vjetërohet.

<sup>31</sup> Shih: “Deputetët e VMRO DPMNE-së të prerë: propozimi francez për popullin maqedonas është joevropian, johuman, çnjerëzor, skandaloz dhe diskriminues” ([Пратениците на ВМРО ДПМНЕ децидни: Францускиот предлог за македонскиот народ е неевропски, нехуман, нечовечки, скандалозен и дискриминирачки](#), Нова Македонија, 15.07.2022) “Propozimi francez dhe të gjithë ata që e konsiderojnë se është unik, më i miri dhe përfundimtar do të bëjnë një gjenocid të ri dhe të paparë ndaj popullit maqedonas” (Dafina Stojanovska); “Me propozimin francez jemi dëshmitarë të një gjenocidi të tmerrshëm” (Angelina Petkova).

<sup>32</sup> Shih: Meri Jordanovska, “Kontraspin: Gjenocid ekonomik joekzistent dhe gjoja bllokime shpëtimtare të institucioneve – spin pas spini në fjalimin e Mickoskit” ([Контраспин: Непостоечки економски геноцид и наводни спасувачки блокади на институциите – спин до спин во говорот на Мицкоски](#), 20.07.2022)

<sup>33</sup> “[Deklarata për përkatësi nacionale](#)” e cila me vite është temë e manipulimeve edhe në media edhe në rrjetet

Narracione dhe manipulime të këtilla dezinformuese ngritën panik nacionalist, nx-nsin pasione etnike, nxnsin urrejtje dhe intolerancë ndaj BE-së dhe Bullgarisë, si dhe ndarje të mëtejshme të brendshme përgjatë vijave të “patriotëve” dhe “tradhtarëve”.

## Narracione dezinformuese dhe teori të konspiracionit për shtetin dhe të ardhmen e tij

Lideri i partisë më të madhe opozitare, Mickoski e hodhi poshtë “propozimin e ndryshuar francez”<sup>34</sup>, duke e përshkruar atë si disfatë dhe “kapitullim pa shtyrje”,<sup>35</sup> duke manipuluar se “propozimi francez nuk ofron fillim të eurointegritimit maqedonas”,<sup>36</sup> dhe duke dezinformuar se ai i përmban “të gjitha kërkesat bullgare”.<sup>37</sup>

Edhe zëvendësi i tij, Nikolloski, kërkoi që “Qeveria të refuzojë urgjentisht propozimin e Parisit, me të cilin bëhet bullgarizimi dhe shkatërrimi i Maqedonisë”.<sup>38</sup>

Një deputete i akuzoi “tradhtarët e pushtetit” se me propozimin francez “do ta varrosin Maqedoninë”.<sup>39</sup>

Diskursin e “shkatërrimit” e promovuan edhe politikanët të tjerë të shquar të VMRO-DPMNE-së. Veteranët e VMRO-DPMNE-së filluan ta quajnë “propozim francez për shkatërrimin e shtetit”,<sup>40</sup> pasi që ish-presidenti Ivanov përmendi “lojërat e poshtra për të shpërbërë Maqedoninë» dhe akuzoi për “tradhti kombëtare”.<sup>41</sup> Një ish-ambasador në Bullgari dhe kandidat për kryetar të VMRO-DPMNE-së theksoi se “Propozimi francez na hedh në humnerë”.<sup>42</sup>

---

sociale. Nga deklarata, e cila përdoret në praktikë gjatë regjistrimeve vetëm për të zbatuar vendimet e qeverisë për “kuotat shtesë të regjistrimit për studentët jo-shumicë”, nuk mund të nxirret përfundimi i vlefshëm se “maqedonasit janë zhdukur që sot”. Studentët maqedonas trajtohen si shumicë nga administrata e fakulteteve dhe për këtë arsye nuk përfshihen në deklaratën e përdorur në zbatimin e vendimeve të qeverisë për “kuotat shtesë për regjistrimin e studentëve që nuk janë shumicë”, shih: “Kryetari i ASHAM Kocarev dezinformon se “maqedonasit nuk ekzistojnë që sot”” ([Претседателот на МАНУ Коцарев дезинформира дека „Македонците веќе уште денес ги нема“](#), ИМА, 13.09.2022)

<sup>34</sup> Shih: “Maqedonia e Veriut merr formulime të reja nga BE-ja” ([Северна Македонија од ЕУ добива нови формулации](#), DW, 01.07.2022)

<sup>35</sup> Shih: “Mickoski e hodhi poshtë “propozimin francez” dhe kërkoi zgjedhje për të shpëtuar Maqedoninë” ([Мицкоски го отфрли „францускиот предлог“ и побара избори за спас на Македонија](#), PCE, 18.07.2022)

<sup>36</sup> Shih: “Mickovski për “Politika”: Propozimi francez nuk ofron fillimin e integritimeve evropiane maqedonase” ([Мицковски за „Политика“: Францускиот предлог не нуди почеток на македонската евроинтеграција](#), Канал 5, 11.07.2022)

<sup>37</sup> Mjafton të krahasohet korniza e negociatave (i ashtuquajtur “propozimi francez”) me kërkesat e Bullgarisë nga “Pozicioni Kornizë” për të parë pavërtetësinë e deklaratës.

<sup>38</sup> Shih: “Nikolloski: Qeveria të refuzojë menjëherë propozimin e Parisit, me të cilin bëhet bullgarizimi dhe shkatërrimi i Maqedonisë” ([Николоски: Владата итно да го отфрли предлогот од Париз со кој се прави бугаризација и уништување на Македонија](#), Макфакс, 22.07.2022)

<sup>39</sup> Shih: “Llasovska: Me propozimin francez tradhtarët nga pushteti do ta varrosin Maqedoninë” ([Ласовска: Со францускиот предлог велепредавниците од власта ќе ја погребат Македонија](#), 24инфо, 15.07.2022)

<sup>40</sup> Shih: “AS NUK MUND TË NA TREMBË DIKUSH, AS NUK DO TË TËRHIQEMI NGA KJO BETEJË PËR TË SHPËTUAR MAQEDONINË” ([НИТУ МОЖЕ НЕКОЈ ДА НЕ ЗАПЛАШИ, НИТУ ЌЕ СЕ ПОВЛЕЧЕМЕ ОД ОВАА БИТКА ЗА СПАС НА МАКЕДОНИЈА](#), Македонска нација, 06.07.2022)

<sup>41</sup> Shih: “Ivanov: Refuzoni propozimin francez, këto janë lojëra të ndyra për të shkatërruar Maqedoninë” ([Иванов: Отфрлете го францускиот предлог, тоа се подли игри за разнебитување на Македонија](#), Фокус, 02.07.2022), Shih: “Gjorgje Ivanov: Populli maqedonas është sërisht dëshmitar i tradhtisë kombëtare” ([Ѓорѓе Иванов: Македонскиот народ повторно е сведок на национално предавство](#), Сител, 02.07.2022)

<sup>42</sup> Shih: “Intervistë Marjan Gjorçev: Propozimi francez na hedh në humnerë dhe na çon në probleme serioze” ([Интервју Марјан Ѓорчев: Францускиот предлог нѐ фрла во амбис и води кон сериозни проблеми](#), Макфакс, 07.07.2022)

**Diskursi nacionalist i “shkatërrimit” të Maqedonisë u ushqye edhe prej organizatave joqeveritare dhe akademikëve, ndërsa në kontekst të negociatave me BE ai ishte paraprakisht i paralajmëruar në një proklamata të nënshkruar prej më tepër intelektualëve**

Diskursi për shkatërrimin e Maqedonisë me “propozimin francez” u vërejt edhe në protesta, ku shquheshin parullat ““Jo” për shkatërrimin së Maqedonisë, “Jo” harresës së popullit maqedonas” etj.<sup>43</sup> Diskursi nacionalist i “shkatërrimit të shtetësisë sonë” në kontekst të procesit të negociatave me BE-në nxitet edhe nga parti të tjera, si për shembull E Majta.<sup>44</sup>

Diskursi nacionalist i “shkatërrimit” të Maqedonisë u ushqye edhe prej organizatave joqeveritare<sup>45</sup> dhe akademikëve,<sup>46</sup> ndërsa në kontekst të negociatave me BE ai ishte paraprakisht i paralajmëruar në një proklamata të nënshkruar prej më tepër intelektualëve.<sup>47</sup>

## Narracione dezinformuese për historinë dhe “komisionin historik” në kontekst të “propozimit francez”

Në lidhje me “propozimin francez”, në opinion u krijua një perceptim i gabuar se bëhet fjalë për një “propozim në të cilin përfshihen të gjitha kërkesat e Sofjes zyrtare për ndryshimin e historisë”,<sup>48</sup> edhe pse shumica e “kërkesave historike” të Bullgarisë nuk u përfshinë në “propozimin francez”.

Përveç kërcënimeve të pabaza për bullgarizim dhe asimilim të plotë<sup>49</sup>, u përhapën

<sup>43</sup> Shih: “Dita e tetë e protestave dhe kërkesave për të refuzuar “propozimin francez”” ([Осми ден протести и барање за отфрлање на „францускиот предлог“](#)), BOA, 11.07.2022)

<sup>44</sup> “Kulminacionin e këtij shkatërrimi po e shohim pikërisht sot në konferencën ndërqeveritare në Bruksel, me të cilin maqedonizmi, si kashtë për shpëtimin e qeverisë, sakrifkohet në altarin e BE-së”, shih: Konferenca ndërqeveritare nuk hap negociatat për BE-në, por mbron zbatimin e kërkesave shoviniste bullgare ([Меѓувладината конференција не ги отвора преговорите за ЕУ туку се заложува за спроведување на бугарските шовинистички барања](#)), levica.mk, 19.07.2022).

<sup>45</sup> “Shteti maqedonas kurrë nuk duhet të mbështesë një proces negociator me BE-në, i cili do të bëhet baza e shpërbërjes së shtetësisë sonë, duke kërcënuar stabilitetin e brendshëm dhe rajonal me pasoja të paparashikueshme”, shih: “Negociatat me BE-në nuk duhet të bëhen bazë për shkatërrimin e shtetësisë” ([Преговорите со ЕУ не смее да станат основа на разнебитување на државноста](#)), Нова Македонија, 20.06.2022)

<sup>46</sup> Shih: “Katica Qullafkova paralajmëron për tradhti të lartë: Maqedonia është në prag të shkatërrimit të plotë” ([Катица Кулафкова предупредува на велепредавство: Македонија е на прагот на целосна разнебитеност](#)), А1он, 02.07.2022), shih: “Kocarev: Të gjitha dokumentet që nuk janë në përputhje me premisat themelore të maqedonizmit nënkuptojnë shkatërrimin e Maqedonisë” ([Кочарев: Сите документи што не се конзистентни со основните премиси на македонизмот, значат разнебитување на Македонија](#)), Република, 21.07.2022).

<sup>47</sup> Shih proklamata: “Maqedonizmi është një ide legjitime emancipuese. Pse I duhet Evropës një Maqedoni çmaqedonizuar?” ([Македонизмот е легитимна еманципаторска идеја. Чуму ѝ е на Европа една размакедончена Македонија?](#)), mkd.mk) “Maqedonia, pikërisht për këtë arsye, nuk mund dhe nuk duhet të pranojë që çmimi i marrjes së datës për fillimin e negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian të jetë shkatërrim i procesit legjitim historikisht të rumbullakosur të konstituimit të kmbit maqedonas dhe çmaqedonizimi i saj”

<sup>48</sup> Shih: “Manifesti I mësuesve maqedonas” ([Манифест на македонските учители, А1он](#)), 12.07.2022)

<sup>49</sup> Për shembull, Mickoski manipuloi se gjithçka që përmbante rezoluta e parë e Parlamentit bullgar të vitit 2019 ishte pranuar në protokoll: “E para është se një nga dokumentet i referohet protokollit të konferencës së dytë ndërqeveritare me Bullgarinë, ku praktikisht gjendet edhe historia, edhe arsimi, monumentet dhe kultura, gjithçka që përmban rezoluta e parë e Kuvendit të Bullgarisë të vitit 2019, dhe nëse e pranojmë këtë, pranojmë atë protokoll, na pret praktikisht asimilimi i plotë”. Shih: “Mickoski: Nëse ky propozim pranohet, pranohet asimilimi i plotë dhe mjet i Bullgarisë që ta bllokoi Maqedoninë kur të dojë” ([Мицкоски: Ако се прифати овој предлог, се прифаќа комплетна асимилација и алатка на Бугарија да ја блокира Македонија кога саќа](#)), Република, 06.07.2022.)



**Përveç kërcënimeve të pabaza për bullgarizim dhe asimilim të plotë , u përhapën dezinformata se “Bullgaria do të shkruajë historinë maqedonase!”.**

dezinformata se “Bullgaria do të shkruajë historinë maqedonase!”.<sup>50</sup>

Madje, partia E Majta akuzoi “Komisionin për bullgarizimin e popullit maqedonas” se është në shërbim të “vërhovizmit”.<sup>51</sup> Në shënjestër të akuzave të paargumentuara për “shitje të historisë” ishte veçanërisht kryetari i komisionit.<sup>52</sup>

Pas publikimit të rekomandimeve të përbashkëta, ekipi maqedonas i Komisionit Historik ka reaguar ndaj akuzave të pabaza për gjoja “bullgarizim” ,<sup>53</sup> duke dhënë kundërgjegje për “shpifjet, akuzat dhe manipulimet e shumta për veprim antishkencor, tradhti dhe bullgarizim”.<sup>54</sup>

IMA vuri në dukje se “...interpretimet e njëanshme të historianëve bullgarë u përdorën për të përhapur dezinformata dhe për të ndezur pasionet nacionaliste”.<sup>55</sup> Dezinformata të shumta, spekulime dhe interpretime tendencioze të rekomandimeve të publikuara u shfrytëzuan jo vetëm për të ngritur panik, por edhe për akuzat të mëtejshme për “tradhti kombëtare”, si dhe për të nxitur urrejtje (kundër “severxhanobullgarëve” (veriobullgarëve)) dhe “tradhtarëve” në rrjetet sociale.<sup>56</sup>

## Narracionet dezinformuese me retorikë nxitëse “ne-të tjeret”

Debati publik për propozimet e BE-së u pasua me dezinformata të shumta, përpjekje për të ngritur panik në publik, por edhe me jotransparencë dhe mosreagim nga ana e autoriteteve, në lidhje me narracionet dezinformuese që përforconin gjuhën e urrejtjes që nxit dhunë.<sup>57</sup>

<sup>50</sup> Shih: “Populli po mobilizohet kundër bullgarizimit të Maqedonisë - nuk ka propozim të ri!” ([Народот се мобилизира против бугаризацијата на Македонија – нема нов предлог!](#)), levica.mk, 01.07.2022)

<sup>51</sup> Shih: “Dragi Gjorgjiev dhe Komisioni historik në shërbim të plotë të vërhovizmit” ([Драги Ѓорѓиев и историската комисија во целосна служба на врховизмот](#)), levica.mk, 16.08.2022)

<sup>52</sup> Për shembull: “Koteska për Gjorgjievin: Imajino të marrësh një çmim akademik nga Maqedonia dhe më pas të shesësh historinë e saj” ([Котеска за Ѓорѓиев: Замисли да добиваш академска награда од Македонија и потоа да ја распродадеш нејзината историја](#)), Expres.mk, 19.08.2022).

<sup>53</sup> Shih: “Ekipi maqedonas i Komisionit Historik: akuzat për gjoja bullgarizim janë të pabaza” ([Македонскиот тим на Историската комисија: неосновани се обвинувањата за наводна бугаризација](#)), PCE, 18.08.2022)

<sup>54</sup> Shih: “Historianët: Rekomandimet janë mposhtje e miteve historike” ([Историчари: Препораките се пораз на историските митови](#)), DW, 18.08). Po ashtu: “Reagimi i Komisionit Historik: Vazhdon përhapja e gënjeshtërve për punën tonë” ([Реакција на Историската комисија: Продолжува ширењето невистини за нашето работење](#)), Meta, 22.08.2022)

<sup>55</sup> Për shembull, [interpretimet vijuese](#) nuk kanë mbështetje faktike në rekomandimet e botuara: “... edhe fëmijët në Kroaci, Sllovaki dhe vende të tjera sllave duhet të mësojnë se misioni arsimor i Qirilit dhe Metodit dhe nxënësve të tyre është një ‘projekt bullgar’.” Askund në rekomandime nuk gjendet shprehja “projekt bullgar”. Akuzat për “bullgarizimin e Kirilit dhe Metodit” nuk kanë bazë në rekomandimet e publikuara. Dezinformata janë edhe pretendimet se Komisioni ka pranuar se Qirili dhe Metodi janë lindur dhe [“kanë vepruar në Bullgarinë mesjetare”](#). Shih: “Car Samuili dhe Shën. Qirili dhe Metodi u keqpërdorën për përhapjen e dezinformatave dhe nxitjen e urrejtjes” ([Цар Самоил и Светите Кирил и Методиј злоупотребени за ширење дезинформации и поттикнување омраза](#)), IMA, 17.08.2022)

<sup>56</sup> Shih: Zharko Trajanoski, “Car Samuili dhe Shën. Qirili dhe Metodi u keqpërdorën për përhapjen e dezinformatave dhe nxitjen e urrejtjes” ([Цар Самоил и светите Кирил и Методиј злоупотребени за ширење дезинформации и за поттикнување омраза](#)), Слободен Печат, 19.08.2022).

<sup>57</sup> IMA u bëri thirrje politikanëve, gazetarëve dhe të gjithë pjesëmarrësve në debatin publik që të ndalojnë përhapjen e dezinformatave flagrante dhe ngritjen e panikut publik gjatë debatit publik për propozimet e BE-së. IMA u bëri thirrje gjithashtu institucioneve kompetente që të informojnë publikun për çdo aspekt që nga fillimi i negociatave dhe të

**Debati publik për propozimet e BE-së u pasua me dezinformata të shumta, përpjekje për të ngritur panik në publik, por edhe me jotransparencë dhe mosreagim nga ana e autoriteteve, në lidhje me narracionet dezinformuese që përforconin gjuhën e urrejtjes që nxit dhunë.**

Përveç akuzave të VMRO-DPMNE-së, se ministri Bujar Osmani nuk ka punuar në interes të Maqedonisë, por të Shqipërisë,<sup>58</sup> që ajo të fillojë negociatat,<sup>59</sup> në protesta janë përhapur mesazhe diskriminuese, jo vetëm kundër “Bullgar Osmanit”, por edhe mesazhe tjera antishqiptare.

Pas incidenteve të dhunshme gjatë protestave kundër propozimit francez më 06.07.2022, lideri i VMRO-DPMNE-së, Hristian Mickoski, postoi një fotografi duke pohuar se “Ky është njeriu që duhej të më vriste sonte”.<sup>60</sup>

Mickoski e drejtoi sërish gishtin drejt Osmanit si paralajmërues i një skenari të tillë.<sup>61</sup> Një analizë e Vërtetëmatësit arriti në përfundim se Mickoski ka bërë spin “pa paraqitur asnjë provë që do të dëshmonte një gjë të tillë” dhe se ai e përdorur incidentin e protestës për të përfutur pikë politike.<sup>62</sup>

Pas incidentit të dhunshëm në protestat kundër “propozimit francez”, lideri i VMRO-DPMNE-së hodhi akuzat të rënda se “kemi identifikuar pesë persona, të punësuar në MPB, ata kanë shtënë mbi popullin”, “kanë angazhuar persona të punësuar në MPB për të shtënë mbi popullin”, të cilat u mohuan nga MPB.<sup>63</sup>

Vërtetëmatësi vlerësoi se “kryetari i partisë më të madhe opozitare në deklaratën e tij nuk ofron tekstualisht asnjë provë për të konfirmuar pretendimin e tij se “punonjësit e MPB-së kanë shtënë mbi popullin”, një deklaratë e cila në vetvete është jashtëzakonisht e rëndë dhe në asnjë rast nuk duhet jepet në mënyrë të përgjithshme”.<sup>64</sup>

Incidentet e dhunshme të protestave nuk ishin vetëm një shkas për spine politike,<sup>65</sup>

marrin masa të menjëhershme për të identifikuar dhe zbuluar narracionet e dezinformatave që përforcojnë gjuhën e urrejtjes që nxit dhunë. Për më tepër, shih: ([ИМА: ПОЛИТИЧАРИТЕ И МЕДИУМИТЕ ДА ПРЕСТАНАТ ДА ШИРАТ ГОВОР НА ОМРАЗА И ДЕЗИНФОРМАЦИИ. ИНСТИТУЦИИТЕ ДА ПРЕЗЕМАТ МЕРКИ ЗА СПРЕЧУВАЊЕ И КАЗНУВАЊЕ НА ГОВОРОТ НА ОМРАЗА ШТО ПРЕДИЗВИКУВА НАСИЛСТВО](#), ИМА 06.07.2022)

<sup>58</sup> Shih: “Nikolloski pohon se Osmani punon në interes të Shqipërisë e jo të Maqedonisë” ([Николоски тврди дека Османи работи во интерес на Албанија, а не Македонија](#), Независен, 26.06.2022)

<sup>59</sup> Shih: “Mickoski: Ne nuk do të fillojmë negociatat tani, këtë duhet ta dinë qytetarët. Shqipëria do të fillojë, jo ne. Ne do të duhet të ndryshojmë Kushtetutën. Ne po e nënshkruajmë këtë që Shqipëria të fillojë negociatat, jo Maqedonia”. ([Ние ова го потпишуваме за Албанија да почне преговори, а не Македонија, вели Мицкоски за францускиот предлог](#), Нова Македонија, 04.07.2022)

<sup>60</sup> Shih: “Mickoski: Ky është njeriu që duhej të më vriste sonte” ([Мицкоски: Ова е човекот кој требаше да ме убие вечерва](#), Сител, 06.07.2022)

<sup>61</sup> Shih: Vllado Apostollov, “Dufi nga propozimi francez po derdhet mbi bashkëjetesën” ([„Бесот од францускиот предлог се истура врз соживотот“](#), БИРН, 07.07.2022), “Dua t’ju kujtoj se një skenar të tillë e ka paralajmëruar qeveria, ministri i Punëve të Jashtme, Bujar Osmani”, tha dje Mickoski. Qysh mbrëmë, akuzat e Mickoskit e humbi legjitimitetin sepse doli se i armatosuri, pronari i inatosur i hotelit pranë Skënderbeut, është përkrahës i Aleancës së Shqiptarëve, partner koalicioni i VMRO-DPMNE-së”.

<sup>62</sup> Shih Meri Jordanovska; “Kontraspin: Mickoski e përdori incidentin e protestës për të përfutur pikë politike” ([Конtrasпин: Мицкоски го искористи инцидентот на протестите за собирање политички поени](#), Вистиномер, 07.07.2022)

<sup>63</sup> MPB-ja “ashpër dhe kategorikisht” ka mohuar “gënjeshtrat që presidenti i VMRO-DPMNE-së i ka thënë në televizionin serb Prva, se i arrestuari i cili ka qëlluar me armë gjatë incidentit në sheshin Skënderbeu ka qenë punonjës i Ministrisë së Brendshme”, duke apeluar “të mos prezantohen lajme të rreme dhe dezinformata që mund të çojnë në konfuzion publik”, shih: ([Демант на МВР](#), 09.07.2022)

<sup>64</sup> Shih: Meri Jordanovska; “Mickoski pretendon rrejtshëm se “personat që qëlluan mbi popullin” në protesta janë punonjës të MPB-së” ([Мицкоски невистинито тврди дека „лицата кои пукале во народот“ на протестите се вработени во МВР](#), Вистиномер, 10.07.2022)

<sup>65</sup> Shih: Teo Blazhevski; “Kontraspin: Cilët janë provokatorët e protestave, duhet të zbulojnë Ministria e Brendshme

por shkaktuan edhe një ortek dezinformata në mediat në gjuhën maqedonase dhe shqipe.<sup>66</sup> Një pjesë e tyre kishin tendencë për të nxitur tensione ndëretnike dhe ndërfe-tare, por edhe për të minuar besimin në polici dhe prokurori.<sup>67</sup>

Tensionet e protestave vazhduan edhe më 11 korrik 2022, kur disa pjesëmarrës në protestë kundër “bullgarizimit” brohoritën “Maqedonia e pastër”, “dhoma gazi për të ‘Shiptarët’” dhe kënduan këngën partizane “A bre Makedonçe” me vargun e ndryshuar “le të kuptojnë ‘Shiptarët’ e mallkuar”.<sup>68</sup> Në fund të korrikut, edhe presidenti Pendarovski gjithashtu theksoi se retorika ndezëse ndaj të tjerëve mund të shkaktojë incidente.<sup>69</sup>

## Narracione me dezinformata dhe manipulime për referendumin për “propozimin francez”

Ndër dezinformatat dhe manipulimet e shumta mediatiko-politike për “propozimin francez” janë edhe ato se do të fillohet nisma për referendum, ku qytetarët do të mund të deklarohen PRO ose KUNDËR “propozimit francez” dhe ndryshimeve kushtetuese.<sup>70</sup>

Mediat raportuan se Mickoski “inicoi idenë e referendumit për Kornizën negociuese edhe pasi opozita u largua nga seanca dhe nuk votoi për projekt-konkluzionet”.<sup>71</sup>

Mirëpo, pyetja e referendumit e iniciativës aktuale qytetare që u ngrit nga Mickoski nuk i referohet fare kornizës së negociatave (të ashtuquajturit “propozim francez”), por Ligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes me Bullgarinë, i publikuar në Gazetën Zyrtare në fillim të vitit 2018.<sup>72</sup>

dhe ajo e Drejtësisë” ([Контраспин: Чии се провокаторите на протестите, треба да откријат МВР и ЈО 07.07.2022](#))

<sup>66</sup> Shih: Sefer Tahiri, “[Si raportuan mediat në gjuhën shqipe për “propozimin francez](#)”, në pjesën “Raportimi për protestat, theksi mbi antishqiptarizmin”, IMA, 30.07.2022

<sup>67</sup> Shih: “A do t’i kërkojnë falje opinionit politikanët, partitë dhe mediat që shpërndajnë dezinformata për “mbajtësin e pistoletës” e gabuar të Mavrovka?” ([Ке ѝ се извинат ли на јавноста политичарите, партиите и медиумите кои шират дезинформации за погрешен „пиштолија“ кај Мавровка?](#), IMA, 16.07.2022), shih edhe: “Me fotografi të gabuar dezinformohet opinionin për të shtënat te Mavrovka („[Со погрешна фотографија се дезинформира јавноста за пукотниците кај Мавровка](#)””, Вистиномер, 19.07.2022)

<sup>68</sup> Shih: “Po intensifikohet gjuha e urrejtjes në disa baza: “Shiptarët e mallkuar” dhe “Maqedonia e pastër” po jehojnë sërish, ku janë opinionin dhe institucionet?” ([Се интензивира говорот на омраза по повеќе основи: Пак ечи „Клетите Шиптари“ и „Чиста Македонија“, каде се јавноста и институциите?](#), IMA, 14.07.2022).

<sup>69</sup> Shih: “Pendarovski për “Fokus”: Kemi retorikë të paparë ndaj shqiptarëve dhe retorikë antiperëndimore, anti-amerikane, antigreke dhe antibullgare” ([Пендаровски за „Фокус“: Имаме невидена retorika кон Албанците и антизападна, антиамериканска, антигрчка, антибугарска retorika](#), IMA, 29.07.2022) “Ne kemi retorikë ndaj shqiptarëve që është e paparë, pastaj kemi edhe retorikë antiperëndimore, antiamerikane, antigreke dhe antibullgare të një niveli të paparë, dhe druaj se gjenerata e reja të nxitura nga retorika e politikanëve ndoshta do të duan që të provokojnë incidente”

<sup>70</sup> Lideri i VMRO-DPMNE-së, Hristijan Mickoski, në një paraqitje në TV Sitel më 17 korrik, ka thënë shprehimisht se do të iniciojë referendum për kornizën e negociatave dhe amendamentet kushtetuese: “...korniza e negociatave nuk është miratuar. Korniza e negociatave do të miratohet pasi të bëhen ndryshimet kushtetuese. Nëse populli në referendum thotë se NUK KA amendamente kushtetuese, atëherë do të kërkojmë një kornizë tjetër negociuese. Atëherë edhe Evropa do ta dijë se populli në referendum ka thënë se nuk i pranon amendamentet e reja kushtetuese... nuk është miratuar korniza e negociatave e nëse në referendum populli thotë se nuk ka ndryshime në kushtetutë, kaq, Evropës, në Bruksel, do t’i themi se populli ka vendosur, ju lutemi na jepni një kornizë tjetër negociuese.”

<sup>71</sup> Shih edhe: “Mickoski paralajmëroi referendum për “propozimin francez”: Asgjë nuk ka përfunduar!” ([Мицкоски најави референдум за „францускиот предлог“: Ништо не е завршено! Фокус](#), 17.07.2022), si dhe: “Mickoski në konsultime për referendumin për propozimin francez” ([„Мицкоски во консултација за референдумот за францускиот предлог“](#), PCE, 24.07.2022)

<sup>72</sup> “A jeni për anulimin e vlefshmërisë së Ligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për miqësi, fqinjësi të mirë dhe bashkëpunim ndërmjet Maqedonisë dhe Bullgarisë, e publikuar në Gazetën Zyrtare të datës 18 janar 2017?”; Shih më tepër në: “VMRO-DPMNE i manipuloi qytetarët dhe mediat: Nuk ka referendum për “propozimin francez”, kornizën e negociatave dhe amendamentet kushtetuese” ([ВМРО-ДПМНЕ ги изманипулира граѓаните и медиумите: Нема](#)

## Narracionet me dezinformata, manipulime dhe spekulime mbi referendumin për “propozimin francez”

Propaganda politike kundër “propozimit francez” bazohej edhe në dezinformata, manipulime dhe spekulime për gjuhën e urrejtjes. Për shembull, para se të griste në mënyrë

**Ministri i Punëve të Jashtme theksoi se interpretimet e ndryshme historike nuk guxojmë t'i vendosim nën gjuhë të urrejtjes dhe se gjuha e urrejtjes nuk ka të bëjë me punën e komisionit historik dhe sqaroi se gjuha e urrejtjes monitorohet jo vetëm në Maqedoni, por edhe në Bullgari.**

teatrale “propozimin francez” në një emision televiziv propagandistik, ish-zëvendëskryeministri për integritime evropiane, Ivica Bocevski manipuloi mediatikisht me termin “gjuhë urrejtjeje”, duke sugjeruar se deklarimi etnik si “maqedonas” konsideroheshka si gjuhë urrejtje në Bullgari.<sup>73</sup> “Ekspertët” përhapnin paranojë se çdo koment negativ kundër Bullgarisë do të cilësohej si gjuhë urrejtjeje dhe do të sanksionohej penalisht.<sup>74</sup>

VMRO-DPMNE përhapte dezinformata dhe frikësim se propozimi francez parasheh “sanksionimin e çdo kritike apo mendimi kundërshtues nën vallon e gjuhës së urrejtjes”.<sup>75</sup>

Mediat publikonin spekulime të shumta se “në Maqedoni, nën petkun e “mar-rëdhënieve të mira fqinjësore”, do të gjenden libra të shumtë, dokumentarë dhe filma artistikë dhe seriale televizive, në të cilat tema qendrore është lufta me pushtuesin bullgar gjatë Luftës së Dytë Botërore”.<sup>76</sup> Përhapeshin spekulime se “gjuha e supozuar e urrejtjes” mund të “keqpërdoret për hakmarrje, për të ndëshkuar dhe arrestuar njerëzit që mendojnë ndryshe nga qeveria në Maqedoni.»<sup>77</sup>

U publikuan edhe dezinformata për ndryshime të veprave penale në lidhje me gjuhën e urrejtjes, në kontekst të “propozimit francez”.<sup>78</sup>

Ministri e Drejtësisë vuri në dukje se ndryshimet e fundit në Kodin Penal, ku u shtua një pjesë për urrejtjen e shkakuar «në bazë të një ligji ose një marrëveshjeje të ratifikuar ndërkombëtare», nuk ka asnjë lidhje me Protokollin Bilateral të nënshkruar së fundmi me Bullgarinë dhe se «gjuhën e urrejtjes nuk duhet ta lidhim gjithmonë me

референдум за „францускиот предлог“, преговарачката рамка и уставните измени, ИМА, 07.09.2022)

<sup>73</sup> Shih: “(VIDEO) Bocevski grisi propozimin francez në television: Ky është një poshtërim!” ((ВИДЕО) Боцевски го искрина францускиот предлог на телевизија: Ова е понижување!, Lider, 21.06.2022): “Nëse tani them se jam maqedonas, gjuha ime është maqedonase, maqedonas është një etni dhe komb i ndryshëm nga ai bullgar, gjuha maqedonase është ndryshe nga bullgarishtja, kjo është gjuhë e urrejtjes për Bullgarinë. Kështu e kuptojnë ata. Kjo është gjuhë urrejtjeje... Nëse them Goce Dellçev është maqedonas, kjo është gjuhë urrejtjeje”.

<sup>74</sup> Shih: Nenad Zhivanovski, “Në qëllimet e mira të propozimit francez nuk do të besonte as një shërbëtorë naivë francez” ((Во добронамерноста на францускиот предлог не би поверувала ни наивна француска „собарица“, мкд.мк, 06.07.2022): “Çdo koment negativ i një qytetari të thjeshtë kundër shtetit dhe kombit bullgar në diskursin publik apo në rrjetet sociale duhet të cilësohet si gjuhë urrejtjeje dhe të sanksionohet penalisht, gjë që nuk përjashton kërcënimin me burgim”.

<sup>75</sup> Shih: “VMRO-DPMNE: Propozimi francez është disfatë e diplomacies maqedonase” ((ВМРО-ДПМНЕ: Францускиот предлог е пораз на македонската дипломатија, Макфакс, 5 јули 2022)

<sup>76</sup> Shih: “Edhe “Samar magjik” do të bëhet gjuhë e urrejtjes? Bullgarët do t’ia humbin tërësisht kuptimin edhe КАЧКМ-сë” ((И „ВОЛШЕБНОТО САМАРЧЕ“ КЕ СТАНЕ ГОВОР НА ОМРАЗА? Бугарите целосно ќе го обесмислат и АСНОМ, инфо - 22.07.2022)

<sup>77</sup> Shih: Pande Kolemishevski, “Propozimi francez është fushë për zënka të reja, jo për pajtim” ((Францускиот предлог е поле за нови кавги – не е за помирување, Нова Македонија, 12.07.2022)

<sup>78</sup> Shih: “Informata të gabuara në media për ndryshimet në veprat penale që lidhen me gjuhën e urrejtjes” ((Порешни медиумски информации за измени на кривични дела во врска со говор на омраза, ИМА, 29.07.2022)

Bullgarinë, por t’i japim kuptim pak më ekstensiv”.<sup>79</sup>

Ministri i Punëve të Jashtme theksoi se interpretimet e ndryshme historike nuk guxojmë t’i vendosim nën gjuhë të urrejtjes dhe se gjuha e urrejtjes nuk ka të bëjë me punën e komisionit historik dhe sqaroi se gjuha e urrejtjes monitorohet jo vetëm në Maqedoni, por edhe në Bullgari.<sup>80</sup>

## Narracione dezinformuese dhe nxitëse kundër politikanëve, mediave dhe mbështetësve të “propozimit francez”

Narracionet ndezëse me akuzat të rreme ndaj politikanëve për “tradhti të lartë” kishin tendencë të shkaktonin trazira politike dhe destabilizim.<sup>81</sup> Në protestat kundër “propozimit francez”, deputetët e mazhorancës në pankarta u shpallën si “tradhtarë të popullit”.<sup>82</sup>

**Sulme të sinkronizuara propagandistike me dezinformata janë vërejtur jo vetëm ndaj politikanëve (përfshirë thirrjet për dhunë), por edhe ndaj intelektualëve për shkak të pikëpamjeve të publikuara personale. Një fushatë propagandistike me thirrje për linçim u drejtua edhe ndaj anëtarëve të komisionit historik dhe presidentit të tij.**

Pasi 68 deputetë votuan “për propozimin francez”, disa media publikuan një “tablo” me fotografi të deputetëve, me titullin “tradhtarët e Maqedonisë”, dhe akuzat të shumta të paargumentuara. Deputetët u “akuzuan” se duke votuar “propozimin francez” janë pajtuar “për tradhti të Maqedonisë dhe popullit maqedonas, bullgarizim të plotë dhe asimilim të Maqedonisë”, gjegjësisht, se kanë hequr dorë nga “historia maqedonase, gjuha maqedonase, kultura maqedonase dhe identiteti maqedonas”.<sup>83</sup>

Lideri i partisë E Majta dhe deputet në Kuvend, Dimitar Apasiev, i sulmoi gazetarët e mediave që raportonin nga Brukseli për nisjen e negociatave me BE-në, me etiketat “prostituta” dhe “gazetari sorospike”<sup>84</sup>. E Majta bëri thirrje për protestë kundër “kuislingëve

<sup>79</sup> Shih: “Tupançevski për REL: Vetëm institucionet e vendit tonë duhet të vendosin për kallëzime penale për gjuhë të urrejtjes” ([Тупанчевски за РСЕ: Само институциите на нашата држава треба да одлучуваат по кривични пријави за говор на омраза](#), ИМА 22.07.2022)

<sup>80</sup> Shih: “Osmani: Interpretimet e ndryshme historike nuk duhet t’i vendosim nën gjuhë të urrejtjes, gjuha e urrejtjes nuk ka lidhje me punën e komisionit historik” ([Османи: Различните историски интерпретации не смееме да ги ставиме под говор на омраза, говорот на омраза не е поврзан со работата на историската комисија](#), ИМА, 27.07.2022)

<sup>81</sup> Shih: Zharko Trajanoski, “Kokteje Mollotovi të propagandës ruse, dezinformatave dhe gjuhës së urrejtjes” („[Молотови коктелите од проруска пропаганда, дезинформации и говор на омраза](#)”, Независен, 18.07.2022): “Ndaj partive politike dhe deputetëve hidhen kokteje molotovi propagandistike me mallkime, sharje dhe akuzat për tradhti kombëtare, me qëllim të ndezjes së zjarrit politik dhe destabilizimit të “fuqisë ballkanike të barutit”

<sup>82</sup> Shih: “Deputetët - tradhtarë të popullit” porositen protestuesit para Kuvendit në protestën e nëntë kundër propozimit francez” („[Пратеници-предавници на народот](#)” порачаа демонстрантите пред Собранието на деветтиот протест против францускиот предлог, 360 степени, 12.07.2022)

<sup>83</sup> Shih, për shembull: “Tradhtarët kanë emër e mbiemër: Do të kërket përgjegjësi për të gjitha poshtërimet ndaj popullit” ([Предавниците имаат име и презиме: Ке се бара одговорност за сите понижувања на народот](#), Република, 17.07.2022)

<sup>84</sup> Shih: “Apasiev vazhdon me sulmet brutale ndaj gazetarëve dhe përhapjen e dezinformatave” ([Апасиев продолжува со брутални напади врз новинарите и ширење дезинформации](#), ИМА, 20.07.2022)

dhe tradhtarëve vendas” të cilët “vendosur themelet për shkatërrimin e ardhshëm të shtetit me të cilin qeverisin”.<sup>85</sup>

VMRO-DPMNE madje publikoi edhe një video, në të cilën një kuazi gjykatë dënon me 101 vjet burg politikanët Kovacevski, Osmani dhe Mariçiq për kryerje të tradhtisë së lartë.<sup>86</sup>

Sulme të sinkronizuara propagandistike me dezinformata janë vërejtur jo vetëm ndaj politikanëve<sup>87</sup> (përfshirë thirrjet për dhunë)<sup>88</sup>, por edhe ndaj intelektualëve për shkak të pikëpamjeve të publikuara personale.<sup>89</sup> Një fushatë propagandistike me thirrje për linçim u drejtua edhe ndaj anëtarëve të komisionit historik dhe presidentit të tij.<sup>90</sup>

## “Propozimi francez” si platformë për përforcimin e narracioneve antiperëndimore

Një pjesë e narracioneve dezinformuese rreth “propozimit francez” kishin për qëllim minimin e mëtejshëm të besimit në BE (dhe “Perëndimit”), i cili u zvogëlua në mënyrë drastike pas vetos së Bullgarisë për fillimin e negociatave me BE-në.<sup>91</sup>

Dy partitë më të mëdha pro-ruse në Maqedoni (VMRO-DPMNE dhe Levica) sigurisht se kanë dijeni se shumica e anëtarëve të tyre preferojnë Bashkimin Ekonomik Euro-aziatik iluziv, si alternativë ndaj BE-së, kështu që nuk është për t’u habitur që shtabet e tyre përdorin narracione në përputhje me perceptimet e mbështetësve të tyre.<sup>92</sup>

Mu për këtë shkak, nuk është për t’u habitur që «propozimi francez» u shfrytëzua si një platformë për të përforcuar narracionet antiperëndimore nga më tepër aktorë politikë.

Diskursi politik kundër “Evropës” të mishëruar në “propozimin francez” u përdor në protesta nga lideri i VMRO-DPMNE-së, me shprehjen “nuk na duhet Evropa nëse...”, duke e paraqitur atë si kërcënim për Maqedoninë, identitetin, gjuhën, kulturën, historinë dhe

<sup>85</sup> Shih: “Aq mundemi me presidencë qyqare – Pendarovski hoqi dorë nga garancat me shkrim prej Bullgarisë” ([Со кукавичко претседателство толку можеме – Пендаровски се откажа од писмените гаранции од Бугарија](#), levica.mk, 04.07.2022)

<sup>86</sup> Shih: “101 vjet burg për tradhëti që i bënë Maqedonisë Kovaçevski, Osmani dhe Mariçiq” ([101 година затвор за предавство кое Ковачевски, Османи и Мариçик и го направија на Македонија](#), Youtube VMRO-DPMNE, 15.07.2022)

<sup>87</sup> Shih: “Sulme të sinkronizuara ndaj politikanëve në Wikipedia me dezinformim, gjuhë urrejtjeje dhe diskriminim” ([Синхронизирани напади кон политичари на Википедија со дезинформации, поттикнување омраза и дискриминација](#), ИМА, 25.07.2022)

<sup>88</sup> Shih: “Gjuhë e urrejtjes nga Australia që bën thirrje për dhunë kundër politikanëve” ([Говор на омраза од Австралија кој повикува на насилство врз политичари](#), ИМА, 28.07.2022)

<sup>89</sup> Shih: “Gjuhë urrejtjeje dhe sulme të pahijshme ndaj profesoreshës Kolozova për pikëpamje të publikuara personale” ([Говор на омраза и непримерни напади кон професорката Колозова за објавени лични ставови](#), ИМА, 28.07.2022)

<sup>90</sup> Shih: “Emision kontaktues i keqpërdorur nga lajmëruerit për përhapje të gjuhës së urrejtjes dhe thirrjeve për dhunë” ([Контактна емисија злоупотребена од јавувачи за ширење говор на омраза и повикнување на насилство](#), ИМА, 18.08.2022)

<sup>91</sup> Shih: “Nga lavdëratat deri te zhgënjimet: 2021 Analizë e opinionit publik mbi procesin maqedonas të anëtarësimit në Bashkimin Evropian” ([Од пофалби до разочарувања: 2021 Анализа на јавното мислење за македонскиот процес на пристапување кон Европската Унија](#), Фондација Конрад Аденауер во Република Северна Македонија Институт за демократија „Социетас Цивилис“ – Скопје, февруари 2022, стр. 31)

<sup>92</sup> Një nga ideologët e partis E Majta filloi bile të agjitojë hapur se BE-ja nuk do të ekzistojë në këtë formë deri në vitin 2025 dhe se “Rusia do të kontrollojë një pjesë të madhe të Evropës Lindore, nëse jo edhe Ballkanin”, Tweet i Trajçe Stojanov, <https://twitter.com/majevitka/status/1548386898208387074>

trashëgiminë maqedonase<sup>93</sup> Narrativat anti-evropiane arritën kulmin me dezinformimin dhe sulmet e gjuhës së urrejtjes kundër zyrtarëve të BE-së dhe liderëve të Evropës Perëndimore.<sup>94</sup>

Në protestat kundër “propozimit francez” kishte pankarta, parulla dhe thirrje kundër “fashistëve”,<sup>95</sup> ndërsa protestat u cilësuan si “manifestim i pakënaqësisë së qytetarëve maqedonas ndaj propozimit jashtëzakonisht fyes dhe fashizoid të BE-së”<sup>96</sup>. Drejtuesit më të lartë të BE-së emërtoheshin si fashistë dhe krahasoheshin me nazistët, madje edhe në Kuvend.”<sup>97</sup>

Një deputet i partisë E Maja nga foltorja parlamentare pohonte se me propozimin francez, “kënaqen kërkesat fashiste të Bullgarisë, sepse ajo është anëtare dhe ata qëndrojnë bashkë”<sup>98</sup>.

Teoricienët e konspiracionit në “propozimet e Makronit” panë “nisjen e një diktature evropiane mbi popullin maqedonas» dhe «një pushtim të ri të Maqedonisë nga Bullgaria», duke e krahasuar atë me veprimet e Gjermanisë naziste në Luftën e Dytë Botërore.<sup>99</sup>Në këtë teori të konspiracionit, “propozimi francez” përshkruhej si “një instrument për realizim të projektit për aneksim të shtetit të tanishëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut në shtetin e Bullgarisë”.<sup>100</sup>

Analogji të tilla të pabaza historike janë pjesë e narracioneve antiperëndimore, të cilat përpiqeshin të denigronin BE-në si një “krijesë fashiste”. Për shembull, Mirka Velinovska, në paraqitje në podkastin e partisë proruse Rodina Makedonija (“Rodina Maqedoni”), e cilësoi Evropën si nazifashiste, ndërsa propozimin francez si një skandal me fytyrë “nazi-fashiste, evropiane të egër”.<sup>101</sup> Propagandisti prorus Milenko Nedelkovski e përshkroi “propozimin francez” për një media ruse si “gozhdën e fundit në arkivolin në

<sup>93</sup> Shih: “Mickoski nga protesta: Nuk dua të jem në Evropë sepse kam të drejtë të jem maqedonas” ([Мицкоски од протестот: Јас не сакам да бидам во Европа затоа што имам право да бидам Македонец](#), Телма, 02.07.2022): “... të gjithë ata që duan t'i japin fund Maqedonisë me nënshkrim, do t'i japin fund. Neve nuk na duhet Evropa nëse duhet të asimilohemi, tha Mickoski. Unë nuk dua të jem në Evropë sepse kam të drejtë të jem maqedonas, që flet gjuhën maqedonase dhe që lufton për Maqedoninë e tij, për identitetin e tij, për kulturën e tij, për historinë e tij dhe për trashëgiminë e tij”

<sup>94</sup> Sulmet me dezinformata dhe gjuha e urrejtjes deri tani e paparë ndaj përfaqësueses së BE-së, synonin ta spinonin dhe errësonin mesazhin e saj pozitiv dhe pro-evropian në gjuhën maqedonase. Shih: “Sulme të orkestruara me gjuhë urrejtjeje dhe dezinformata kundër von der Leyen dhe BE” ([Оркестрирани напади со говор на омраза и дезинформации кон фон дер Лайен и ЕУ, ИМА, 15.07.2022](#))

<sup>95</sup> Shih: “(LIVE) Me fashista nuk negociohet – filloi protesta kundër propozimit francez” ([Во живо Со фашисти не се преговара – започна протестот против францускиот предлог](#), Антропол, 06.07.2022)

<sup>96</sup> Shih: “Vankovska: Ndaloni propagandën me të cilën përpiqeni të demonizoni protestantët” ([Ванковска: Престанете со пропаганда со која се обидуваат да ги демонизирате протестантите](#), Антропол, 06.07.2022)

<sup>97</sup> Shih: “Bojarovski: Gjuhë ekstreme e urrejtjes dhe sulme mbi liderët e Evropës Perëndimore” ([Бојаровски: Екстремн говор на омраза и напади врз западноевропски лидери, ИМА 17.07.2022](#)): “Është për turp dhe keqardhje të madhe që liderët më të lartë të BE-së u quajtën fashistë nga foltorja e Kuvendit. U përdor analogjia dhe dezinformata më brutale se nazistët erdhën në shtëpinë tonë për të “na sterilizuar ne maqedonasve”, siç i sterilizonin njerëzit me sëmundje trashëgimore në Gjermaninë naziste në vitin 1933”.

<sup>98</sup> Shih: “(Video) Kërmov: Me “propozimin francez” kënaqen kërkesat fashiste – ne do të jemi të penguar përgjithmonë” ([Видео\) Крмов: Со „францускиот предлог“ се удоволуваат фашистичките барања – ние ќе бидеме вечно закочени](#), Антропол, 16.07.2022)

<sup>99</sup> Shih: Pande Kolemishovski, “Propozimi francez i mirë për shtetin – katastrofal për maqedonasit” ([Францускиот предлог добар за државата – катастрофален за Македонците](#), Нова Македонија, 22.06.2022)

<sup>100</sup> Shih: Pande Kolemishovski, “Një shtet me Bullgarinë është qëllimi përfundimtar i propozimit francez” ([Една држава со Бугарија е крајната цел на францускиот предлог, Нова Македонија, 07.07.2022](#))

<sup>101</sup> Mirka Velinovska në “[Родински разговори](#)”, 24.06.2022: “Të shpallësh të vdekur një popull plotësisht të gjallë, t’ia heqësh përshkrimin personal, identitetin, historinë, kulturën, traditat, gjuhën, kishën, gjithçka... ky skandal ka një fytyrë, fashiste, nazifashiste, evropiane, të egër. .. Evropianët nuk janë të qytetëruar, ata nuk janë qytetërim... Maqedonia dhe populli maqedonas janë qytetërim”



të cilin ndodhet kufoma e ish-Maqedonisë”, të cilin po e gozhdon “Bullgaria fashiste”.<sup>102</sup>

Partia pro-ruse “Rodina Maqedonia” gjithashtu inicioi një peticion “për anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Ekonomik Euroaziatik dhe BRICS”, në të cilin inkurajoi maqedonasit “të dalin nga bota euroatlantike GMO, dehumanizuese, poshtëruese, transjinore, LGBT, dhe të bashkohen me botën e pasurisë së kulturave, traditave, vlerave morale, shpirtërore.”<sup>103</sup>

**Kuptohet, mund të vërehet njëfarë ngjashmërie me narracionet destabilizuese pro-ruse nga koha e krizave politike të viteve 2015-2018.**

Edhe lideri i partisë pro-ruse “Maqedonia Unike” e shfrytëzoi propozimin francez për të përhapur teori konspiracioni kundër “globalistëve në NATO dhe BE, të cilët së bashku me kukullat e brendshme duan të fshijnë gjithçka që është maqedonase» dhe kundër «qeverisë kukull” që dëshiron t’i dhurojë “kombin, gjuhën dhe historinë maqedonase Bullgarisë tatarë”.<sup>104</sup>

Kuptohet, mund të vërehet njëfarë ngjashmërie me narracionet destabilizuese pro-ruse nga koha e krizave politike të viteve 2015-2018. Me atë që, në vend që të mbjellin frikë ekzistenciale dhe identitare me “skenarin ukrainas”, “platformën tiranase”, “kantonizimin” dhe “federalizimin” (si në periudhën 2015-2018), narracionet propagandistike pro-ruse tani kërkojnë të rrënojnë krik; identitare dhe ekzistenciale me “propozimin francez” si “skenar bullgar” për “bullgarizim” dhe “asimilim”.

Pas publikimit të “propozimit francez”, në portalet e dominuara nga propaganda militante ruse, më të fuqishme ishin përpjekjet për të ngritur panik për rrezikimin e identitetit dhe gjuhës maqedonase, si dhe sulmet për “tradhti kombëtare”, të shoqëruara me gjuhë që nxit urrejtje (dhe një vërshim komentesh që bëjnë thirrje për dhunë). Edhe në rrjetet sociale binte në sy agjitacioni kundër “propozimit francez” nga ana e armatës proruse të trollëve partiakë, të njohur për nga narracionet antiperëndimore “në emër të popullit”.

## Indicie dhe pohime për ndërhyrje propagandistike ruse

Pohime se Federata Ruse po abuzon me protestat kundër propozimit francez u thanë publikisht nga presidenti Pendarovski më 8 korrik, i cili vuri në dukje se Maqedonia është nën sulme hibride të intensifikuara të ngjashme me ato të vitit 2018.<sup>105</sup> Edhe në një intervistë të mëvonshme, presidenti Pendarovski theksoi se rusët “përipiqen të bëjnë ndikim përmes propagandës politike”, duke vënë në dukje se deklarata e Lavrov është pjesë e asaj propagande politike.<sup>106</sup> Gjithashtu, presidenti Pendarovski theksoi se

<sup>102</sup> Shih: “Eksperti: Bullgaria fashiste godet gozhdën e fundit në arkivolin e Maqedonisë” ([Эксперт: фашистская Болгария забивает последний гвоздь в гроб Македони](#)), 7.07.2022

<sup>103</sup> Shih: “Zgjedhja është një”: Rodina Maqedoni e shpall të vdekur” ([„ЕДЕН Е ИЗБОРОТ“ РОДИНА МАКЕДОНИЈА ГО ПРОГЛАСУВА ЗА УМРЕНИ](#)), Rodina.org.mk. 11.09.2022

<sup>104</sup> Shih: Janko Bačev, [FB Status](#), 01.07.2022.

<sup>105</sup> Shih: “Pendarovski ekskluzivisht në TV21: Federata Ruse po abuzon me faktin se qytetarët po protestojnë në mënyrë legjitime kundër propozimit francez” ([Пендаровски ексклузивно на ТВ21: Руската федерација го злоупотребува тоа што граѓаните легитимно протестираат против францускиот предлог](#)), ТВ21 08.07.2022); “Maqedonia aktualisht është nën sulme hibride të intensifikuara të ngjashme me nivelin që kishim në vitin 2018... Palët e treta, konkretisht Federata Ruse, po abuzojnë me faktin se qytetarët protestojnë në mënyrë legjitime kundër propozimit francez”.

<sup>106</sup> Për propagandën e Llavrovit, shih: “Zharko Trajanoski: Sergej Lavrov dhe propaganda imperialiste “ortodokse” ruse” ([Жарко Трајаноски, Сергеј Лавров и руската „православна“ империјалистичка пропаганда](#)), Независен,



"propaganda ruse, lajmet e rreme ruse, jo vetëm për luftën në Ukrainë, kanë arritur suksese të caktuara në mesin e popullatës në Ballkanin Perëndimor, para së gjithash për shkak të inercisë së BE-së".<sup>107</sup>

Mediat raportuan se sfida kryesore e Agjencisë për Siguri Kombëtare (ANB) kanë qenë "dezinformatat dhe kërcënimet hibride që ishin të pranishme gjatë debatit dhe votimit për propozimit francez për çpëngimin e eurointegritimeve".<sup>108</sup> Drejtori i ANB tregoi se ata kanë qenë të preokupuar me «ballafaqimin me dezinformatat dhe veprimet hibride» dhe se ballafaqimi ka qenë i suksesshëm.<sup>109</sup>

Shefi i diplomacisë, Bujar Osmani nga ana tjetër akuzoi se pakënaqësia në lidhje me "propozimin francez" është krijuar nga qendra politike që shpërndajnë qëllimisht lajme të rreme.<sup>110</sup>

Në këtë analizë u përpoqëm t'i përgjigjemi pyetjes "Çfarë narracionesh me dezinformata u përhapën për "propozimin francez"?". Pyetjes "Kush i ka përhapur dezinformata për "propozimin francez"?" i është përgjigjur vetëm pjesërisht. Për një përgjigje më komplekse, nevojiten kërkime dhe analiza të mëtejshme, të cilat do t'i nënshtrojnë shqyrtimit pretendimet zyrtare për ndërhyrje të propagandës ruse, do të marrin parasysh masat e marra për të luftuar dezinformimin dhe sulmet hibride, si dhe kritikën ndaj autoriteteve për mungesë të transparencës.<sup>111</sup>

---

27.07.2022): "Akuzat e Llavrovit se Perëndimi u përpoq t'i bënte malazezët dhe maqedonasit "instrumente në lojën anti-ruse" pasohet nga një analogji e rreme - "ashtu siç u përpoqën të bënin me Ukrainën dhe një numër vendesh të tjera të Evropës Lindore". Asgjë e re nga propaganda ruse, e cila përdori krizën politike maqedonase të viteve 2015-2017 për të akuzuar Perëndimin për një "skanar ukrainas". Por është propaganda ruse në dekadën e fundit ajo që është dëshmi se Rusia po përpiqet ta kthejë Maqedoninë (dhe jo vetëm Maqedoninë) në një instrument për një lojë antiperëndimore"

<sup>107</sup> Shih: Intervistë e presidentit Pendarovski për javoren "Fokus" ([Интервју на претседателот Пендаровски за неделникот „Фокус“](#), pretsedatel.mk, 28.08.2022): "Askush nuk po ec përpara, asnjë nga gjashtë vendet nuk ka bërë përparim, kështu që u la një hapësirë boshe për skanarë alternativë dhe propaganda ruse gjeti terren pjellor këtu. Nuk është rastësi që mbështetja për BE-në po bie në mënyrë drastike. Nëse BE-ja vazhdon me këtë politikë ndaj Ballkanit Perëndimor, propaganda ruse do të jetë gjithnjë e më e fuqishme"

<sup>108</sup> Shih: "Integrimi evropian me propozimin francez - shkas që forcat destruktive të prishin sigurinë në Maqedoni, përvjetori i Agjencisë për Siguri Kombëtare" ([Европската интеграција со францускиот предлог-повод за деградирани сили да ја нарушат безбедноста во Македонија, годишнина на Агенцијата за национална безбедност](#), Телма, 01.09.2022)

<sup>109</sup> Shih: "Krimi, korrupsioni dhe kërcënimet hibride mbeten një sfidë për ASK-në" ([Криминалот, корупцијата и хибридите закани остануваат предизвик на АНБ](#), Слободен печат, 01.09.2022): "Përcaktimi ynë strategjik për t'u integruar në Bashkimin Evropian dhe marrja e vendimeve politike të kompromisit u përdor si një shkas për forcat destruktive që përpiqen të prishin stabilitetin dhe sigurinë. Dhe pikërisht falë atij koordinimi dhe bashkëpunimi të shkëlqyeshëm ndërinstitucional, ky tentim mbeti pikërisht vetëm një "tentim", theksoi Dimovski.

<sup>110</sup> Shih: "Osmani: Maqedonia e Veriut këto ditë është kthyer në qendër të lajmeve të rreme" ([Османи: Северна Македонија денонсире е претворена во центар за лажни вести](#), Фокус, 18.08.2022)

<sup>111</sup> Për shembull, Bojarovski: "Mësuam se Qeveria ra në provimin e transparencës dhe veçanërisht të përgatitjes së publikut për një proces kaq kompleks", shih: "Bojarovski: Gjuhë ekstreme e urretjes dhe sulme ndaj liderëve të Evropës Perëndimore" ([Бојаровски: Екстремн говор на омраза и напади врз западноевропски лидери](#), ИМА 17.07.2022); shih edhe: "Trajkoska - Mostransparenca për propozimit francez krijon hapësirë për dezinformata" ([Трајкоска - Нетранспарентноста за францускиот предлог создава простор за дезинформации](#), PCE, 11.07.2022)

# 3. SI RAPORTUAN MEDIAT NË GJUHËN SHQIPE PËR “PROPOZIMIN FRANCEZ”?

Shkruan: SEFER TAHIRI

Mediat në gjuhën shqipe kishin raportim kryesisht afirmativ mbi “propozimin francez” për kornizën negociuese të BE-së për fillimin e negociatave për anëtarësim të Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian. Mirëpo, kishte raste të raportimit sensationalist, si dhe raste të dezinformimit. Gjatë protestave të organizuara nga opozita maqedonase, mediat në gjuhën shqipe u fokusuan në antishqiptarizmin e tyre dhe vunë theksin mbi nxitjen e urrejtjes ndëretnike që u shfaq në këto protesta.

## Raportim afirmativ mbi propozimin francez në mediat në gjuhën shqipe

Pas viteve 90-ta, kur filloi pluralizmi demokratik në vend, diskursi politik është dominuar nga frazeologjia integruese. Që nga partia e parë e shqiptarëve, Partia e Prosperiteti Demokratik e deri më sot, në debatin politik, krahas çështjeve që kanë të bëjnë me statusin juridik – kushtetues të shqiptarëve, vëmendje e intensitetit të lartë i është kushtuar procesit të aderimit të Maqedonisë (më pas Maqedonia e Veriut) në Bashkimin Evropian.

Duke pasur parasysh se politika në vendin tonë në masë të madhe modelon agjendën publike dhe mediatike, diskursi politik euroatlantik ka ndikuar edhe ndaj atij mediatik.

Një analizë sipërfaqësore mbi diskursin mediatik të 32 viteve të kaluara tregon qartë se qasja e mediave shqiptare ndaj integrimit euroatlantik, ka qenë ekskluzivisht pozitive.

**Në këtë drejtim, hapësirën informative në gjuhën shqipe në Maqedoninë e Veriut, por edhe atë rajonale, e kanë dominuar raportime me konotacione pozitive mbi “propozimin francez”, ndërsa kritikëve të tij u është dhënë hapësirë e paktë.**

Kjo do të thotë se kritikët ndaj integrimit janë prezantuar vetëm si informacione ditore. Politikanëve, ekspertëve apo opinionistëve që kanë kritikuar integrimin në BE, duke mos e parë si alternativë të vetme, u është dhënë hapësirë minimale në debatet politike, përkatësisht ka ndodhur rrallë, vetëm sa për të plotësuar njërin nga standardet themelore gazetareske, që është balancimi (baraspeshimi) në raportim, por edhe në zhanret tjera gazetareske, përfshirë edhe ato programore – televizive, si intervista, debati e formate tjera.

Mediat në gjuhën shqipe, politika, por edhe mendimi shkencor, sikur kanë ndjekur filozofinë e rilindësve shqiptarë, të cilët moti kanë thënë se “Dielli për shqiptarët lind në Perëndim”.

Kjo linjë editoriale është ndjekur edhe gjatë raportimit dhe debatit mbi Propozimin francez për zgjidhjen e kontesteve mes Shkupit dhe Sofjes.

Në këtë drejtim, hapësirën informative në gjuhën shqipe në Maqedoninë e Veriut, por edhe atë rajonale, e kanë dominuar raportime me konotacione pozitive mbi “propozimin francez”, ndërsa kritikëve të tij u është dhënë hapësirë e paktë dhe, këtu, kemi parasysh qëndrimet zyrtare të partisë opozitare VMRO – DPMNE. Shumë më pak hapësirë i është dhënë partisë “E Majta” (Levica), për shkak të qëndrimeve të saj të vazhdueshme antishqiptare dhe kundër Kosovës, por edhe për shkak të qëndrimeve të saj konstante anti – evropiane dhe anti – NATO.

## Media e njëzëshme: Propozimi francez është i mirë

Në mediat në gjuhën shqipe u është dhënë hapësirë e konsiderueshme deklaratave dhe qëndrimeve të zyrtarëve shtetërorë mbi “propozimin francez” për kornizën e negociatave mes Maqedonisë së Veriut dhe Bashkimit Evropian, në të cilin përfshihen edhe çështjet kontestuese mes Shkupit dhe Sofjes.

Mediat në gjuhën shqipe i kanë dhënë rëndësi të madhe deklaratës së kryeministrit të vendit, Dimitar Kovaçevski, por edhe deklaratave të ministrit të jashtëm, Bujar Osmani, presidentit të vendit, Stevo Pendarovski e zyrtarëve, por edhe politikanëve rajonal e diplomatëve, të cilët shpreheshin me intonacion pozitiv mbi propozimin.

Disa shembuj të raportimit mbi pozicionet politike në Maqedoninë e Veriut ndaj Propozimit francez:

- Propozimi francez, Kovaçevski: Bazë solide për pozicion shtetëror ([TV Alsat, 01.07.2022](#))<sup>1</sup>
- Osmani: Propozimi i ri francez është i mirë, mundësi e fundit që ta kapim trenin për në BE ([TV 21, 02.07.2022](#))<sup>2</sup>
- Propozimi i modifikuar francez është shumë më i mirë se i kaluari, vlerësoi Pendarovski ([Portalb, 30.07.2022](#))<sup>3</sup>
- Zaev: Propozimi francez mbase nuk është më i miri, por është bazë e mirë për fillimin e negociatave ([TV Shenja, 05.07.2022](#))<sup>4</sup>
- Ali Ahmeti: Propozimi francez nuk cënon gjuhën maqedonase ([TV Alsat, 14.07.2022](#))<sup>5</sup>
- Sela: Propozimi i Francës për zgjidhjen e problemeve me Bullgarinë të merret me seriozitet ([30.06.2022](#))<sup>6</sup>

Analiza tekstuale e titujve të lartshënuar tregon se mediat në gjuhën shqipe kanë përzgjedhur gjykime vlerësuese afirmative mbi propozimin, pasi në to dominon narrativi se i njëjti është kompromis. Madje, përveç tonalitetit kompromisues që e ndjek politikën editoriale të mediave shqipe, është vërejtur një lloj tendence e prezantimit të propozimit si i pa alternativë (*mundësi e fundit që ta kapim trenin për në BE*). Në anën tjetër,

<sup>1</sup> Shih: “Propozimi francez, Kovaçevski: Bazë solide për pozicion shtetëror”, botuar në [TV Alsat, 01.07.2022](#)

<sup>2</sup> Shih: “Osmani: Propozimi i ri francez është i mirë, mundësi e fundit që ta kapim trenin për në BE”, botuar në [TV 21, 02.07.2022](#)

<sup>3</sup> Shih: “Propozimi i modifikuar francez është shumë më i mirë se i kaluari, vlerësoi Pendarovski”, botuar në [Portalb, 30.07.2022](#)

<sup>4</sup> Shih: “Zaev: Propozimi francez mbase nuk është më i miri, por është bazë e mirë për fillimin e negociatave”, botuar në [TV Shenja, 05.07.2022](#)

<sup>5</sup> Shih: “Ali Ahmeti: Propozimi francez nuk cënon gjuhën maqedonase”, botuar në [TV Alsat, 14.07.2022](#)

<sup>6</sup> Shih: “Sela: Propozimi i Francës për zgjidhjen e problemeve me Bullgarinë të merret me seriozitet”, botuar në portalin fol.mk, [30.06.2022](#)

duke pasur parasysh sensibilitetin që ka brenda vetes “propozimi francez”, kanë shfaqur raportime të matura, që janë në linjën e moscenimit të identitetit etnokulturor të popullit maqedonas (*propozimi francez nuk cenon gjuhën maqedonase*).

Mediat në gjuhën shqipe nuk i kanë lënë pa prezantuar edhe qëndrimet e opozitës maqedonase, sado që në nivel sasior, krahasuar me deklaratimet afirmative të pushtetit, janë më të pakta. Kjo ka ndodhur për shkak të politikës editoriale të mediave, por edhe për shkak të dinamikës së zhvillimeve politike, në të cilat pushteti ishte tepër aktiv.

Ja disa shembuj:

- Mickovski: Jo propozimit francez, nesër të dalim të gjithë në protesta ([Klan Maqedoni, 01.07.2022](#))<sup>7</sup>
- VMRO-DPMNE në protestë, Mickovski: Jo në Evropë të asimiluar ([Flaka, 02.07.2022](#))<sup>8</sup>
- Propozimi francez: Apasievi paralajmëron radikalizimin e protestave ([Klan Maqedoni, 04.07.2022](#))<sup>9</sup>.

Media në gjuhën shqipe i ka dhënë hapësirë edhe një qëndrimi të liderit të opozitës maqedonase, i cili kundërshton në formë të pyetjes deklarin e kryeministrit shqiptar, Edi Rama (*Mickovski: Nga e di Edi Rama se propozimi francez është i mirë?!*, portali [Flaka, 30.06.2022](#))<sup>10</sup> se propozimi francez është në të mirën e maqedonasve dhe shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut. Rama në Twitter kishte shkruar: “Propozimi i fundit francez, i cili është edhe përfundimtari, i jep Maqedonisë së Veriut mundësinë e një pranimi pa rezervë dhe hap rrugën e nisjes zyrtare të negociatave për anëtarësimin e të dy vendeve në Bashkimin Evropian! Vëllezërve maqedonas & shqiptarë në MV u them: Pranojeni!”. (*Edi Rama ka një kërkesë për shqiptarët dhe maqedonasit e Maqedonisë së Veriut*, [Portalb, 30.06.2022](#)).<sup>11</sup>

Mediat në shqip, një hapësirë të konsiderueshme i kanë dhënë edhe thirrjes së president serb, Aleksandar Vuçiq, që qytetarët e vendit tonë të mos refuzojnë propozimin evropian pa menduar mirë, që kishte tendencë të zbusë pezmin e madh të krijuar ndaj këtij propozimi në qarqe të ndryshme, jo vetëm të së djathtës etnocentrike, por edhe në mesin e atyre që gjithë këto vite shquhen si njerëz që promovojnë vlera evropatlantike. (Propozimi francez: Vuçiq ka një apel për maqedonasit, [TV Alsat, 07.07.2022](#)).<sup>12</sup>

## Përgënjeshtrimi i dezinformacionit të papublikuar

Më 8 korrik të këtij viti në mediat maqedonase, të cilat kanë politikë editoriale pro – opozitare ose nëse nuk janë të tilla kanë qëndrime antiqeveritare, rrufeshëm u shpërnda deklarata e analistes çeke, Jana Juzova. Sipas asaj që ajo gjoja kishte dëgjuar nga MPJ-ja çeke “Ata janë shumë të shqetësuar me Francën dhe Bullgarinë, ndërsa shkaku është që për propozimin nuk ishin konsultuar vendet tjera anëtare, por vetëm Bullgaria”. Këto deklarata Juzova, i bëri në debatin e organizuar nga Instituti i Poliikave Evropiane, që

<sup>7</sup> Shih: “Mickovski: Jo propozimit francez, nesër të dalim të gjithë në protesta”, botuar në [Klan Maqedoni, 01.07.2022](#)

<sup>8</sup> Shih: “VMRO-DPMNE në protestë, Mickovski: Jo në Evropë të asimiluar”, botuar në portalin Flaka, 02.07.2022

<sup>9</sup> Shih: “Propozimi francez: Apasievi paralajmëron radikalizimin e protestave”, botuar në Klan Maqedoni, 04.07.2022

<sup>10</sup> Shih: “Mickovski: Nga e di Edi Rama se propozimi francez është i mirë?!", botuar në portalin Flaka, 30.06.2022

<sup>11</sup> Shih: “Edi Rama ka një kërkesë për shqiptarët dhe maqedonasit e Maqedonisë së Veriut”, botuar në portalin Portalb, 30.06.2022

<sup>12</sup> Shih: “Propozimi francez: Vuçiq ka një apel për maqedonasit”, botuar në TV Alsat, 07.07.2022

është shumë kritik ndaj Propozimit francez, ndërsa tema e tij ishte “Ballkani Perëndimor dhe BE-ja në vitin 2022: çfarë na pret?” Kjo deklaratë madje zuri vend edhe në disa media me reputacion ndërkombëtar në gjuhën maqedonase ([Dojçe Vele, 08.07.2022](#)).<sup>13</sup>

Mediat në gjuhën shqipe, edhe pse nuk e kishin transmetuar qëndrimin e analistes Juzova, i kushtuan hapësirë të madhe qëndrimin të ambasadorit çek në Maqedoninë e Veriut, Jaroslav Ludva, i cili në fakt ishte reagim ndaj qëndrimin të analistes. (Ludva: Jemi të gatshëm për zbatim pa probleme të propozimit francez sapo ta miratojë Shkupi, [Telegrafi, 10.07.2022](#))<sup>14</sup>. Ngjashëm si Telegrafi kanë raportuar edhe mediat tjera, të cilat e citonin ambasadorin çek, i cili thoshte se shteti i tij, si kryesues aktual me Këshillin e Bashkimit Evropian është i gatshëm të kontribuojë për zbatim pa probleme të propozimit francez.

**Një deklaratë tjetër e një analisteje po ashtu ka nxjerrë në pah tendencën e një pjese të mediave, kryesisht në sferën onlajn, që për klikime përdorimin metoda të raportimit sensacionalist, madje edhe kur janë në pyetje çështjet (ndër) etnike, që në Ballkan janë shumë të ndjeshme.**

Ndërkohë, disa media shqiptare, edhe pse pak në numër, pavarësisht politikës së tyre editoriale prointegruese, i kanë dhënë hapësirë analizës së profesorit të politikës dhe historisë së Evropës Juglindore në Universitetin e Gracit, Florian Bieber të publikuar në Twitter. Në shtatë pika ka shpjeguar se pse sipas tij propozimi francez për fillimin e negociatave për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian është “fatkeqësi për zgjerimin” e BE-së dhe nuk është i mirë për vendin. Një pjesë e mediave, në mënyrë jokritike, por vetëm transmetuese kanë rapo-

tuar mbi qëndrimet e Biberit, të cilat natyrisht se janë individuale, por të njëjtat nuk argumentohen me teza konkrete, përfshirë edhe atë se kjo do të shpie drejt siç e quan ai “varrosjes së procesit të zgjerimit”. ([Lajm, 06.07.2022](#)<sup>15</sup>, [Telegrami, 06.07.2022](#)<sup>16</sup>, [Telegrafi, 06.07.2022](#))<sup>17</sup>.

## Raportim sensacionalist i pikëpamjes së analistes

Një deklaratë tjetër e një analisteje poashtu ka nxjerrë në pah tendencën e një pjese të mediave, kryesisht në sferën onlajn, që për klikime përdorimin metoda të raportimit sensacionalist, madje edhe kur janë në pyetje çështjet (ndër) etnike, që në Ballkan janë shumë të ndjeshme.

Mediat në gjuhën shqipe transmetojnë deklaratën e analistes bullgare, Zorica Ilieva, e cila për TV bullgar Pogled ka deklaruar se Maqedonia e Veriut do të federalizohet. Mediat shqipe në datën 9 korrik (portali [Ina-online](#), portali [Zhurnal](#), portali [Medial](#), portali [Lajme.mk](#)), kanë transmetuar deklaratën e Ilievës, e publikuar së pari në [portalin në](#)

<sup>13</sup> Shih: “[Çekia e shqetësuar për shkak të propozimit francez](#)”, botuar në Dojçe Vele maqedonisht, 08.07.2022

<sup>14</sup> Shih: “Ludva: Jemi të gatshëm për zbatim pa probleme të propozimit francez sapo ta miratojë Shkupi”, botuar në portalin [Telegrafi, 10.07.2022](#)

<sup>15</sup> Shih: “Bieber: Propozimi francez është i padrejtë ndaj Maqedonisë, dëmton imazhin e BE-së”, botuar në portalin [Lajm, 06.07.2022](#)

<sup>16</sup> Shih: “Florian Bieber: Propozimi francez për zhblokimin e bllokadës bullgare është një fatkeqësi për zgjerimin...”, botuar në portalin [Telegrami, 06.07.2022](#)

<sup>17</sup> Shih: “Bieber: Propozimi francez është i padrejtë ndaj Maqedonisë, dëmton imazhin e BE-së”, botuar në portalin [Telegrafi, 06.07.2022](#)

[gjuhën maqedonase Expres.mk](#)<sup>18</sup>, por pa i bërë interpretim analitik qëndrimeve të saj. Për shembull nuk u përgënjeshtroa qëndrimi se në rajonin e Tetovës dhe Maqedonisë Perëndimore, nuk jetojnë më ortodoksë! [Regjistrimi i fundit i popullsisë](#)<sup>19</sup>, por edhe vetë realiteti shoqëror dëshmon se jo vetëm në Tetovë, por edhe në mbarë perëndimin e vendit jetojnë maqedonas – ortodoksë. Një deklaratë tjetër e saj, e cila është e pavërtetë dhe dezinforon publikun është se Universiteti i Tetovës është vetëm në gjuhën shqipe. E vërteta është se në [Fakultetin e Filologjisë](#)<sup>20</sup> së këtij universiteti mund të studiohet edhe gjuha maqedonase. Poashtu, media ndër vite, ka raportuar se nuk është i paktë [numri i atyre me përkatësi maqedonase](#),<sup>21</sup> të cilat kanë studiuar në Universitetin e Tetovës!

Prandaj, është me rëndësi që kur transmetohen deklaratat sensitive, përkatësisht që kanë konotacione sensacionale, mediat duhet të jenë të kujdesshme. Të njëjtat jo vetëm që i shtrembërojnë faktet, por mund të shkaktojnë tendosje të marrëdhënieve edhe ashtu të brishta ndëretnike.

## Raportimi i protestave, theksi tek antishqiptarizmi

Në protestat e opozitës kundër “propozimit francez” që ndodhën gjatë muajit korrik, ka pasur edhe brohoritje të shumta që kanë paragjykuar dhe stereotipizuar shqiptarët. Mediat në gjuhën shqipe gjithmonë në titujt kryesore apo në ballinat e portaleve kanë raportuar mbi brohoritjet si “Shqiptarët e mallkuar” (video në kanalin zyrtar të [TV Klan Maqedoni, 12.07.2022](#)).<sup>22</sup>

**Është me rëndësi që kur transmetohen deklaratat sensitive, përkatësisht që kanë konotacione sensacionale, mediat duhet të jenë të kujdesshme. Të njëjtat jo vetëm që i shtrembërojnë faktet, por mund të shkaktojnë tendosje të marrëdhënieve edhe ashtu të brishta ndëretnike.**

Edhe rreth incidentit që ndodhi më 6 korrik, në të cilin ndodhi përplasja mes një pjese të protestuesve kundër “propozimit francez” dhe një grupi të shqiptarëve tek sheshi Skënderbeu në Çarshinë e Vjetër në Shkup, kishte raportime që dallonin varësisht nga gjuha e përdorur. Në mediat shqiptare, personi që gjuajti me armë, Isuf Koka, u prezantua si njeri që këtë veprim e bëri në mbrojtje të pronës

së tij. Titulli i [portalit news 33](#) “Qëlloi me armë në ajër për të mbrojtur pronën nga protestuesit, arrestohet Isuf Koka”<sup>23</sup> e reflekton më së afërmi linjën e përgjithshme të politikës editoriale gjatë raportimit mbi këtë incident.

Në disa media tjera, madje pati edhe raportime me motive etno – folklorike, pasi në to thuhej se Koka, i njohur në opinion si Cufi, me armë e ka mbrojtur statujën e Skënderbeut ([portali Faxweb, 08.07.2022](#))<sup>24</sup>. Ndërsa në asnjë rast nuk ka pasur intonacion

<sup>18</sup> Shih: “Maqedonia do të federalizohet pavarësisht nëse do të hyjë në BE, sipas një analisti bullgar!”, botuar në portalin [expres.mk](#), 09.07.2022

<sup>19</sup> Shih: Të dhëna zyrtare nga regjistrimi i popullsisë 2021, ueb-faqja e [Entit Shtetëror për Statistikë](#)

<sup>20</sup> Shih: faqja zyrtare e [Universitetit Shtetëror të Tetovës](#)

<sup>21</sup> Shih: “Branitellat” dhe ish ushtarët e “UÇK-së”, në listën pa pagesë të USHT-së”, botuar në [portalin Portalb](#), 18.09.2013

<sup>22</sup> Shih: Video në kanalin zyrtar të [TV Klan Maqedoni, 12.07.2022](#)

<sup>23</sup> Shih: “Qëlloi me armë në ajër për të mbrojtur pronën nga protestuesit, arrestohet Isuf Koka”, botuar në [portalin News 33](#), 06.07.2022

<sup>24</sup> Shih: “Hakmerren maqedonasit ndaj shqiptarit që mbrojt me armë statujën e Skënderbeut, ja çfarë mase vendosi gjykata për biznesmenin”, botuar në [portalin Faxweb](#), 08.07.2022

raportues që dënon përdorimin e armës, pavarësisht fakteve që u dëshmuuan më vonë gjatë ekspertizës, mes tjerash se njëri prej të akuzuarve ka përdorur edhe armë që nuk është e zjarrit.

## Përfundime të shkurtra

Në përfundim lirisht mund të konstatojmë se në mediat në gjuhën shqipe ka dominuar politika editoriale që favorizon procesin e integritimit në Bashkimin Evropian, duke e parë madje si alternative të vetme për të ardhmen e qytetarëve të Maqedonisë së Veriut. Kjo do të thotë se nuk ekzistojnë media, në të cilat mund të lexohen përmbajtje kundër vlerave evropiane, përkatësisht që në masë të madhe u japin hapësirë zërave antiperëndimorë.

Në anën tjetër, për tu vlerësuar është raportimi dhe qasja konstruktive mbi çështjet e ndjeshme identitare në raport me shtetin fqinj – Bullgarinë.

Në kontekst të protestave, për shkak se shqiptarët janë grupi targetues i publikut, mediat shqipe theksin e vënë mbi shprehjen e pakënaqësive ndaj propozimit francez, duke përdorur narrativin maqedonasocentrik, i cili ka qenë dhe fatkeqësisht vazhdon të jetë antishqiptar .

*(Autori është profesor universiteti në lëminë e gazetarisë dhe komunikimeve publike)*

# 4 ■ NEGOCIATAT ME BE-NË DHE MARRËVESHJA ME BULLGARINË: ORGANIZATAT MEDIATIKE MBËSHTESIN LUFTËN KUNDËR GJUHËS SË URREJTJES, KRITIKA PËR MËNYRËN E ZBATIMIT DHE TRANSPARENCËN

Shkruan: PETRIT SARAÇINI

Ballafaqimi me gjuhën e urrejtjes është një nga kriteret, sipas të cilit do të matet progresi i Maqedonisë së Veriut në përmbyshjen e kornizës negociuese me BE-në, por edhe në përmbyshjen e Marrëveshjes për Fqinjësi të Mirë dhe Miqësi me Republikën e Bullgarisë. Ky është epilogu formal, por ambienti në të cilin u zhvillua i gjithë procesi i negociatave dhe debati publik për të ashtuquajturin “propozim francez”, Protokollin e ri dhe zbatimin e Marrëveshjes së Fqinjësisë së Mirë me Bullgarinë, ishte i tensionuar.

Atmosfera në të cilën u zhvillua debati publik ishte përsëri e polarizuar, plot me dezinformata dhe gjuhë urrejtjeje. Siç veçmë [publikoi IMA në analizën e Zoran Bojarovskit](#),<sup>1</sup> gjatë periudhës kur kjo temë ishte aktuale, është vërejtur një rritje e madhe, apo “shpërthim” i gjuhës së urrejtjes.

Çfarë përmbajnë dokumentet për gjuhën e urrejtjes, çfarë efekti mund të kenë mbi mediat dhe komunikimin publik?

Në [Qëndrimin e përgjithshëm të takimit ministror të konferencës ndërqeveritare për përfundimin e hapjes së negociatave për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian](#),<sup>2</sup> gjegjësisht “propozimin francez” siç u pranua si emërtim gjerësisht nga publiku, në pikën 35, ndër të tjera, thuhet se “Maqedonia e Veriut përmes një procesi gjithëpërfshirës do të miratojë një Plan Veprimi kushtuar mbrojtjes së të drejtave të pjesëtarëve të pakicave apo komuniteteve, duke përfshirë, ndër të tjera, në fushën e mosdiskriminimit, luftimin e gjuhës së urrejtjes, arsimin, vendosjen e masave efektive, mekanizmave të raportimit dhe identifikimin e institucioneve përkatëse përgjegjëse. Zbatimi i këtij Udhërrëfyesi dhe Plani të Veprimit do të monitorohet dhe rishikohet vazhdimisht në Konferencat Ndërqeveritare gjatë gjithë procesit”.

<sup>1</sup> Shih, Zoran Bojarovski, “Shpërthim i gjuhës së urrejtjes në debatin publik lidhur me “propozimin francez””, botuar në [portalin e IMA](#), 06.08.2022

<sup>2</sup> Shih: Qëndrimi i përgjithshëm i takimit ministror të konferencës ndërqeveritare për përfundimin e hapjes së negociatave për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian, botuar në [faqen zyrtare të Qeverisë së Maqedonisë së Veriut](#)



**Qëndrimi i përgjithshëm i takimit ministror të konferencës ndërqeveritare për përfundimin e hapjes së negociatave për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian, pika 35**

*Prandaj, Maqedonia e Veriut do të ftohet të përgatisë një udhërrëfyes për kapitujt mbi sundimin e ligjit (23 – Gjyqësori dhe të drejtat themelore dhe 24 – Drejtësia, liria dhe siguria). Ky udhërrëfyes do të miratohet nga autoritetet e Maqedonisë së Veriut bazuar në udhëzimet e dhëna në raportet e skringut të Komisionit dhe pas një procesi transparent të konsultimit domethënës me të gjitha palët relevante, përfshirë shoqërinë civile. Udhërrëfyesi duhet të përmbajë prioritetet kryesore të reformës dhe të drejtë negociatave të anëtarësimit në këta kapituj dhe përgatitjet për të përmbushur kërkesat e anëtarësimit.*

*Maqedonia e Veriut përmes një procesi gjithëpërfshirës do të miratojë një Plan Veprimi kushtuar mbrojtjes së të drejtave të pjesëtarëve të pakicave apo komuniteteve, duke përfshirë, ndër të tjera, në fushën e mosdiskriminimit, luftimin e gjuhës së urrejtjes, arsimit, vendosjen e masave efektive, mekanizmave të raportimit dhe identifikimit të institucioneve përkatëse përgjegjëse. Zbatimi i këtij Udhërrëfyesi dhe Plani të Veprimit do të monitorohet dhe rishikohet vazhdimisht në Konferencat Ndërqeveritare gjatë gjithë procesit.*

Gjuha e urrejtjes përmendet edhe në [Protokollin](#) <sup>3</sup> e Komisionit të Përbashkët Ndërqeveritar, i themeluar në bazë të nenit 12 të Marrëveshjes për Miqësi, Fqinjësi të Mirë dhe Bashkëpunimi ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Bullgarisë (i cili u botua në [mediat në gjuhën maqedonase që transmetuan përmbajtjen nga agjencia bullgare BGNES](#)),<sup>4</sup> në pikën e tretë të rendit të ditës, kapitulli I, mbi Masat që duhen marrë përpara Konferencës Ndërqeveritare për përfundimin e fazës së hapjes së negociatave të anëtarësimit:

**Protokolli i Komisionit të Përbashkët Ndërqeveritar, i krijuar në bazë të nenit 12 të Marrëveshjes për Miqësi, Fqinjësi të Mirë dhe Bashkëpunimi ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Bullgarisë, 17 korrik 2022, Sofje**

*Gjuha e urrejtjes*

*Shtetet e konfirmojnë detyrimin për të marrë masa kundër çdo lloj gjuhe të urrejtjes dhe përcaktojnë Ministrinë e Punëve të Jashtme për kontakt dhe informim të institucioneve kompetente për identifikimin e përbashkët të rasteve të tilla, në mbishkrime të ndërtesave dhe monumenteve publike, përmbajtjeve në tekstet shkollorë dhe programeve shkollorë, si si dhe në hapësirën publike.*

<sup>3</sup> Shih: "PROTOKOLL nga Takimi i Dytë i Komisionit të Përbashkët Ndërqeveritar, i themeluar në bazë të nenit 12 të Marrëveshjes për miqësi, fqinjësi të mirë dhe bashkëpunim ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Bullgarisë, i cili u mbajt më 17 korrik 2022 në Sofje", botuar në [Agjencionin Mediatik Informativ MIA](#)

<sup>4</sup> Shih: "BGNES: Teksti i plotë i Protokollit ndërmjet RSM dhe Bullgarisë" (БГНЕС: Целосниот текст на Протоколот меѓу РСМ и Бугарија), botuar në portalin [360stepeni.mk](#), 22.06.2022

*Shtetet do të vendosin, pa vonesë, procedurë adekuate dhe hapa konkretë për marrjen e masave të shpejta dhe efektive gjatë identifikimit të rasteve të tilla. Të dy shtetet do të marrin masa efektive për të parandaluar propagandën keqdashëse nga ana e institucioneve dhe agjencive dhe do të dekurajojnë aktivitetet e subjekteve private, që synojnë nxitjen e dhunës, urrejtjes apo aktiviteteve të tjera të ngjashme, të cilat do të dëmtonin marrëdhëniet e tyre.*

Vallë është ky proces transparent dhe i qartë për të gjithë të cilëve u referohet? Cilat mekanizma dhe institucione kompetente do të veprojnë në bazë të këtyre kritereve? Cilat përkufizime do të përdoren për gjuhën e urrejtjes, a mjaftojnë dhe a zbatohen ligjet aktuale, a do të ketë ndryshime? A mund të ketë abuzime me mekanizmat për të cenuar lirinë e shprehjes? Çfarë efekti do të ketë në media, tradicionale dhe online, çfarë efekti në komunikimin përmes mediave sociale? Këto dhe dilema të tjera ishin pjesë e diskutimit publik gjatë gjithë kësaj periudhe.

Lidhur me trajtimin e gjuhës së urrejtjes në kuadër të negociatave me BE-në dhe përmeshjes së Marrëveshjes për Miqësi me Bullgarinë, kërkuam mendimin e organizatave mediatike profesionale dhe eksperte në vend.

Mbështetja e tyre për luftën kundër gjuhës së urrejtjes është me aklamacion. Njëzëri është edhe mbështetja për zbatimin e legjislacionit të vendit dhe të konventave të Këshillit të Evropës, të cilat janë të detyrueshme për vendin tonë. Mirëpo, ato shprehin disa rezervë për mënyrën e realizimit të kësaj lufte, transparencën, efikasitetin e mekanizmave ekzistues dhe mundësitë e keqpërdorimeve për të cenuar lirinë e shprehjes.

## Sinadinovska: Këto vlera janë mbi të gjitha politikat ditore, nuk ka transparencë, zbatim i është brengosës

Fillimisht, në fund të qershorit 2022, kur këto çështje dhe negociatat ishin më aktuale dhe në fokus të publikut, kurse formulacionet e dokumenteve tashmë qarkullonin në media, IMA kërkoi mendim nga Katerina Sinadinovska, kryetare e Bordit Drejtues të Këshillit për Etikë në Mediat në Maqedoni, KEMM. Ajo atëherë theksoi se në lidhje me ato paralajmërime, konkretisht për atë pjesë, nuk mund të deklarohen, sepse fatkeqësisht ato përmbajtje nuk kanë ardhur nga autoritetet vendore, të cilat është dashur të jenë transparente, por nga mediat bullgare.

“Është thelbësore të dihet se në atë proces gjuha e urrejtjes duhet të përkufizohet sipas njërit prej përkufizimeve të punës të pranuar ndërkombëtarisht të termit “gjuhë urrejtjeje” (OKB, Këshilli i Evropës), sepse, nëse nuk ka korniza të tilla, është shumë e mundur të lihet vend për ta kthyer këtë në një gjueti shtrigash dhe një sulm ndaj lirisë së shprehjes. Çështja është veçanërisht delikate, sepse në rastin konkret i referohet një situatë të problemit të hapur me një fqinj, dhe kjo krijon nevojën absolute, natyrisht, për të futur parimin e reciprocitetit në monitorimin e këtij fenomeni, dhe kjo nuk duhet të harrohet”, thekson Sinadinovska.

Ajo që e shqetëson Sinadinovskën, anësh aktualiteteve me integrimet evropiane, është zbatim i rregullave ligjore për luftimin e gjuhës së urrejtjes në vendin tonë në përgjithësi, jo vetëm për Bullgarinë.

“Të gjithë jemi dëshmitarë se sidomos gjyqësori (por edhe Ministria e Punëve të

Brendshme) duhet të jetë shumë më e të angazhuar, por edhe më të vetëdijshëm për rëndësinë e mirëmbajtjes së kësaj luftime. Në hijen e ngjarjeve, disi u harrua se kjo luftë është universale, qytetëruese dhe nuk ka dhe nuk duhet të ketë lidhje me Bullgarinë apo të bëhet për hir të Bullgarisë apo BE-së. Ky është detyrimi ynë gjithsesi, po aq sa është edhe i shtetit bullgar, pavarësisht nga mosmarrëveshja aktuale dhe pavarësisht - ose aq më tepër bile, që bëhet fjalë për shtet anëtar. Këto vlera janë mbi të gjitha politikë ditore, madje edhe çështjeve ndërshtetërore, sepse janë njerëzore", thotë Sinadinovska nga KEMM në përgjigjet e saj në pyetjet e IMA-s.

*Katarina Sinadinovska, KEMM, 28.06.2022*

*Në lidhje me ato njoftime, konkretisht për atë pjesë, nuk mund të deklarohe mi, sepse fatkeqësisht ato përmbajtje nuk kanë ardhur nga autoritetet vendore, të cilat është dashur të jenë transparente, por nga mediat, edhe atë bullgare.*

*Është thelbësore të dihet se në atë proces gjuha e urrejtjes duhet të përkufizohet sipas njërit prej përkufizimeve të punës të pranuar ndërkombëtarisht të termit "gjuhë urrejtjeje" (OKB, Këshilli i Evropës), sepse, nëse nuk ka korniza të tilla, është shumë e mundur të lihet vend për ta kthyer këtë në një gjueti shtrigash dhe një sulm ndaj lirisë së shprehjes. Çështja është veçanërisht delikate, sepse në rastin konkret i referohet një situatë të problemit të hapur me një fqinj, dhe kjo krijon nevojën absolute, natyrisht, për të futur parimin e reciprocitetit në monitorimin e këtij fenomeni, dhe kjo nuk duhet të harrohet.*

*Ajo që më shqetëson, anësh aktualiteteve me integritet evropiane, është zbatimi i legjislacionit ligjor për të luftuar gjuhën e urrejtjes në vendin tonë në përgjithësi, jo për Bullgarinë. Të gjithë jemi dëshmitarë se sidomos gjyqësori (por edhe Ministria e Punëve të Brendshme) duhet të jetë shumë më e të angazhuar, por edhe më të vetëdijshëm për rëndësinë e mirëmbajtjes së kësaj luftime. Në hijen e ngjarjeve, disi u harrua se kjo luftë është universale, qytetëruese dhe nuk ka dhe nuk duhet të ketë lidhje me Bullgarinë apo të bëhet për hir të Bullgarisë apo BE-së. Ky është detyrimi ynë gjithsesi, po aq sa është edhe i shtetit bullgar, pavarësisht nga mosmarrëveshja aktuale dhe pavarësisht - ose aq më tepër bile, që bëhet fjalë për shtet anëtar. Këto vlera janë mbi të gjitha politikë ditore, madje edhe çështjeve ndërshtetërore, sepse janë njerëzore"*

## SHGM: Mos të lejohen abuzime, një formulim i përgjithshëm mbi gjuhën e urrejtjes mund të shkaktojë censurë

Më vonë gjatë kësaj periudhe, gjatë gushtit dhe fillimit të shtatorit 2022, për gjuhën e urrejtjes në kuadër të negociatave me BE-në dhe përmbushjes së Traktatit të Miqësisë me Bullgarinë, IMA kërkoi mendimin e disa organizatave të tjera profesionale dhe eksperte të medias me përvojë shumëvjeçare në këtë fushë.

Në përgjigjet për IMA, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) thotë se gjithmonë reagon publikisht dhe me zëshëm kur njuh gjuhë të urrejtjes që u drejtohet gazetarëve dhe mediave në vend. Një nga rezultatet, siç theksojnë ata, është vendimi i vetëm

I plotfuqishëm gjyqësor në favor të SHGM-së për gjuhën e urrejtjes në mediat sociale në kontekst lokal, i sjellur në dhjetor të viti 2021. ZNM informon se me organizata të tjera partnere nga sektori i mediave, rregullisht inicojnë debate publike për rrezikun nga gjuha e urrejtjes dhe pasojat kur ajo nuk sanksionohet.

“Në rastin e trajtimit të gjuhës së urrejtjes në kuadër të negociatave me BE-në dhe përmbushjes së Traktatit të Miqësisë me Bullgarinë, qëndrimi i SHGM-së është se gjuha e urrejtjes përfaqëson vepër penale pavarësisht për çfarë konteksti bëhet fjalë, kur ka shembuj të qartë të gjuhës së urrejtjes edhe institucionet duhet të tregojnë proaktivitet, pavarësisht nëse ai plasohet në mediat tradicionale, dixhitale apo sociale. Vetëm përmes një reagimi të koordinuar dhe institucional ndaj kryerësve nga Prokuroria Publike dhe Ministria e Punëve të Brendshme do të mund të bëhet një betejë efikase dhe efektive kundër gjuhës së urrejtjes.

Po ashtu, një rol të rëndësishëm në këtë segment luan edhe rregullatori i medias. Gjuha e urrejtjes mund të shkaktojë tensione në baza etnike, fetare, partiake e të tjera, sidomos kur transmetohet nga televizionet kombëtare dhe pikërisht për këtë, rregullatori i medias ka një rol shumë të rëndësishëm në parandalimin dhe sanksionimin. Në kontekst të negociatave me BE-në, SHGM mendon se nuk duhet lejuar që disa institucione të keqpërdorin autoritetin e tyre, respektivisht të mos lejohet që një formulim i përgjithshëm i gjuhës së urrejtjes të ndikojë në lirinë e shprehjes dhe të mendimit, gjegjësisht të mos shkaktohet censurë”, thuhet në përgjigjen e SHGM për IMA.

#### *Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë SHGM , 24.08.2022*

*Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) gjithmonë reagon publikisht dhe zëshëm kur njih gjuhë të urrejtjes që u drejtohet gazetarëve dhe punonjësve të mediave në vend. Një nga rezultatet është i vetmi gjykim i plotfuqishëm në favor të SHGM për gjuhën e urrejtjes në mediat sociale në një kontekst lokal, i cili u soll në dhjetor të vitit 2021. SHGM dhe organizatat e tjera partnere nga sektori i medias rregullisht inicojnë debate publike për rrezikun nga gjuha e urrejtjes dhe pasojat kur ajo nuk sanksionohet.*

*Në rastin e trajtimit të gjuhës së urrejtjes në kuadër të negociatave me BE-në dhe përmbushjes së Traktatit të Miqësisë me Bullgarinë, qëndrimi i SHGM-së është se gjuha e urrejtjes përfaqëson vepër penale pavarësisht për çfarë konteksti bëhet fjalë, kur ka shembuj të qartë të gjuhës së urrejtjes edhe institucionet duhet të tregojnë proaktivitet, pavarësisht nëse ai plasohet në mediat tradicionale, dixhitale apo sociale. Vetëm përmes një reagimi të koordinuar dhe institucional ndaj kryerësve nga Prokuroria Publike dhe Ministria e Punëve të Brendshme do të mund të bëhet një betejë efikase dhe efektive kundër gjuhës së urrejtjes.*

*Po ashtu, një rol të rëndësishëm në këtë segment luan edhe rregullatori i medias. Gjuha e urrejtjes mund të shkaktojë tensione në baza etnike, fetare, partiake e të tjera, sidomos kur transmetohet nga televizionet kombëtare dhe pikërisht për këtë, rregullatori i medias ka një rol shumë të rëndësishëm në parandalimin dhe sanksionimin. Në kontekst të negociatave me BE-në, SHGM mendon se nuk duhet lejuar që disa institucione të keqpërdorin autoritetin e tyre, respektivisht të mos lejohet që një formulim i përgjithshëm i gjuhës së urrejtjes të ndikojë në lirinë e shprehjes dhe të mendimit, gjegjësisht të mos shkaktohet censurë*

## Instituti RESIS: Është problematik zbatimi i Marrëveshjes, të respektohen detyrimet ekzistuese dhe instrumentet juridike të Këshillit të Evropës për të drejtat e njeriut

Dr. Snezhana Trpevska nga Instituti RESIS konsideron se si shtet anëtar i Këshillit të Evropës, vendi ynë ka marrë përsipër të respektojë dhe zbatojë të gjitha instrumentet juridike të Këshillit të Evropës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut - në radhë të parë Konventën Evropiane për Të Drejtat e Njeriut me vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, por edhe rezolutat, rekomandimet dhe deklaratat e miratuara nga Komiteti i Ministrave dhe Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës.

"Disa dokumente kyçe të Këshillit të Evropës i referohen pikërisht çështjes së gjuhës së urrejtjes si në mediat tradicionale ashtu edhe në sferën online. Shkurtimisht, të gjitha këto dokumente detyrojnë secilin vend të krijojë një kornizë rregullative gjithëpërfshirë ose holistike për trajtimin e gjuhës së urrejtjes, e cila duhet të përbëhet nga masa të ndryshme ligjore, rregullatore, vetërregulluese dhe një sërë masash të tjera. As për ne dhe as për Republikën e Bullgarisë, e cila është edhe anëtare e Këshillit të Evropës, nuk duhet të lindë asnjë detyrim i ri nga Marrëveshja për Miqësi. Kjo do të thotë se monitorimi, identifikimi dhe sanksionimi i gjuhës së urrejtjes në të dyja vendet duhet të bëhet si më parë, në kuadër të sistemit të vendosur të masave ligjore dhe të tjera", vlerëson Trpevska.

Ajo thekson dy situata problematike në kontekst të zbatimit të Marrëveshjes për Miqësi:

"Së pari, futja e Ministrive të Jashtme të dy vendeve si pika "...për kontakt dhe për informimin e institucioneve kompetente për evidentimin e përbashkët të rasteve të tilla, në mbishkrime të ndërtesave dhe monumenteve publike, përmbajtjet në tekste dhe programe mësimore, si dhe në hapësirën publike." Kjo del krejtësisht jashtë kuadrit rregullator të vendosur, aq më tepër që as kjo dhe as ndonjë ministri tjetër nuk mund të ketë autoritetin për të monitoruar, raportuar apo vepruar për cilin do rast të gjuhës së urrejtjes", vlerësojnë në RESIS.

Së dyti, RESIS vë në dukje kompleksitetin e problemit të përcaktimit të "gjuhës së urrejtjes" në kontekst të marrëdhënieve midis dy shteteve, ose siç thonë, absurditetin dhe pazbatueshmërinë e kësaj mase, veçanërisht nëse merret parasysh përkufizimi për gjuhën e urrejtjes, i dhënë në Rekomandimin 97(20) të Këshillit të Evropës, sipas të cilit gjuhë e urrejtjes janë: "...të gjitha format e shprehjes që përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjeje të ndryshme, ksenofobi, antisemitizëm apo forma të tjera të urrejtjes të bazuara në jotolerancë, duke përfshirë jotolerancën e shprehur përmes nacionalizmit dhe etnocentrizmit agresiv, diskriminimit dhe armiqësisë ndaj pakicave, emigrantëve dhe njerëzve me origjinë migrante."

"Për shembull, vallë është dhe si është e mundur që një shtet përmes kornizës rregullatore të vendosur të sanksionojë emanimin sistematik të nacionalizmit apo etnocentrizmit që buron nga institucionet dhe politikanët e tij dhe i drejtohet popullit të një shteti tjetër? Për më tepër, a është e mundur dhe si është e mundur që shteti tjetër, përmes kornizës së vendosur rregullative, të sanksionojë pakënaqësinë masive, jotolerancën, përfshirë gjuhën e urrejtjes, e cila është reagim ndaj jotolerancës dhe nacionalizmit të shtetit të parë?", pyet Trpevska.

*Dr. Snezhana Trpevska, Instituti RESIS , 29.08.2022*

*Si shtet anëtar i Këshillit të Evropës, vendi ynë ka marrë përsipër të respektojë dhe zbatojë të gjitha instrumentet juridike të Këshillit të Evropës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut - në radhë të parë Konventën Evropiane për Të Drejtat e Njeriut me vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, por edhe rezolutat, rekomandimet dhe deklaratat e miratuara nga Komiteti i Ministrave dhe Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës.*

*Disa dokumente kyçe të Këshillit të Evropës i referohen pikërisht çështjes së gjuhës së urrejtjes si në mediat tradicionale ashtu edhe në sferën online. Shkurtimisht, të gjitha këto dokumente detyrojnë secilin vend të krijojë një kornizë rregullative gjithëpërfshirëse ose holistike për trajtimin e gjuhës së urrejtjes, e cila duhet të përbëhet nga masa të ndryshme ligjore, rregullatore, vetërregulluese dhe një sërë masash të tjera. As për ne dhe as për Republikën e Bullgarisë, e cila është edhe anëtare e Këshillit të Evropës, nuk duhet të lindë asnjë detyrim i ri nga Marrëveshja për Miqësi. Kjo do të thotë se monitorimi, identifikimi dhe sanksionimi i gjuhës së urrejtjes në të dyja vendet duhet të bëhet si më parë, në kuadër të sistemit të vendosur të masave ligjore dhe të tjera.*

*Ajo që është problematike në kontekstin e zbatimit të Marrëveshjes për Miqësi me Republikën e Maqedonisë është:*

*(1) Së pari, futja e Ministrive të Jashtme të dy vendeve si pika "...për kontakt dhe për informimin e institucioneve kompetente për evidentimin e përbashkët të rasteve të tilla, në mbishkrime të ndërtesave dhe monumenteve publike, përmbajtjet në tekste dhe programe mësimore, si dhe në hapësirën publike." Kjo del krejtësisht jashtë kuadrit rregullator të vendosur, aq më tepër që as kjo dhe as ndonjë ministri tjetër nuk mund të ketë autoritetin për të monitoruar, raportuar apo vepruar për cilin do rast të gjuhës së urrejtjes;*

*2) Së dyti, kompleksiteti i problemit të përcaktimit të "gjuhës së urrejtjes" në kontekst të marrëdhënieve midis dy shteteve, ose absurditeti dhe pazbatueshmëria e kësaj mase, veçanërisht nëse merret parasysh përkufizimi për gjuhën e urrejtjes, i dhënë në Rekomandimin 97(20) të Këshillit të Evropës, sipas të cilit gjuhë e urrejtjes janë: "...të gjitha format e shprehjes që përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjeje të ndryshme, ksenofobi, antisemitizëm apo forma të tjera të urrejtjes të bazuara në jotolerancë, duke përfshirë jotolerancën e shprehur përmes nacionalizmit dhe etnocentrizmit agresiv, diskriminimit dhe armiqësisë ndaj pakicave, emigrantëve dhe njerëzve me origjinë migrante." Për shembull, vallë është dhe si është e mundur që një shtet përmes kornizës rregullatore të vendosur të sanksionojë emanimin sistematik të nacionalizmit apo etnocentrizmit që buron nga institucionet dhe politikanët e tij dhe i drejtohet popullit të një shteti tjetër? Për më tepër, a është e mundur dhe si është e mundur që shteti tjetër, përmes kornizës së vendosur rregullative, të sanksionojë pakënaqësinë masive, jotolerancën, përfshirë gjuhën e urrejtjes, e cila është reagim ndaj jotolerancës dhe nacionalizmit të shtetit të parë?*

## IMM: Dispozitat nuk do të ngrohin marrëdhëniet, detyrimet janë asimetrike, është e pamundur të zbatohen në praktikë

As nuk do të “ngrohen” marrëdhëniet mes dy vendeve, nëse ky është qëllimi i këtyre dispozitave të Marrëveshjes, e as nuk është e mundur të zbatohen në praktikë, para së gjithash sepse detyrimet mes dy vendeve janë asimetrike, ndërsa qëndrimet zyrtare të Republikës së Bullgarisë, e cila mohon gjuhën dhe kombin maqedonas, mund të cilësohet si gjuhë e urrejtjes, thotë Biljana Petkovska, drejtoreshë e Institutit Maqedonas për Media, në pyetjet e dërguara nga IMA.

“Gjithashtu, zbatimi i dispozitave të marrëveshjes nuk duhet të interpretohet në një mënyrë që mund të përfaqësojë censurë të veprave të kaluara dhe të ardhshme të artit, kulturës dhe letërsisë. Moszbatimi eventual do të jetë vetëm në dëm të vendit tonë, gjë që mund të kontribuojë të shtyhet fillimi i negociatave të vendit me BE-në në pafundësi”, paralajmëron nga IMM.

*Biljana Petkovska, Instituti Maqedonas për Media , 5 shtator 2022*

*As nuk do të “ngrohen” marrëdhëniet mes dy vendeve, nëse ky është qëllimi i këtyre dispozitave të Marrëveshjes, e as nuk është e mundur të zbatohen në praktikë, para së gjithash sepse detyrimet mes dy vendeve janë asimetrike, ndërsa qëndrimet zyrtare të Republikës së Bullgarisë, e cila mohon gjuhën dhe kombin maqedonas, mund të cilësohet si gjuhë e urrejtjes.*

*Gjithashtu, zbatimi i dispozitave të marrëveshjes nuk duhet të interpretohet në një mënyrë që mund të përfaqësojë censurë të veprave të kaluara dhe të ardhshme të artit, kulturës dhe letërsisë. Moszbatimi eventual do të jetë vetëm në dëm të vendit tonë, gjë që mund të kontribuojë të shtyhet fillimi i negociatave të vendit me BE-në në pafundësi*

## Metamorfozis: Trajtim sipas standardeve të Këshillit të Evropës, nevojitet efikasitet dhe llogaridhënie më e madhe e autoriteteve shtetërore përgjegjëse

Nga Fondacioni Metamorfozis përkujtojnë për vlerësimet e tyre të vazhdueshme se ka shumë manipulime në opinion lidhur me termin gjuhë urrejtjeje si kategori ligjore, përkufizimin e tij dhe kompetencat për mbrojtje nga ky abuzim i lirisë së shprehjes. Sipas tyre, rezultati përfundimtar i këto manipulime, të cilat krijojnë mjegull rreth kuptimit të vetë termit, është mundësimi i mosndëshkimit të autorëve të dyshuar dhe zgjerimi i hapësirës për abuzime politike në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

“Ashtu si në të gjitha situatat e tjera, sa i përket kontekstit të negociatave me BE-në dhe përmbushjes së Marrëveshjes për Miqësi me Bullgarinë, është e rëndësishme që të përcaktohen qartë kriteret për trajtimin e kësaj vepre penale sipas standardeve të Këshillit të Evropës, si dhe komunikim i qartë me publikun për kriteret dhe rolet e të gjitha institucioneve të sistemit gjatë atij procesi, veçanërisht të atyre që janë pjesë e sistemit



gjyqësor. Nevoja për rritjen e efikasitetit dhe llogaridhënies së organeve shtetërore përgjegjëse për mbrojtjen e qytetarëve në këtë drejtim për vite me radhë është pjesë e nevojave të shprehura përmes raporteve të progresit të përgatitura nga Komisioni Evropian”, thotë Filip Stojanovski nga Metamorfozis.

“Ky proces mund të përfshijë edhe plotësimin e legjislacionit përmes një procesi konsultimi dhe debati të gjerë publik që do të rrisë ndërgjegjësimin e publikut për kuptimin e vërtetë juridik të termit, duke inkuadruar drejtpërdrejt jurisprudencën e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut nga Strasburgu, e cila është organi më i lartë gjyqësor për raste të tilla në sistemin juridik të vendit tonë”, thekson Stojanovski.

Në të njëjtën kohë, sipas Metamorfozis, procesi duhet të përfshijë edukimin e të gjitha palëve të përfshira për të gjitha aspektet e problemit, veçanërisht ato ligjore, sepse është konstatuar mungesë njohurish dhe ndërgjegjësimi pothuajse në të gjitha nivelet.

*Filip Stojanovski, Fondacioni Metamorfozis, 2 shtator 2022*

*Fondacioni Metamorfozis që më parë vazhdimisht ka treguar se ka shumë manipulime në opinion lidhur me termin gjuhë urrejtjeje si kategori juridike, përcaktimin e tij dhe kompetencat për mbrojtje nga ky abuzim i lirisë së shprehjes. Rezultati përfundimtar i këtyre manipulimeve, me të cilat krijohet megjull rreth kuptimit të vetë termit, është mundësimi i mosndëshkimit të autorëve të dyshuar dhe zgjerimi i hapësirës për abuzime politike në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.*

*Ashtu si në të gjitha situatat e tjera, sa l përket kontekstit të negociatave me BE-në dhe përbushjes së Marrëveshjes për Miqësi me Bullgarinë, është e rëndësishme që të përcaktohen qartë kriteret për trajtimin e kësaj vepre penale sipas standardeve të Këshillit të Evropës, si dhe komunikim i qartë me publikun për kriteret dhe rolet e të gjitha institucioneve të sistemit gjatë atij procesi, veçanërisht të atyre që janë pjesë e sistemit gjyqësor. Nevoja për rritjen e efikasitetit dhe llogaridhënies së organeve shtetërore përgjegjëse për mbrojtjen e qytetarëve në këtë drejtim për vite me radhë është pjesë e nevojave të shprehura përmes raporteve të progresit të përgatitura nga Komisioni Evropian*

*Ky proces mund të përfshijë edhe plotësimin e legjislacionit përmes një procesi konsultimi dhe debati të gjerë publik që do të rrisë ndërgjegjësimin e publikut për kuptimin e vërtetë juridik të termit, duke inkuadruar drejtpërdrejt jurisprudencën e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut nga Strasburgu, e cila është organi më i lartë gjyqësor për raste të tilla në sistemin juridik të vendit tonë.*

*Në të njëjtën kohë, procesi duhet të përfshijë edukimin e të gjitha palëve të përfshira për të gjitha aspektet e problemit, veçanërisht ato ligjore, sepse është konstatuar mungesë njohurish dhe ndërgjegjësimi pothuajse në të gjitha nivelet.*



## Komuniteti mediatik kërkon më shumë transparencë nga institucionet dhe zbatim e respektim joselektiv të legjislacionit dhe mekanizmave ekzistues ndërkombëtar dhe të vendit

Sipas pikëpamjeve të shprehura të organizatave profesionale dhe eksperte të medias, mund të konkludohet se ato janë unanime se gjuha e urrejtjes duhet të trajtohet brenda kornizës së përkufizimeve, dokumenteve, konventave dhe mekanizmave të pranuar ndërkombëtarisht që vendi është zotuar t'i respektojë (më së shumti përmenden mekanizmat e Këshillit të Evropës), si dhe legjislacionit ekzistues të vendit.

Megjithatë, mbizotëron mendimi se mekanizmat ligjorë zbatohen në mënyrë të pamjaftueshme dhe selektive, se organet kompetente nuk veprojnë në masë të duhur, duke krijuar një kulturë të mosndëshkimit.

Organizatave mediatike dhe ekspertët drejtojnë vërejtje për institucionet dhe Qeverinë e Maqedonisë së Veriut, të cilat i referohen mungesës së transparencës në të gjithë procesin e përcaktimit të kornizës së negociatave me BE-në dhe protokollit me Bullgarinë.

Një pjesë e tyre e konsiderojnë si kontestues rolin e Ministrive të Jashtme si një mekanizëm përmes të cilit do të zhvillohet trajtimi i gjuhës së urrejtjes në të dy vendet, pasi për këtë janë përgjegjës ministritë e brendshme dhe prokuroritë, apo rregullatori i medias.

Një pjesë e tyre, nga ana tjetër, e ngrenë çështjen e reciprocitetit në këto marrëdhënie, duke theksuar se, në opinion, politika shtetërore e Bullgarisë dhe deklaratat e shumë politikanëve të atjeshëm që mohojnë identitetin dhe gjuhën maqedonase, perceptohen si gjuhë e urrejtjes.

Organizatave mediatike dhe ekspertët vlerësojnë se në të gjithë procesin duhet pastruar veçanërisht kujdes që të mos shkaktohet "efekt ftohës" dhe të mos lejohet që një formulim i përgjithshëm i gjuhës së urrejtjes të ndikojë në lirinë e shprehjes dhe të mendimit, pra, të mos shkaktojë censurë.

Një pjesë e përgjigjeve ndaj këtyre dilemave, sugjerimeve dhe vërejtjeve të komunitetit profesional dhe ekspert mediatik, ndoshta do të ketë kur do të konkretizohen planet e veprimit, për të cilat flitet në përgjithësi në dokumentet e negociatave. Ata duhet të krijohen në të ardhmen.

Deri më tani, të dy shtetet nuk u treguan të jenë veçanërisht të shkathtë dhe transparentë në komunikimin me publikun. Duke vepruar kështu, ata shpeshherë linin hapësirë për ndikimin e spekulimeve, të narrativave të konfrontimeve, propagandës e bile edhe të narrativave dezinformuese, të cilat krijojnë polarizim dhe urrejtje shtesë.

Në ato veprime konkrete do të shihet nëse dhe në çfarë mënyre politika, diplomacia dhe institucionet do të krijojnë bashkëpunim me mediat, organizatat e tyre dhe sektorin civil në të dy vendet. Vallë do të gjejnë shtetet mënyra për të përmbushur kërkesat e tyre dhe për të adresuar rezervat dhe frikën rreth mundësisë së kërcënimeve ndaj lirisë së shprehjes? A do të krijohen mekanizma brenda shteteve, por edhe mes tyre, për të arritur përfshirjen dhe bashkëpunimin konstruktiv të të gjithë aktorëve?

Në të njëjtën kohë, është fakt se komunikimi mediatik dhe publik, veçanërisht në disa prej mediave online dhe në rrjetet sociale, është i distorsionuar nga një rritje e mad-

he e gjuhës së urrejtjes dhe dezinformimit. Përpjekjet e organizatave mediatike për të ndikuar në zvogëlimin e tyre përmes mekanizmave vetërregullues, dhe ndikimi i shtetit përmes veprimeve të institucioneve kompetente, qartazi nuk japin rezultate më të dukshme dhe kanë një efekt shumë të kufizuar.

Prandaj, bashkëpunimi ndërmjet institucioneve, mediave dhe sektorit civil brenda dy vendeve, por edhe ndërmjet tyre, nëse zhvillohet siç duhet, mund të jetë kyç për uljen e dëmeve të shkaktuara nga gjuha e urrejtjes. Pa atë bashkëpunim, lufta kundër këtij fenomeni shkatërrues do të jetë shumë më e vështirë. Kjo, siç është treguar deri më tani, do të ndikojë negativisht në përpjekjet për marrëdhënie të mira fqinjësore, e me këtë edhe në perspektivat evropiane të vendit.

# 5 RRUGA E MAQEDONISË SË VERIUT DREJT BE ËSHTË NËN KËRCËNIM NGA NJË AKTOR I PAPRITUR

Shkruan: KATERINA KOLLOZOVA

Një pjesë e madhe e shoqërisë civile maqedonase i është bashkuar së djathtës në refuzimin e marrëveshjes me Sofjen dhe Brukselin. Kjo është një gjë e rrezikshme.

Gjatë verës, propozimi nga Bashkimi Evropian për të zgjidhur mosmarrëveshjen e Maqedonisë së Veriut me Bullgarinë fqinje, e cila kishte vendosur një veto në kandidaturën e saj për anëtarësim në BE, shkaktoi shumë trazira sociale në këtë vend ballkanik. Opozita maqedonase hodhi poshtë atë që u bë i njohur si “propozimi francez” dhe bëri thirrje për demonstrata masive.

Pasi që qeveria maqedonase miratoi propozimin, ndërsa Sofja hoqi veton e saj, partitë opozitare deklaruan se do të votojnë kundër ndryshimeve në kushtetutë për t’u përshtatur me dispozitat e dokumentit. Në shtator, opozita gjithashtu njoftoi se kërkon një referendum për të braktisur vlefshmërinë e Marrëveshjes për miqësi midis dy vendeve të vitit 2017, kërkesë kjo e cila u refuzua nga parlamenti – për momentin.

Është e kuptueshme që opozita po shfrytëzon situatën për të kërkuar përfitime politike. Por në kundërshtimin e saj ndaj “propozimit francez” dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes me Bullgarinë, asaj i është bashkuar shumica e shoqërisë civile progresive dhe pro-BE.

Kjo ekspozoi realitetin shqetësues se përkrahësit e supozuar të integritimit në BE janë të gatshëm për të hequr dorë shpejtë nga ai, duke avokuar “alternativa” që me siguri do të minonin rrugën demokratike dhe stabilitetin të Maqedonisë së Veriut.

Për të kuptuar rreziqet e kësaj situatë, është e rëndësishme të kujtojmë se si Maqedonia e Veriut arriti deri këtu. Pas shpërbërjes së Jugosllavisë, së bashku me Slloveninë, Republika e Maqedonisë e atëhershme ishte një nga republikat e para ish-jugosllave që mori njohjen e pavarësisë së saj nga Komuniteti Evropian (tani Bashkimi Evropian). Në vitin 2005, ajo mori statusin e kandidatit për BE. Megjithatë, për shkak të mosmarrëveshjeve në lidhje me trashëgiminë kulturore dhe historinë kombëtare me fqinjët e saj të BE-së, Greqinë dhe Bullgarinë, ajo u la në dhomën e pritjes së BE-së për gati 20 vjet, pasi që fillimi i negociatave të anëtarësimit u shty.

Mosmarrëveshja me Greqinë u zgjidh në vitin 2018 me [nënshkrimin](#)<sup>1</sup> e të ashtuquajturës Marrëveshje të Prespës, e cila ndryshoi emrin e vendit në Maqedoninë e Veriut dhe konfirmoi të drejtat e saja për identitet etnik, kulturor, gjuhësor dhe nacional. Marrëveshja e 2017-ës për marrëdhënie miqësore duhej të vendosë një kornizë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me Bullgarinë për problemet historike, , problemet gjuhësore dhe problemet me të drejtat e pakicave. Mirëpo, në vitin 2020, Sofja [imponoi një veto](#)<sup>2</sup>, duke përmendur si shkak mosrespektimin e marrëveshjes. Ky veprime sa duket ishte një

<sup>1</sup> Shih: Katerina Kolozova, “Si e zgjidhi Ballkani një problem ballkanik” (How the Balkans solved a Balkan problem, [Al Jazeera](#), 21.02.2022)

<sup>2</sup> Shih: Katerina Kolozova, “Për kontestin maqedono-bullgar dhe revizionizmin historik” (On the Macedonian-Bulgarian dispute and historical revisionism, [Al Jazeera](#), 07.12.2020)

përpjekje e qeverisë së Bojko Borisov për të larguar vëmendjen nga një valë protestash që kërkonin dorëheqjen e saj.

Këmbëngulja e fqinjëve të Shkupit për të interpretuar se cili duhet të jetë identiteti kombëtar dhe etnik i maqedonasve, duke i shndërruar mosmarrëveshjet bilaterale në një kusht jozyrtar për integrimin e vendit në BE, shkaktoi një frustracion të kuptueshëm në vend.

Por sipas rregullave aktuale të BE-së, çdo anëtar i BE-së ka të drejtën e vetos për fillimin e bisedimeve për anëtarësimin e shteteve që nuk janë anëtare të BE-së. Franca, Danimarka dhe Holanda, për shembull, gjithashtu kanë vënë veton më parë për negociatat e anëtarësimit me Maqedoninë e Veriut.

Më parë gjatë këtij viti, i ballafaquar me mospranimin bullgar për të lëshuar pe për veton dhe duke u përpjekur t'i jepte një vrull të ri zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor, Brukseli, nën presidencën franceze, krijoi një kornizë negociuese për Sofjen dhe Shkupin – atë që u bë e njohur si “Propozimi francez”. Pala bullgare u pajtua me “propozimin francez” dhe hoqi veton, por opozita maqedonase, duke përfshirë partitë e krahut të djathtë, si VMRO-DPMNE që ka lidhje të dëshmuara me të fortin hungarez Viktor Orban, si dhe partia nacionaliste gjoja e krahut të majtë e quajtur “Levica” (E Majta) e refuzoi atë, duke parë në të tepër shumë lëshime ndaj Bullgarisë për çështjet e identitetit maqedonas.

E ftoj lexuesin të shikojë [dokumentin](#)<sup>3</sup> dhe të vlerësojë vet – ky është një dokument standard, steril teknokratik që kërkon pajtimin mes dy vendeve në emër të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë.

Ai i referohet vetëm në një vend marrëveshjes së miqësisë ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Bullgarisë, si dhe Marrëveshjes së Prespës. Dokumenti qartëson se të drejtat e pakicës bullgare në Maqedoninë e Veriut duhet të njihen, gjë që kërkon një ndryshim kushtetues. Kjo është kërkesa kryesore bullgare.

Është e vërtetë se dokumenti gjithashtu i lejon Bullgarisë të kundërshtojë në mënyrë të njëanshme veçorinë e gjuhës maqedonase dhe me gjasa ta shpallë atë për “dialekt bullgar”. Megjithatë, një mundësi e tillë nuk do të ndikojë në faktin se BE-ja e njej gjuhën maqedonase dhe veçantinë e identitetit kombëtar të maqedonasve, gjë që është mjaft e qartë në propozim.

Megjithatë, fushata opozitare e dezinformimit kundër dokumentit arriti të tërheqë organizatat gjoja “neutrale” dhe properëndimore të shoqërisë civile, të cilat gjithashtu ngritën transparentët “JO për [këtë] BE” dhe “JO për një BE që dëshiron të na bullgarizojë”.

Slogani i fundit tingëllon komik, por është përdorur me gjithë seriozitet – më tepër *think-tank* organizata kanë publikuar analiza të shumta të këtilla. Disa madje filluan të avokojnë publikisht për alternativat ndaj anëtarësimit në BE, të tilla si Unioni Euroaziatik, ose për një marrëveshje rajonale përgjatë kufijve të ish-Jugosllavisë.

Siç qëndrojnë punët tani, organizatat *think-tank*, institucionet akademike dhe OJQ-të e financuara nga BE dhe SHBA në Maqedoninë e Veriut nuk e mbështesin njohjen e pakicës bullgare në kushtetutën maqedonase – me përjashtim të vetëm disa prej tyre.

Për shembull, Akademia Maqedonase e Shkencave dhe Arteve e ka hedhur poshtë

<sup>3</sup>Shih: MINISTERIAL MEETING OF THE INTERGOVERNMENTAL CONFERENCE COMPLETING THE OPENING OF THE NEGOTIATIONS ON THE ACCESSION OF NORTH MACEDONIA TO THE EUROPEAN UNION GENERAL EU POSITION, botuar në [ueb-faqen zyrtare të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut](#)

me vendosmëri "propozimin francez". Kjo nuk është aspak befasuese, duke pasur parasysh se ajo është e rrënjosur në një "romantizëm kombëtar" atavist të ngjashëm me atë që e përqafoi Akademia Serbe e Shkencave në vitet 1990, kur i mbështeste luftërat e Slobodan Millosheviqit në ish-Jugosllavi.

Intelektualët maqedonas dhe shoqëria civile që qëndroi në anën e nacionalistëve, kanë inkurajuar gjithashtu disa studiues dhe ekspertë të huaj të njohur për Evropën Juglindore dhe Ballkanin Perëndimor të supozojnë se pozicioni i tyre është ai i vërteti. Nuk kam shpjegim tjetër, përveçse atij që kolegët e mi të dashur të huaj që kanë mbajtur qëndrimin e "mbrojtësve të patundur të maqedonasve", në fakt nuk i kanë lexuar 25 faqet e dokumentit.

Disa pretendojnë se "propozimi francez" e ka futur historinë si kriter në procesin e anëtarësimit. Unë kam mendim të ndryshëm. Qëndrimi i përgjithshëm i Këshillit të BE-së vetëm kërkon që të dy fqinjët të zgjidhin mosmarrëveshjen e tyre, por nuk thotë se më çfarë mënyre, as në aspektin historik. Në çfarë mënyre është kjo "bullgarizim"? Marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë – e me këtë edhe stabiliteti rajonal – janë aspekt i Kritereve të Kopenhagës për anëtarësimin në BE.

Nëse Maqedonia e Veriut tërhiqet nga Marrëveshja me Bullgarinë pas një referendumi ose nuk i përmbush zotimet e saj për të njohur të drejtat e pakicës bullgare në kushtetutë, kjo do të bllokonte në mënyrë efektive qasjen e saj në BE. Dhe nuk do të ishte Bullgaria që do të imponojë një veto. Vetë Këshilli i BE-së do të ndalonte procesin për mungesë respektimi të kushteve të negociatave të përshkruara në "propozimin francez" dhe respektimit të dispozitave të Kritereve të Kopenhagës.

Është evidente se po përballemi me një ksenofobi në rritje ndaj Bullgarisë dhe pakicës bullgare në Maqedoninë e Veriut, e kombinuar me euro-skepticizmin në rritje, gjë që po e vë në rrezik mbarë procesin e zgjerimit të BE-së. Nëse kjo mbetet e pa adresuar, rruga demokratike e Maqedonisë së Veriut do të dëmtohet rëndë.

Duke pasur parasysh realitetet e sotme gjeopolitike, mosinkuadrimi për vendet e vogla si Maqedonia e Veriut nuk është një opsion i vërtetë. Andaj, Shkupi duhet të zgjedhë midis anëtarësimit në BE apo integritet euroaziatik, pra rreshtimit me Rusinë dhe Kinën.

Maqedonia e Veriut është e rrethuar nga shtetet fqinje që janë pjesë e BE-së dhe është gjithashtu në zemër të një rajoni që ka pësuar konflikte në të kaluarën e afërme dhe mbetet e jo stabil. Në këtë kontekst, përafrimi me lojtarët gjeopolitikë që nuk janë të BE-së mund të çojë në jostabilitet rajonal që do të prekte mbarë Evropën.

Kjo është arsyeja pse duhet të trajtohet toksiciteti që është në qendër të kulturës politike maqedonase. Ilaçi i vetëm është afrimi kulturor midis Maqedonisë së Veriut dhe Bullgarisë. Nisma e Ballkanit të Hapur, një zonë joformale politike dhe ekonomike e themeluar nga Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria që synon të veprojë ngjashëm si BE me "mini-Shengenin" e vet (kufijve të hapur për lëvizje), mund të jetë e dobishme nëse hapet ndaj fqinjëve të BE-së: Bullgarisë, Greqisë dhe Kroacisë.

*(Katerina Kollozova është profesreshë e filozofisë dhe teorisë politike)*

Burimi: <https://www.aljazeera.com/opinions/2022/9/18/north-macedonias-eu-path-is-in-danger>

iM@